



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS**

RAPORT AUDITIMI PERFORMANCE

“Performanca e sistemit të shfrytëzimit mineral të mermerëve”.

Tiranë 2023

P Ë R M B A J T J A

1. PROBLEMI SOCIAL DHE RËNDËSIA E AUDITIMIT	5
1.1 Konteksti i problemit social.....	5
1.2 Rëndësia e auditimit të performancës	6
1.3 Auditime të mëparshme apo aktuale në këtë fushë.....	6
2. SUBJEKTET NËN AUDITIM.....	7
2.1 Hyrje në subjektet nën auditim.....	7
2.2 Baza ligjore që rregullon çështjen nën auditim.....	11
2.3 Rëndësia e produkteve të subjektit.....	12
2.4 Peshë në buxhet	14
2.5 Përkufizimet dhe terminologjia	16
2.6 Skema e analizës së programit auditues.....	19
2.7 Feedback-u i subjektit në fazën studimore	20
3. DETAJET E AUDITIMIT	20
3.1 Vlerësimi i risqeve të aktiviteteve të subjektit	20
3.2 Objektivi i auditimit.....	21
3.3 Pyetjet e auditimit	22
3.4 Fushëveprimi i auditimit	22
4.SHTJELLIMI I PYETJEVE DHE NËNPYETJEVE	23
4.1 A GARANTOJNË POLITIKAT KOMBËTARE MAKSIMIZIMIN E PËRFITIMIT PUBLIK NGA VEPRIMTARIA MINERARE E SHFRYTËZIMIT TË MERMERËVE?.....	23
4.1.1 A JANË HARTUAR DHE ZBATUAR POLITIKA DHE OBJEKTIVA TË PËRSHTATSHME NË FUNKSION TË SHFRYTËZIMIT TË MERMERËVE?.....	23
4.1.2 SI KA QENË ECURIA E TË ARDHURAVE TË REALIZUARA NGA SEKTORI I SHFRYTËZIMIT TË MERMERËVE?.....	27
4.2 A KANË GARANTUAR INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE MBIKËQYRJE TË PLOTË TË PROCESIT TË SHFRYTËZIMIT TË MERMERËVE?.....	36
4.2.1 A JANË MIRATUAR KËRKESAT PËR HEQJE NGA FONDI PYJOR TË AKTIVITETEVE TË SHFRYTËZIMIT TË MERMERËVE?.....	36
4.2.2 A KA FUNKSIONUAR SISTEMI I KONTROLLIT DHE MONITORIMIT TË AKTIVITETIT TË SHFRYTËZIMIT TË MERMERËVE?.....	42
5. GRUPI I PUNËS..	
.....Error! Bookmark not defined.	
6. ANEKSI.....	52

PËRMBLEDHJA

Auditimi me temë “Performanca e sistemit të shfrytëzimit mineral të mermerëve” ka pasur si objektiv kryesor vlerësimin dhe analizimin e masave të marra nga institucionet përgjegjëse mbi shfrytëzimin e mineralit të mermerit si dhe impaktin që ato kanë në ekonomi, komunitet dhe mjedis. Institucionet subjekt i këtij auditimi kanë qenë Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore. Masat e marra nga institucionet përgjegjëse nuk kanë qenë plotësisht të mjaftueshme për të përmirësuar shfrytëzimin e mineralit të mermerit dhe efektet që ky aktivitet ka në ekonomi, mjedis por dhe komunitet. Angazhimet e institucioneve përgjegjëse duhet të synojnë optimizimin dhe maksimizimin e vjeljes së rentës minerare ndaj subjekteve që shfrytëzojnë mermerin duke qenë se të ardhurat në buxhetin e shtetit nga vjelja e rentës minerare për mermerin kanë pësuar rënie përgjatë viteve 2020-2022 kur në të njëjtën kohë shitjet dhe të ardhurat e subjekteve private janë rritur. Një fenomen i ri sapo ka filluar të përhapet duke dhënë efekte negative në reduktimin e rentës minerare të vjelë nga shteti. Konkretisht, disa subjekte në vitet e fundit kanë ndryshuar emërtimin e Lejes Minerare duke bërë që këto të paguajnë më pak rentë minerare edhe pse shfrytëzojnë të njëjtin formacion shkëmbor me subjekte të tjera dhe të cilat e paguajnë rentën minerare në vlerën që u takon. Subjekte të tjera me të njëjtin emërtim në Lejen minerare paguajnë rentë minerare të ndryshme në mos përputhje me Ligjin për Taksat kombëtare. Nevojitet një sinkronizim dhe harmonizim midis Ligjit Minerar dhe Ligjit për Taksat Kombëtare sa i përket përdorimit të terminologjisë mbi mineralin e mermerit.

Problematikë mbetet gjithashtu mos miratimi për ndryshimin/heqjen nga fondi pyjor të sipërfaqeve pyjore të licencuara për shfrytëzim për aktivitetet minerar. Pavarësisht se subjektet kanë aplikuar prej kohësh dhe dosjet e shumicës prej tyre janë në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, deri më sot asnjë prej subjekteve që ushtrojnë aktivitetin e shfrytëzimit të mermerit nuk janë të pajisur me aktin përkatës ligjor/nënligjor (Miratimin e Ministrit të MTM, VKM ose Ligj të veçantë) për ndryshimin/heqjen nga fondi pyjor të sipërfaqes pyjore të shfrytëzuar. Sipërfaqja reale pyjore e shfrytëzuar për aktivitetet minerar në sektorin e mermerit është 0.89 km² që ndryshe do të thotë se 0.89 km² është “*de facto*” sipërfaqja pyjore e reduktuar. Duke qenë se subjekteve nuk i është miratuar ndryshimi/heqja nga fondi pyjor, këto sipërfaqe rezultojnë ende në Regjistrin Kombëtar të Fondit Pyjor, kur aktualisht ato janë sipërfaqe e shfrytëzuar si aktivitetet minerar. Mos miratimi nga Ministri i MTM, VKM, ose Ligj për heqje nga Fondi Pyjor bën që subjektet të mos marrin masa për kompensimin e shpyllëzimit që ato kanë kryer dhe do të vazhdojnë të kryejnë.

Lidhur me kontrollin, monitorimin dhe inspektimin e subjekteve që kryejnë shfrytëzimin e mineralit të mermerit janë vërejtur një sërë parregullsish si në mungesë të mbulimit me monitorim të këtyre subjekteve nga ana e institucioneve përgjegjëse (konkretisht AKM dhe AKBN) ashtu edhe me mungesë bashkëpunimi nga vetë këto institucione. Shqetësim mbetet fakti që rehabilitimi mjedisor progresiv nuk është bërë nga asnjë subjekt që shfrytëzon mermerin, pavarësisht se në dokumente të ndryshme zyrtare këtyre subjekteve i është lënë detyrë nga AKBN që të kryejnë rehabilitimin mjedisor për sipërfaqe të caktuara.

AKRONIMET

RSH	Republika e Shqipërisë
BE	Bashkimi Evropian
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
AKBN	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore
AKP	Agjencia Kombëtare e Pyjeve
NJVQV	Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore
QKB	Qendra kombëtare e Biznesit
SHGJSH	Shërbimi Gjeologjik Shqiptar
VKM	Vendimi i Këshillit të Ministrave
TVSH	Tatim mbi vlerën e shtuar
PRM	Plani i Rehabilitimit të Mjedisit
RKFP	Regjistri Kombëtar i Fondit Pyjor
GMMD¹	Gëlqerorët Masiv, Mermerizuar dhe Dekorativ
INTOSAI	The International Organization of Supreme Audit Institutions
EUROSAI	The European Organisation of Supreme Audit Institutions

¹ Shënim: Termi GMMD është përdorur nga grupi i auditimit për të identifikuar mineralin e mermerit i cili gjendet (në përqindje të ndryshme) në Gëlqerorët masiv, mermerizuar dhe dekorativ.

1. PROBLEMI SOCIAL DHE RËNDËSIA E AUDITIMIT

1.1 Konteksti i problemit social

Eksplorimi (kërkim-zbulimi) është hapi i parë në zinxhirin e vlerës së minierave, i cili përfshin të gjitha proceset që lidhen me gjetjen e mineraleve (përqendrimit e mundshme të tyre) me qëllim nxjerrjen dhe shfrytëzimin në një fazë të mëvonshme. Nxjerrja përfshin zhvillimin, hapjen e një depozite për prodhim dhe shfrytëzimin, prodhimin në shkallë të gjerë të mineralit në një minierë.² Shqipëria është e njohur për burimet e saj minerale. Shumë prej tyre janë zbuluar që nga kohët antike e deri më sot. Gjithashtu ekzistojnë depozita të tjera për të cilat nevojitet të kryhen studime dhe vlerësime të rezervave gjeologjike. Zhvillimi i industrisë minerare në Shqipëri ka kaluar në tre faza kryesore. Faza e parë përfshin periudhën deri në Luftën e Dytë Botërore e cila shënon dy ngjarje kryesore. Në 1922 u përpilua Harta e parë Gjeologjike e Shqipërisë, e cila ishte e para në llojin e saj në të gjitha shtetet e Ballkanit. Ndërsa, në vitin 1929 aprovohet Ligji i parë Minerar në Mbretërinë e Shqipërisë, e cila i hapi rrugë eksplorimit dhe shfrytëzimit të burimeve minerale në Shqipëri. Faza e dytë (1944-1994), shënon periudhën në të cilën aktiviteti minerar ishte i organizuar në ndërmarrje shtetërore dhe koncepti i privatizimit të aktivitetit minerar nuk ekzistonte. Faza e tretë përfshin periudhën nga 1994 deri më sot. Ajo filloi me privatizimin e aktivitetit minerar pas aprovimit të Ligjit Minerar të Shqipërisë.³

Gëlqerorët e mermerit (të Triasik-Jurasikut) përfaqësojnë grupin me cilësinë më të lartë dekorative. Ato dallohen për nivelin e lartë të kristalizimit, diversitetin e ngjyrave, ndërtimin masiv dhe mundësinë për t'u nxjerrë në blloqe. Ato ndodhen në rrethet e Tropojës, Kukësit, Dibërës dhe Bulqizës, me ngjyrë të kuqe në rozë dhe nuancë të bardhë. Ndërsa gëlqerorë të tjerë mermeri me ngjyrë të bardhë gjenden në Qaf Shtamë, me ngjyrë rozë në Elbasan dhe Pogradec dhe ngjyrë gri në rrethin e Devollit. Nga vlerësimet e kryera në rreth 20 vendburime, llogariten në rreth 100 milionë m³ rezerva gjeologjike. Depozitimet më të rëndësishme midis të gjithave mund të konsiderohen ato të Muhurit, Gjurasit, Kovashicës dhe Qafshtamës. Gëlqerorët masivë të Kretakut dhe Kretakut- Paleogenium janë me nuancë të kuqe dhe rozë në Milot, Lag, Mamurras etj. te rrethit Kurbin, ndërsa në Zall Dajt dhe Qaf Priskë të rrethit Tiranë janë me ngjyrë të bardhë e gri. Në vendburimet e Mëlovës, që ndodhet në rrethin e Skraparit, prodhohen blloqe gëlqerorë të bardhë. Nga vlerësimi i grupit të sipërpërmendur, sasia gjeologjike e rezervave të llogaritura janë rreth 143 milionë m³.⁴

Gjatë shfrytëzimit të mermerëve ndikim thelbësor kanë faktorët:

- Natyrorë (ndërtimi gjeologjik i vendburimit, karakteristikat hidrogjeologjike të vendburimit, morfologjia e vendburimit, cilësia e mermerit, etj.);
- Teknologjikë (mundësia e shfrytëzimit, kapaciteti dhe jetëgjatësia e shfrytëzimit, siguria, qëndrueshmëria e shpateve përfundimtare etj.);
- Ekologjikë (ndikimi i shfrytëzimit në mjedis, masat e rehabilitimit dhe kthimit në gjendjen e mëparshme etj.);
- Ekonomikë (vlerësimi i vendburimit si tërësi, kostoja e shfrytëzimit dhe çmimi i shitjes së produktit minerar, punësimi, fitimi etj.).⁵

Aktiviteti i shfrytëzimit minerar ka ndikime pozitive dhe negative në ekonomi, shoqëri dhe mjedis. Ai mund të kontribuojë në zhvillimin ekonomik, krijimin e infrastrukturës dhe rritjen e zhvillimin e komuniteteve, por gjithashtu mund të rezultojë në ndikime të rënda negative mjedisore gjatë gjithë ciklit jetësor të minierës. Në disa vende, kompanitë minerare neglizhojnë kostot e kompensimit për

² The MIN-GUIDE Policy Guide Guidance for EU and MS mineral policy and legislation, fq 14

³ <http://www.akbn.gov.al/wp-content/uploads/2019/06/Mineral-Resources1.pdf> , fq 5

⁴ <http://www.akbn.gov.al/wp-content/uploads/2019/06/Mineral-Resources1.pdf> , fq 30-32.

⁵ A. Morina, Universiteti i Mitrovicës “Isa Boletini” Punim Master Shkencor me temë “Optimizimi i shfrytëzimit të mermerit në vendburimin Zatriq – Malishevë, fq 7.

dëmet mjedisore, të cilat ndonjëherë mund të çojnë deri në mbylljen e plotë të aktivitetit minerar. Për të vlerësuar me saktësi fizibilitetin ekonomik të një aktiviteti minerar, është thelbësore të përfshihen kostot mjedisore në studimet e fizibilitetit. Megjithatë, përcaktimi sasior i kostove mjedisore për ton të mineraleve ende mbetet një sfidë shumë e madhe.⁶ Sipas të dhënave të AKBN-së, numri i të punësuarve në të gjithë sektorin minerar, në fund të vitit 2022 është 5497, ndërsa vetëm në sektorin e shfrytëzimit të mermerëve për të njëjtin vit është 239.

1.2 Rëndësia e auditimit të performancës

Auditimet e performancës vlerësojnë nëse synimet e politikave dhe skemat qeverisëse lidhen me problemet reale të shoqërisë dhe shqetësimet e palëve të interesit, duke dhënë një informacion shumë më të gjerë mbi ecurinë e të gjithë projekteve dhe programeve në entet publike të audituara. Këto auditime kryhen duke u bazuar tek Standardet Ndërkombëtare ISSAI dhe Udhëzuesi i Auditimit të Performancës (ISSAI 300, 3000, 3100, 3200, 5100 dhe 5200), Manuali i Auditimit të Performancës, Indikatorët e Performancës sipas praktikave më të mira audituese, të cilat shërbejnë si udhërrëfyes për konceptimin, planifikimin, kryerjen, konkludimin dhe ndjekjen e rekomandimeve të auditimit të performancës. Kontrolli i Lartë i Shtetit, duke synuar realizimin e misionit të tij, si institucion që ofron një ekspertizë të pavarur në ndihmë të një menaxhimi sa më të përgjegjshëm në shërbim të qytetarëve, jep një informacion shumë më të gjerë mbi ecurinë e të gjitha projekteve dhe programeve të institucioneve dhe enteve publike të audituara. Nëpërmjet auditimit të performancës synohet të analizohet ekonomiciteti, efienca dhe efektiviteti i programeve të ekzekutivit. KLSH nëpërmjet këtij auditimi synon të paraqesë situatën aktuale në lidhje me procesin e shfrytëzimit të mermerëve si dhe ndikimeve ekonomike, sociale e mjedisore të tij në vendin tonë.

1.3 Auditime të mëparshme apo aktuale në këtë fushë

K Kontrolli i Lartë i Shtetit në veprimtarinë e tij audituese, gjatë viteve të fundit i ka kushtuar një rëndësi gjithmonë e më të madhe auditimit të veprimtarisë së institucioneve qendrore dhe atyre vendore sa i përket mirëadministrimit të pasurive kombëtare me synim rritjen e mirëqenies së qytetarëve. Lidhur me tematika të ngjashme, KLSH ka kryer:

- Auditimin e performancës me temë “Cilësia e ajrit” bazuar në programin e auditimit nr. 682/4, datë 06.10.2017, i cili konkludoi me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr.203, datë 29/12/2017. Ky auditim u ushtrua në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve, Institutin e Shëndetit Publik, si dhe në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Berat, Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve Berat, Drejtorinë Rajonale Shëndetësore Berat.
- Auditimin e performancës me temë: “Efektiviteti i menaxhimit dhe administrimit të fondit pyjor dhe kullosor”⁷ bazuar në programin e auditimit nr. 1426/5; 1426/6; 1426/7; 1426/8 prot., datë 12.03.2019, i cili konkludoi me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 30, datë 30.07.2019. Ky auditim u ushtrua në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Bashkinë Tiranë, Bashkinë Vlorë dhe Bashkinë Shkodër.
- Auditimin financiar dhe përputhshmërisë me objekt: “Auditimi i përputhshmërisë dhe rregullshmërisë financiare për periudhën 07.09.2014 deri në 31.08.2016”.⁸ i cili konkludoi me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr.11, datë 26/02/2017. Ky auditim u ushtrua në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore, Tiranë.

2. SUBJEKTET NËN AUDITIM

2.1 Hyrje në subjektet nën auditim

Subjektet që janë përfshirë në këtë auditim janë:

⁶ <https://www.sciencedirect.com/science/article/abs/pii/S0301420723002726>

⁷ <https://panel.klsh.org.al/storage/phptWmoR9.PDF>


⁸ <https://panel.klsh.org.al/storage/php8NgNU0.pdf>

1. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
2. Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore
3. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
4. Agjencia Kombëtare e Mjedisit

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka si mision hartimin dhe zbatimin e politikës së përgjithshme shtetërore në fushën e infrastrukturës dhe transportit, në sektorin e telekomunikacionit dhe shërbimit postar, në sektorin e energjisë, shfrytëzimit të burimeve energjitike dhe minerare dhe në sektorin e industrisë jo ushqimore.

Fig.1 Organigrama e pjesshme, MIE dhe institucioni i varësisë AKBN



Përpunoi: Grupi i Auditimit

Drejtorja e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Industrisë dhe Energjisë

Nëpërmjet Sektorit të Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Industrisë dhe Energjisë harton strategji të shoqëruara me indikatorë përkatës dhe plane veprimi në përputhje me zhvillimet kombëtare dhe rajonale në sektorët e industrisë dhe energjisë mbi bazën e analizës së situatës ekzistuese.

Drejtorja e Programeve të Zhvillimit në Fushën e Minerave dhe Industrisë në MIE

- Krijon një “data base” të përditësuar për veprimtarinë industriale me elementët përkatës informativ, problematika aktuale, programet për përmirësim në funksion të zhvillimit industrial dhe miradministrim të pronës publike, pasurive natyrore e potencialeve njerëzore në interes të zhvillimit të vendit, bazuar në parimin e zhvillimit të qëndrueshëm;
- Vlerëson dhe analizon si tendencë të kohës gjendjen e mjedisit, rrugët e format për mbrojtjen e tij;

Sektori i Programeve të Zhvillimit në Fushën e Burimeve Minerare

- Zbaton politikën e Qeverisë në fushën e aktivitetit minerar (kërkimin, zbulimin, shfrytëzimin dhe përpunimin e mineraleve), në bazë të ligjit minerar të Shqipërisë.

- Siguron zbatimin e programeve të zhvillimit të industrisë minerare, programin 3 (tre) vjeçar dhe vjetor;
- Harton dhe përgatit dokumentacionin e nevojshëm për dhënien e lejeve minerare kërkim zbulimin dhe shfrytëzimin e mineraleve;
- Ndjek të gjitha procedurat e dhëna në ligj për dhënien e lejeve minerare, si institucion përgjegjës;
- Drejton, nëpërmjet institucioneve të varësisë, mbikëqyrjen, monitorimin, veprimtarinë e shoqërive, që merren me aktivitet minerar në lidhje për mbrojtjen në punë dhe shëndetin e punonjësve, si edhe për mbrojtjen dhe monitorimin e mjedisit për zonën e dhënë për kërkim zbulim apo shfrytëzim;⁹

Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore

Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore ka objekt të veprimtarisë zhvillimin, mbikëqyrjen e shfrytëzimit racional të burimeve natyrore, në bazë të politikave qeverisëse, dhe monitorimin e postshfrytëzimit të tyre, në sektorin minerar, hidrokarbur dhe energjetik.¹⁰

Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore ka këto detyra dhe përgjegjësi:

- Konsulton, propozon dhe bashkëpunon me strukturat përkatëse të qeverisë për hartimin e politikave të saj në fushën e minierave;
- Zbaton politikat e qeverisë në fushën e minierave;
- Siguron, brenda fushës së veprimtarisë së vet, oponencën qeveritare për studimet dhe projektet në fushën e veprimtarisë minerare, postminerare, hidrokarbure dhe energjetike, të paraqitura nga subjektet, shtetërore a private, vendase ose të huaja.
- Promovon burimet minerare e hidrokarbure, negociacion marrëveshjet hidrokarbure dhe minerare, si dhe ndjek zbatimin e planeve të zhvillimit të tyre;
- Mbikëqyr veprimtarinë minerare, postminerare, hidrokarbure dhe energjetike;
- Realizon monitorimin e zonave të shfrytëzuara, të rrezikut minerar dhe të mbylljes së veprimtarisë minerare;
- Administron, ekskluzivisht, të gjitha të dhënat parësore të sektorit hidrokarbur dhe të dhënat, që lidhen me veprimtarinë minerare dhe postminerare;
- Shërben si organ i specializuar për ministrin përgjegjës për energjinë, për problemet e strategjisë dhe të politikës në këtë fushë;

Drejtoria Minerare (Misioni)

- Hartimi dhe zbatimi i politikave të saj në fushën minerare;
- Sigurimi i oponencës qeveritare për studimet dhe projektet në fushën minerare dhe postminerare;
- Promovon burimet minerare, negociacion marrëveshjet minerare dhe ndjek zbatimin e planit të zhvillimit të tyre;
- Mbikëqyr veprimtarinë minerare e postminerare dhe realizon monitorimin e zonave të shfrytëzuara, të rrezikut minerar dhe të mbylljes së veprimtarisë minerar;

Sektori i Mbikëqyrjes së Shfrytëzimit racional të Materialeve të Ndërtimit, Qymyreve dhe Bitumit

- Mbikëqyr aktivitetin minerar në drejtim të zbatimit të projekteve, studimeve dhe programeve të zhvillimit të miratuara nga strukturat e AKBN-së dhe institucionet e tjera përkatëse;
- Grumbullon të dhëna për lejet minerare dhe prodhimin, për t'i përdorur në përditësimin e të dhënave në materiale promovuese;

⁹ Urdhër nr. 469 datë 30.12.2021 “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë”

¹⁰ Vendim Nr. 547, datë 9.8.2006, i azhurnuar “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore”

- Organizon punën e sektorit për kontrollin e pagesave të garancisë vjetore financiare të investimit dhe rehabilitimit si dhe ndjek procedurën e pagesës së rentës minerare për çdo mineral referuar ligjit të Taksave Kombëtare;
- Pranon dhe shqyrton kërkesat për kthimin e vlerës së garancisë së investimit dhe përgatit për Ministrin raportin përfundimtar me masën e llogaritur të vlerës së kthyeshme;


Sektori i Procedurave, Statistikës, Garancive Financiare, Koordinimit dhe GIS

- Hedh *on-line* në sistemin elektronik të implementuar në AKBN, të dhëna të lejes minerare, investimin dhe garancinë e investimit, rezervat, prodhimi tremujor dhe vjetor, shitjen dhe të dhëna të tjera të parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore, aktin e konstatimit dhe masën eventuale administrative të aplikuar;
- Kontrollon deklaratimet *on-line* të subjekteve krahasuar me gjendjen në terren. Mbi këtë bazë bën miratim ose jo të tyre dhe nëse konstatohen mosrakordime, në bashkëpunim me sektorët mbikëqyrës, njofton drejtorin ekzekutiv të AKBN dhe strukturat e MIE;
- Dokumenton raportet tremujore, vjetore dhe planet e punës vjetore të paraqitura nga subjektet sipas kuadrit ligjor e rregullator në fuqi;

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka për mision hartimin dhe zbatimin e politikave që synojnë mbrojtjen e mjedisit, përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit, zhvillimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe kullotave, monitorimin e cilësisë së ujërave.¹¹

Fig.2 Organigrama e pjesshme, MTM dhe institucioni i varësisë AKM



Drejtoria e Përgjithshme për Zhvillimin e Mjedisit

- Garanton realizimin e objektivave të Drejtorisë së Natyrës dhe Pyjeve, duke siguruar që çdo projekt apo aktivitet kontribuon në realizimin e objektivave dhe strategjive të sektorit dhe të gjitha programet së bashku realizojnë strategjitë dhe objektivat e ministrisë.
- Drejton dhe koordinon procesin për menaxhimin e ciklit të jetës së programeve, duke filluar nga iniciimi dhe formësimi i programeve sektoriale të zhvillimit, ndjekjen e realizueshmërisë së tyre në bazë të programeve në të cilat ato bëjnë pjesë dhe në përputhje me rezultatet dhe

¹¹ "Rregullore e Brendshme për organizimin dhe funksionimin e MTM", Neni 2 pika 1

impaktet e tyre, me qëllim përmirësimin e kuadrit ligjor për mbrojtjen e mjedisit, pyjeve, natyrës e biodiversitetit, për arritjen e transpozimit të plotë të direktivave të BE-së.

Drejtoria e Natyrës dhe Pyjeve

- Garantimi i politikave, strategjive dhe planeve të veprimit për mbrojtjen dhe administrimin e pyjeve dhe kullotave, në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm, përmirësimit të cilësisë së jetës dhe të integritetit të vendit në Bashkimin Evropian.

Sektori i Pyjeve dhe Kullotave

- Përgjigjet për hartimin, ndjekjen dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të sektorit, lidhur me mbarështimin dhe trajtimin, si dhe ekstensionin e pyjeve dhe kullotave
- Harton programet e zhvillimit të sektorit të pyjeve dhe kullotave, në përputhje me kuadrin ligjor për Mbarështimin e Qëndrueshëm të Fondit Pyjor e Kullosor.
- Ndjek veprimtaritë kombëtare dhe ndërkombëtare sa i takon pyjeve dhe kullotave

Agjencia Kombëtare e Mjedisit

Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) u krijua si ristrukturim i Agjencisë së Mjedisit dhe Pyjeve në mbështetje, të ligjit Nr.10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e Mjedisit” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 568 datë 17.07.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit si dhe “Urdhrit të Kryeministrit Nr. 23, datë 03.02.2020 “Për Miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Agjencisë Kombëtare të Mjedisit”. AKM është një institucion qendror publik në varësi të ministrit, që ushtron juridiksionin e vet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, përmes zyrës qendrore të AKM-së dhe 4 Agjencive Rajonale të Mjedisit. AKM financohet nga Buxheti i Shtetit dhe burimet e veta si dhe ka pavarësi në vendimmarrjen dhe kryerjen e funksioneve të saj, të parashikuara me Ligj. AKM-ja ka për mision mbrojtjen, ruajtjen dhe përmirësimin e mjedisit si një pasuri jetike për brezat e sotëm dhe të ardhshëm, parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, përdorimin e matur dhe racional të natyrës e të burimeve të saj në kuadër të zhvillimit të qëndrueshëm të vendit. Funksionet e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit janë:

- a) Sigurimi i performancës mjedisore;
- b) Kërkimi dhe dija mjedisore;
- c) Vlerësimi i impaktit mjedisor dhe licencimi;
- d) Inspektimi dhe kontrolli tematik për respektimin e kërkesave ligjore e të kushteve mjedisore.¹²

Drejtoria e Vlerësimit dhe Impaktit të Licensimit është përgjegjëse për:

- Vlerësimin e dokumenteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis;
- Përpunimin e lejeve mjedisore;

Sektori i Lejeve Mjedisore

- Ndjek procedurat e parashikuara ligjore për dhënien e lejes mjedisore;
- Informon dhe këshillon subjektet e licensuara për detyrimet ligjore që duhet të respektojnë;
- Bën oponencën teknike të lejeve;
- Mban lidhje me QKB për shkarkimet/ngarkimet në sistem leje mjedisore tipi A, B, etj;
- Zbardh akt miratimet/refuzimet e lejeve mjedisore;

Drejtoria e Inspektimit Kontrollit është përgjegjëse për:

- Sigurimi i kontrollit shtetëror i mbrojtjes së mjedisit;
- Sigurimi i zbatimit të gjithë akteve ligjore dhe nënligjore që rregullojnë gjithë veprimtarinë në fushën e inspektimit të mjedisit;
- Përgatit planin vjetor të inspektimit mbi bazën e riskut;

¹² VKM nr. 568, datë 17.7.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të AKM”

Sektori i Inspektimit Mjedisor

- Përgatitja e metodikave të inspektimit;
- Siguron zbatueshmërinë dhe përputhshmërinë e kushteve të lejeve të mjedisit me kërkesat e legjislacionit në fuqi;
- Përgatit raporte për çdo veprimtari inspektimi të kryer;
- Siguron përmbushjen e kushteve të lejes përkatëse të mjedisit në përputhje me dispozitat ligjore;

2.2 Baza ligjore që rregullon çështjen nën auditim

Kriteret politike:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
- VKM nr. 479, datë 29.06.2011 “Për Miratimin e Strategjisë Minerare të Republikës së Shqipërisë”.
- VKM nr.664, datë 10.10.2019 “Për miratimin e programit të veprimit 3-vjeçar, për vitet 2019-2021, në zbatim të strategjisë minerare”.
- VKM nr.380, datë 01.06.2022 “Për miratimin e programit të veprimit 3-vjeçar, për vitet 2022-2024, në zbatim të Strategjisë Minerare”.

Akte ligjore e nënligjore

- Ligji nr. 10304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”.
- Ligji nr. 57/2020 “Për pyjet”.
- Ligji nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për Fondin Kulloror”.
- Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat Kombëtare” i ndryshuar”.
- Ligji nr. 10081, datë 23.02.2009, Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.
- VKM nr. 547, datë 09.08.2006, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore”.
- VKM nr. 568, datë 17.07.2019, “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit”.
- VKM nr. 232, datë 23.03.2011 “Për miratimin e funksioneve të strukturave përgjegjëse në sektorin minerar të Republikës së Shqipërisë”.
- VKM nr. 558, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e kriterëve për ndarjen e shkeljeve me pasoja të lehta apo me pasoja të rënda dhe sanksionet financiare në Fondin Pyjor Kombëtar”.
- VKM nr. 559, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jo drusore pyjore”.
- VKM nr. 942, datë 17.11.2010 “Për miratimin e procedurave dhe të dokumentacionit për marrjen e lejeve minerare në zonat e hapura”.
- VKM nr. 320, datë 21.04.2011 “Për miratimin e procedurave dhe të kriterëve të konkurrimit dhe të afateve të shqyrtimit të kërkesave për marrjen e lejeve minerare në zonat konkurruese”.
- VKM nr. 364, datë 04.05.2011 “Për përcaktimin e kushteve, të vlerës minimale të sipërfaqes së zonës së lejuar minerare dhe të vlerës minimale të investimit e të prodhimit për një leje minerare”.
- VKM nr. 417, datë 25.06.2014 “Për miratimin e tarifave të lejeve të mjedisit”.
- VKM nr. 888, datë 27.12.2022, “Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre”.

- VKM nr.1353, datë 10.10.2008 “Për përcaktimin e rregullave për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, si dhe të kriterëve e të procedurave të zvogëlimit të sipërfaqes e të vëllimit të fondit pyjor”.
- VKM nr. 419, datë 25.6.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja”.
- VKM nr.537, datë 22.9.2021 “Për caktimin e kostove të përlogaritura për pyllëzim kompensues në rastet e ndryshimit të destinacionit të fondit pyjor”.
- VKM nr. 741, datë 09.09.2015 “Për miratimin e formës, rasteve të kthimit dhe mënyrës së llogaritjes të garancive financiare për rehabilitimin e mjedisit, për realizimin e programit minimal të punës dhe realizimin e investimit në veprimtarinë minerare”.
- Urdhër nr. 126, datë 10.06.2022 “Për procedurën e dorëzimit/ pranimit të dokumenteve dhe raporteve të vet monitorimit, për subjektet e pajisur me leje mjedisi të tipit A ose B”.
- Udhëzim nr. 01, datë 09.06.2016 i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit “Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të Fondit Pyjor dhe Kullosor Publik”.
- Udhëzim i përbashkët i Ministrisë të MIE dhe MTM me nr. 19 datë 24.08.2022 “Për miratimin e formatit standard për hartimin e Planit të Rehabilitimit të Mjedisit në veprimtarinë minerare”.

Praktika të mira ndërkombëtare

- The MIN-GUIDE Policy Guide Guidance for EU and MS mineral policy and legislation;
- Sweden’s Minerals Strategy “For sustainable use of Sweden’s mineral resources that creates growth throughout the country”;
- A. M., Universiteti i Mitrovicës “Isa Boletini” Punim Master Shkencor me temë “Optimizimi i shfrytëzimit të mermerit në vendburimin Zatriq – Malishevë.

2.3 Rëndësia e produkteve të subjektit

Këshilli i Ministrave me anë të Vendimit nr. 479 datë 29.06.2011 ka miratuar Strategjinë Minerare të Republikës së Shqipërisë e cila mbulon një periudhë 15-vjecare. Qëllimi kryesor i kësaj Strategjie është maksimizimi i përftimeve nga industria minerare, përmirësimi i kuadrit ligjor minerar, forcimi i institucioneve minerare, rivlerësimi i rezervave minerare, forcimi dhe rivlerësimi i marrëdhënieve të partneritetit publik-privat, politikat e punësimit, ruajtjen e parametrave mjedisore etj. Dokumenti i Strategjisë së zhvillimit të industrisë minerare merr në konsideratë reformat politike dhe institucionale në drejtim të integritetit të vendit në strukturat e BE-së dhe i shërben politikëbërësve për të vlerësuar industrinë minerare si një burim fitimi për vendin, për punësimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë. Ky dokument përfshin koncepte koherente me strategjinë evropiane për mineralet, sfidat, kërkesat për minerale, përparësinë e zhvillimit të veprimtarive për trajtimin e mineraleve si një proces të shtimit të vlerës së tyre në vend. Vëmendje e veçantë i kushtohet punësimit, prodhimit të produkteve të reja në këtë biznes, mënyrat e marrjes dhe shpërndarjes të informacionit, monitorimit të veprimtarive ekzistuese minerare, transparencën për publikun, transparencës në marrjen e vendimeve si dhe përfshirjen e autoriteteve lokale. Vizioni i kësaj strategjie mbështetet në zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit duke marrë parasysh impaktet ekonomike, sociale e mjedisore bazuar mbi parimet e ndarjes së të ardhurave midis të gjitha niveleve të qeverisjes, kompanive dhe komuniteteve konkurruese për tërheqjen e investitorëve. Misioni i saj duhet të garantojë një strukturë minerare eficiente nga pikëpamja ekonomike duke u mirë orientuar në treg dhe zgjeruar alternativat për vetë diversitetin e aktiviteti minerar.

Aktiviteti minerar është një burim i madh punësimi në mënyrë të veçantë në zonat rurale. Megjithatë shifra e punësimit në industrinë minerare aktualisht nuk është e lartë, përsëri ajo kontribuon dukshëm

në mbajtjen e një baze rurale të kualifikuar dhe është kusht kryesor për një ekonomi rurale të strukturuar mirë. Për të garantuar një zhvillim të qëndrueshëm e të harmonizuar, politikat minerare duhet të sigurojnë:

- Një bazë ligjore të plotë, në përputhje me legjislacionin e BE-së dhe standardet e veprimtarisë minerare, që garanton mbrojtjen e mjedisit, shëndetit dhe sigurinë në punë, si dhe transparencën;
- Përmirësimin e klimës së investimeve përmes krijimit të kushteve konkurruese ligjore dhe fiskale për të tërhequr dhe mbajtur investitorët e sektorit privat;
- Programin strategjik me objektiva afat-shkurtra, afat-mesme dhe afat-gjata, prioritete duke adresuar çështjet sociale e mjedisore;
- Transparencë në procedurat e tenderimit dhe licencimit;
- Inkurajim të aktiviteteve të trajtimit të mineraleve si një vlerë e shtuar në vend dhe mundësi për rritjen e punësimit;
- Përmirësim të produktivitetit dhe konkurrencës, përdorimit racional të burimeve financiare, njerëzore dhe natyrore;
- Ofrim të burimeve minerare bazuar në diversitetin mineral, të koordinuar me strategjitë sektoriale dhe programet e vendit me ato rajonale, BE-së dhe më gjerë;
- Përmirësim të bilancit ekonomik dhe financiar të vendit me zhvillimin e eksporteve;
- Rritje të investimeve në kërkim dhe zbulim;
- Rivlerësim të burimeve minerare, mbledhjen e të dhënave themelore gjeologjike në nivel kombëtar që ndihmojnë gjetjet e reja minerale dhe tërheqin kompani private për të investuar në veprimtaritë e kërkim zbulimit;
- Menaxhim të sigurt të mbetjeve minerare dhe inkurajim të proceseve të riciklimit.

Nga ana tjetër AKBN, në zbatim të pikës 7, 8 dhe 9 të Urdhrit të Ministrit të MIE nr. 201, datë 20.06.2016 “Për miratimin e formës e informacioneve tremujore, vjetore, përfundimtare dhe përmbajtjen e planit vjetor të punës nga ana e zotëruesve të lejeve minerare të shfrytëzimit me karrierë për grupin e mineraleve ndërtimore”, përgatit dhe dorëzon çdo vit Raportin përmbledhës 6 mujor dhe vjetor të veprimtarisë minerare të shfrytëzimit të subjekteve që posedojnë leje shfrytëzimi. Pjesë e këtyre raporteve, në një kapitull të veçantë përshkruhet edhe veprimtaria e subjekteve që shfrytëzojnë Gëlqerorët masiv, të mermerizuar dhe dekorativ. Për shfrytëzimin e mineralit të gëlqerorit masiv, dekorativ dhe të mermerizuar (GMMD) deri më Dhjetor 2022, janë aktive 33 leje minerare shfrytëzimi të shpërndara në 14 bashki në rang vendi. Shpërndarja e lejeve minerare të shfrytëzimit për mineralin e Gëlqerorit masiv, dekorativ dhe të mermerizuar jepet në tabelën nr. 1. Sipërfaqja totale e licencuar për këto lloje mineralesh është $S = 27.209 \text{ km}^2$. Vlerësohen rreth 130 milionë m^3 rezerva gjeologjike të licencuara me perspektivë për t’u shtuar. Numri më i madh i lejeve minerare për këto lloje mineralesh, ndodhet në rrethin e Skraparit me rreth 31 % të totalit (10 Leje Minerare Shfrytëzimi). Prodhimi për vitin 2022 sipas vet deklarimeve të subjekteve është **V2022= 23 422 m3**, krahasuar me vitin 2021 me **V2021= 21 852 m3**, siç vihet re ka një rritje te prodhimit me 9.3 %.¹³

Tab. Nr. 1 Shpërndarja e lejeve të shfrytëzimit të GMMD sipas rretheve


Gëlqeror masiv, Dekorativ, Mermerizuar		
Nr.	Rrethi	Nr. i Lejeve
1	Berat	2
2	Bulqizë	1
3	Devoll	1
4	Fushë-Arrëz	1
5	Këlcyrë	1

¹³ Mbikëqyrja e shfrytëzimit të rezervave minerare nga subjektet private, Raporti i vitit 2022, AKBN

6	Kolonjë	1
7	Korçë	2
8	Kukës	1
9	Kurbin	1
10	Librazhd	1
11	Mat	5
12	Selenicë	4
13	Shkodër	2
14	Skrapar	10
	Shuma	33

Burimi: Raporti Vjetor 2022, Volumi I, AKBN

Harta nr. 1 Shpërndarja e lejeve të shfrytëzimit të GMMD



Burimi: AKBN

2.4 Peshë në buxhet

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

Taksa e rentës minerare është një ndër llojet e taksave kombëtare të përcaktuara në nenin 3 të Ligjit 9975 nr.9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare” i ndryshuar. Ajo llogaritet si detyrim mujor i subjektit taksapagues në çastin që ai shet produkte minerare.¹⁴ Çdo person fizik apo juridik që është i licencuar dhe/ose vepron në industrinë minerare, duhet të paguajë rentë minerare për burimet

¹⁴ Ligji nr. 9975 datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar.

natyrore që nxjerr nga/mbi dhe nëntoka e Republikës së Shqipërisë¹⁵. Renta minerare është përqindja e vlerës së mineralit të thatë të shitur, që i paguhet shtetit nga zotëruesi i lejes minerare, si kompensim për zvogëlimin e burimeve minerare.¹⁶


Tabela nr. 2 Të ardhurat mbi rentë minerare për periudhën 2019-2022.

Nr	Emërtimi	Njësia	viti 2019	viti 2020	viti 2021	viti 2022
1	Te ardhura nga renta minerare (total produkti minerar)	Lekë	820,779,403	658,901,759	965,270,631	633,771,827
2	Te ardhura nga renta minerare GMMD	Lekë	19,426,747	13,613,041	11,049,667	10,376,056
3	Pesha specifike (%) GMMD/Total		0.0237	0.0207	0.0114	0.0164

Burimi: AKBN, Përpunoi: Grupi i auditimit

Pesha specifike e të ardhurave të vjela nga renta për mineralet e GMMD më të ardhurat e vjela nga renta e totalit të produktit minerar është shumë e ulët. Totali i të ardhurave përfituara nga vjelja e rentës minerare për produktin GMMD, për gjatë periudhës 2019-2022 është 54.465.511 lekë.

Grafiku nr. 1 Ecuria e të ardhurave nga vjelja e rentës GMMD për periudhën 2019-2022



Burimi: AKBN, Përpunoi: Grupi i auditimit


Në grafikun nr. 1 vihet re një ulje e vazhdueshme e të ardhurave të përfituara nga renta minerare e GMMD prej vitit 2019 e në vijim, ndërkohë që grafiku nr. 2 mbi ecurinë e rentës minerare për totalin e produktit minerar paraqet një dinamikë të ndryshme. Viti 2022 paraqet pikën më të ulët të gjithë periudhës 4 vjeçare si për sa i takon të ardhurave nga renta minerare e GMMD ashtu edhe në të ardhurat totale të produktit minerar.

Grafiku nr. 2 Ecuria e të ardhurave nga vjelja e rentës për totalin e produktit minerar, 2019-2022.

¹⁵ Ligji nr. 9975 datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar, Neni 4, pika 4

¹⁶ Ligji Nr.10304, datë 15.7.2010 “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 2 pika 23.

**Ecuria e te ardhurave nga renta minerare (total produkti minerar)
per periudhen 2019-2022**



Burimi: AKBN, Përpunoi: Grupi i auditimit

Krahas rentës minerare, subjektet që aplikojnë për leje shfrytëzimi GMMD, paguajnë tarifën e “Akt Verifikimit” dhe “Oponencës” për projektet e shfrytëzimit të objekteve minerare. Tarifa për Akt verifikimin dhe mbikëqyrjen për vlerësimin e kthimit të garancive të investimit janë të përcaktuara sipas rretheve, ndërsa tarifa për oponencën është tarifë fikse në vlerën 800 euro.¹⁷

Tabela nr. 3 Të ardhura nga Tarifat e Akt Verifikimit dhe Oponencës për lejet e shfrytëzimit të GMMD, 2019-2022

Nr	Emërtimi	Njësia	2019	2020	2021	2022	Total
1	Te ardhura nga tarifat e Akt Verifikimit	Leke	548,000	1,185,000	644,000	0	2,377,000
2	Te ardhura nga vjelja e tarifës se Oponencës	Euro	3200	5600	3200	0	12000

Burimi: AKBN, Përpunoi: Grupi i auditimit

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

Subjektet të cilat aplikojnë për leje shfrytëzimi minerar GMMD, kanë detyrimin të aplikojnë edhe për leje mjedisi për shkak të aktivitetit që do të ushtrojnë. Tarifat për aplikimin e Lejes së Mjedisit janë të përcaktuara me VKM. Tarifa përkatëse për shqyrtimin e kërkesës për leje mjedisi tipi B është në vlerën 30.000 lekë, ndërsa tarifa vjetore për instalime të tipit B është në vlerën 5.000 lekë.¹⁸ Të ardhurat e mbledhura nga tarifat e përcaktuara për leje mjedisi dhe tarifa vjetore, janë të pakthyeshme dhe derdhen në buxhetin e shtetit.

Tabela nr. 4 Të ardhura nga tarifat e aplikimit për leje mjedisi dhe tarifa vjetore

Nr	Emërtimi	Njësia	2019	2020	2021	2022	Total
1	Te ardhura nga tarifa e aplikimit për leje mjedisi	Leke	30000	120000	150000	0	300000
2	Te ardhura nga tarifat vjetore të lejeve mjedisore	Leke		90000	130000	190000	410000

Burimi: AKM, Përpunoi: Grupi i auditimit

2.5 Përkufizimet dhe terminologjia

“Minierë” është çdo gërmim mbi ose nën tokë, përfshirë edhe pjesët nën ujë, dhe sterilet, çdo shpim ose pus kërkim-zbulimi, i cili është në punë ose jo, i bërë për qëllim kërkimi, zbulimi ose shfrytëzimi të mineralit, si dhe çdo vend tjetër, ku shfrytëzohet një pasuri minerare, përfshirë këtu zonën minerare

¹⁷ Urdhër nr. 43 datë 28.01.2014, “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve të tarifave në sektorin minerar”

¹⁸ VKM nr.417 datë 25.06.2014 “Për miratimin e tarifave për leje mjedisi”

dhe të gjitha ndërtesat, konstruksionet, strukturat, makineritë, pajisjet, rrugët ose objektet e tjera, të vendosura në një zonë të tillë, të cilat përdoren ose kanë si qëllim të përdoren për kërkimin, zbulimin, shfrytëzimin, përpunimin a përfitimin e një minerali.

“Veprimtari minerare” janë veprimtaritë e kërkimit, të zbulimit, të shfrytëzimit, të përpunimit, të mbylljes, të konservimit dhe të rehabilitimit të mjedisit minerar.

“Karrierë” është çdo vend ku nxirren minerale, drejtpërdrejt nga sipërfaqja, me anë të gërmimit ose të mënyrave të tjera, për të siguruar minerale për ndërtim, tregti e për qëllime industriale ose përpunuese.

“Kërkim minerar” është kryerja e operacioneve dhe e punimeve të nevojshme për kërkimin e mineraleve mbi sipërfaqen e tokës, për nxjerrjen dhe për lëvizjen e kampioneve minerare nga toka në sasi, për analiza, jo për tregti.

“Zbulim minerar” është kryerja e operacioneve të zbulimit, mbi ose nën sipërfaqen e tokës, si puse kërkimi, transhe, punime kërkimi dhe nxjerrja, lëvizja e provave minerare në sasi, për qëllime studimore, jo për tregti.

“Shfrytëzim minerar” është procesi teknologjik, që kryhet për nxjerrjen e një minerali/mineraleve, duke përfshirë kërkimin dhe zbulimin brenda zonës minerare të lejuar.

“Rehabilitim i mjedisit minerar” është tërësia e veprimtarive që përfshijnë rehabilitimin progresiv e përfundimtar të mjedisit të zonës së lejuar minerare, rehabilitimin e sheshit të depozitimit të mbetjeve, si dhe të gjitha veprimtaritë e tjera, që realizon zotëruesi i lejes minerare, për parandalimin e dëmtimit të mjedisit e ndotjeve dhe për të garantuar një rehabilitim të plotë të ekosistemit në përgjithësi në zonën e lejuar minerare.

“Leje minerare” është akti administrativ, për të kryer veprimtari minerare në zonën e lejuar dhe për mineralet e përcaktuara në të.

“Rentë minerare” është përqindja e vlerës së mineralit të thatë të shitur, që i paguhet shtetit nga zotëruesi i lejes minerare, si kompensim për zvogëlimin e burimeve minerare.

“Plani i rehabilitimit të mjedisit” është projekti teknik, i realizuar në përputhje me kërkesat bazë të legjislacionit minerar dhe mjedisor në fuqi, në bazë të një pune studimore- projektuese, që përfshin të gjitha masat, që do të zbatohen për rehabilitimin progresiv e përfundimtar të mjedisit dhe kthimin e tij në gjendje të rehabilituar, rehabilitimin e sheshit të depozitimit të mbetjeve dhe mbylljen e veprimtarisë minerare, vlerën e përgjithshme të garancisë financiare për realizimin e këtij plani, para zhvillimit të veprimtarive minerare, që paraqitet së bashku me dokumentacionin për marrjen e të drejtave minerare.

“Plan vjetor i veprimtarisë minerare” është plani i detajuar, që përfshin tërësinë e veprimtarive që do të realizojë zotëruesi i lejes minerare për zhvillimin e veprimtarisë së tij minerare gjatë vitit në vazhdim, veprimtaritë për rehabilitimin progresiv të mjedisit minerar dhe të sheshit të depozitimit të mbetjeve minerare, mbylljen progresive të veprimtarisë minerare, si dhe vlerën e investimit vjetor që do të realizohet gjatë atij viti, në përputhje me vlerën e investimit të miratuar, sipas projektit të zhvillimit të veprimtarive minerare dhe vlerën vjetore të garancisë financiare për rehabilitimin përfundimtar të mjedisit.

“Kadastra minerare” krijohet nga heqja nga fondi pyjor e kullësor dhe është një regjistër i veçantë inventarizimi sistematik i të dhënave për sendet e paluajtshme, mbështetëse të veprimtarisë minerare, tokë, ndërtesa dhe instalime të sipërfaqes apo nëntokës, në aspektin teknik, ekonomik, dhe të dhëna të tjera për zonat e lejuara minerare, të cilat regjistrohen pas heqjes nga fondi pyjor e kullësor.

“Regjistri minerar” është regjistri që përfshin të gjitha të dhënat për regjimin juridik të sipërfaqeve të zonave minerare dhe të sipërfaqeve fqinje, pronësinë, situatën topografike të zonave minerare e të punimeve mbështetëse të veprimtarisë minerare, për rezervat dhe për prodhimin minerar, si dhe të dhënat për zotëruesin e lejeve minerare.

“Garanci financiare për rehabilitimin e mjedisit” është vlera monetare që depozitohet çdo vit, në formën e një garancie bankare në favor të shtetit, në një bankë të nivelit të dytë në Shqipëri, që përdoret për realizimin e planit të rehabilitimit përfundimtar të mjedisit.

“Garanci financiare për realizimin e programit minimal të punës” është vlera monetare që depozitohet pas marrjes së lejes minerare të kërkim-zbulimit, në formën e një garancie bankare, në favor të shtetit, në një bankë të nivelit të dytë në Shqipëri.

“Garanci financiare për realizimin e investimit” është vlera monetare që depozitohet pas marrjes së lejes minerare të shfrytëzimit, në formën e një garancie bankare, në favor të shtetit, në një bankë të nivelit të dytë në Shqipëri.

“Fond pyjor kombëtar”, që përfaqësohet nga fondi pyjor publik dhe privat, është sipërfaqja e mbuluar me pyje, shkurre, toka me bimësi pyjore, përfshirë edhe sipërfaqet e zhveshura (çeltirat, shkëmbinjtë, dunat dhe ranishtat), sistemet agropyjore, brezat mbrojtës, infrastrukturën përkatëse, si dhe pasuritë jo pyjore bashkëshoqëruese, të cilat krijojnë një mjedis unik me pyjet e tokën pyjore.


“Inventarizimi kombëtar i pyjeve” është procesi që realizon grumbullimin dhe vlerësimin e të dhënave për shtrirjen dhe gjendjen e fondit pyjor kombëtar, të cilat shërbejnë për hartimin e politikave në fushën e pyjeve, për zhvillimin e qëndrueshëm dhe shumë funksional të tyre.

“Taksë” është pagesa e detyrueshme dhe e pakthyeshme në Buxhetin e Shtetit që paguhet nga çdo person apo nëpërmjet një agjenti që ushtron një të drejtë publike apo përfiton një shërbim publik në territorin e Republikës së Shqipërisë.

“Leje mjedisi e tipit B” është leja e përgatitur nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe e firmosur nga ministri, e cila lëshohet nga QKL-ja, që i jep të drejtën e funksionimit, tërësisht ose pjesërisht, instalimit të tipit B. Një leje mund të mbulojë një ose më shumë instalime ose pjesë të instalimeve në të njëjtën vendndodhje dhe që operohen nga një i njëjti operator.

2.6 Skema e analizës së programit auditues

Skema 1: Modeli Input – Output



2.7 Feedback-u i subjektit në fazën studimore

Gjatë fazës studimore dhe fazës së terrenit, stafet përgjegjëse të MIE, MTM, AKM dhe AKBN i janë përgjigjur përgjithësisht në kohë pyetësorëve të dërguar nga grupi i auditimit, ndërsa për plotësimin e informacionit dhe dokumentacionit të kërkuar që lidhet me vjeljen e të dhënave plotësuese mbi tregues dhe indikatorë të ndryshëm, kërkuar më shumë kohë në përgjigjet e tyre kjo edhe për shkak të natyrës dhe kompleksitetit të informacioneve të kërkuara nga grupi i auditimit.

3. DETAJET E AUDITIMIT

3.1 Vlerësimi i risqeve të aktiviteteve të subjektit

Risqet e politikave dhe aktiviteteve të subjekteve të përfshira në këtë auditim, kanë të bëjnë me vështirësitë dhe pengesat që ato hasin në realizimin e detyrave dhe funksioneve të përcaktuara në kuadrin ligjor e rregullator në fuqi. Për të kryer analizën e riskut, jemi mbështetur në analizën SWOT duke marrë në konsideratë risqet e katër fushave në të cilat shtrihet kjo analizë e respektivisht termi SWOT është një akronim për (*Strengths, Weakness, Opportunities and Threats*) Fuqi, Dobësi, Mundësi dhe Kërcënime. Analiza SWOT është një mjet i rëndësishëm që ndihmon në identifikimin e faktorëve që ndikojnë në funksionimin e një institucioni apo procesi të caktuar. Ajo mundëson gjendjen aktuale të subjekteve, për të diagnostikuar me saktësi problemet. Gjatë përdorimit të kësaj analize është e rëndësishme që faktorët që ndikojnë në funksionimin e procesit për të cilën kjo analizë kryhet, jo vetëm të identifikohen por edhe të vlerësohen aty ku është e mundur. Risqet e politikave dhe aktiviteteve të subjekteve të përfshira në këtë auditim, kanë të bëjnë me vështirësitë dhe pengesat që ato hasin në realizimin e detyrave dhe funksioneve të përcaktuara në kuadrin ligjor e rregullator në fuqi. Duke iu referuar kësaj analize, grupi i auditimit ka bërë një ndarje dhe grupim të risqeve të veprimitarisë së institucioneve përkatëse, për të adresuar dhe ndarë faktorët e riskut sipas përkatësisë së tyre, brenda dhe jashtë kontrollit menaxherial. Gjithashtu është bërë edhe kategorizimi i tyre në strategjik, financiar, juridik dhe operacional.

Fig.3 Analiza SWOT




Tabela. 5: Analiza e Riskut


Nr.	Risku i Subjektit	Kategorizimi i riskut	Niveli i Riskut
1	Strategjia Minerare 2010-2025 e pa rishikuar, pa plane veprimi me objektiva konkrete dhe indikatorë të matshëm.	Risk Strategjik	I lartë
2	Mungesa e planifikimit mineralar, studime, analiza kosto përfitim.		I lartë
3	Mungesa e pajisjes së subjekteve të licencuara për shfrytëzim mineralar me leje mjedisi.		I lartë
4	Konfliktet mbi pronësinë e tokës		I mesëm
5	Mungesa e unifikimit të termit “mermer” në ligjin nr. 9975 datë 28.7.2008” Për taksat kombëtare”, i ndryshuar për llogaritjen e rentës.	Risk Financiar	I lartë
6	Ndryshimet në lejet e shfrytëzimit të llojit të mineralit		I mesëm
7	Mungesë e përditësimit të akteve ligjore dhe nënligjore dhe rregullatore.	Risk Rregullator dhe Juridik	I lartë
8	Kapacitete teknike të burimeve njerëzore të limituara.	Risk Operacional	I mesëm
9	Koordinim dhe bashkëveprim i dobët ndërinstytucional.		I mesëm
10	Mungesa e inspektimeve për zbatimin e planit të rehabilitimit të mjedisit.		I lartë
	.		I mesëm

Burimi: Grupi i Auditimit

3.2 Objektivi i auditimit

Auditimi me temë “Performanca e sistemit të shfrytëzimit mineralar të mermerëve” ka si objektivi kryesor vlerësimin dhe analizimin e masave të marra nga institucionet përgjegjëse mbi shfrytëzimin e mineralit të mermerit si dhe impaktin që ato kanë në ekonomi, komunitet dhe mjedis. Në këtë mënyrë është synuar të sigurohet një vlerësim i paanshëm dhe objektivi mbi nismat dhe iniciativat të cilat institucionet përgjegjëse kanë marrë mbi shfrytëzuesit e mermerit. Me anë të këtij objektivi do të konkludohet se deri në çfarë mase ka qenë efektive veprimtaria e institucioneve subjekt auditimi për periudhën 2020-2022.

3.3 Pyetjet e auditimit



3.4 Fushëveprimi i auditimit

Ky auditim ka patur si fushëveprimi analizimin dhe dhënien e një opinioni mbi respektimin dhe përmirësimin e kriterëve ligjore e rregullatore me qëllim ruajtjen e ekuilibrave midis subjekteve që shfrytëzojnë mermerin por dhe ndikimeve ekonomike, sociale e mjedisore. Në kuadër të këtij auditimi janë vizituar disa aktivitete që shfrytëzojnë mermerin në disa zona të ndryshme si për shembull Mëlova në Skrapar, Kapshticë, Ersekë dhe Lepenicë në Vlorë. Më konkretisht, mbi aktivitetin e shfrytëzimit mineral të mermerëve, krahas përlllogaritjes së rentës minerare dhe ecurisë së saj ndër vite, janë adresuar çështje që kanë të bëjnë me menaxhimin e fondit pyjor, planin e rehabilitimit të mjedisit, monitorimin dhe kontrollin e zotëruesve të lejeve minerare për shfrytëzimin e mermerit si dhe lejeve të mjedisit. Institucionet subjekt auditimi kanë qenë MIE, MTM, AKM dhe AKBN sa i përket kontrollit dhe respektimit të kriterëve dhe standardeve të aktivitetit të shfrytëzimit të mermerëve. Periudha objekt auditimi siç është theksuar dhe më sipër është 2020-2022, megjithatë janë pasqyruar edhe të dhëna historike jashtë kësaj periudhe për të dhënë një panoramë më të qartë të ecurisë së treguesve të ndryshëm.

4. SHTJELLIMI I PYETJEVE DHE NËNPYETJEVE

Pyetja kryesore: A kanë rezultuar të mjaftueshme masat e marra nga institucionet përgjegjëse mbi përmirësimin e shfrytëzimit të mermerëve dhe ndikimeve të tyre në ekonomi, komunitet dhe mjedis?

Mesazhi i auditimit

Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse të nxisin një qasje të përgjegjshme ndaj menaxhimit të burimeve minerare dhe mbrojtjes së mjedisit, duke kërkuar një harmonizim të ligjit, përdorimin e teknologjisë dhe praktikave të mira për të siguruar një përdorim efektiv dhe të qëndrueshëm të këtyre burimeve. Përdorimi i instrumenteve të nevojshëm është detyrë parësore e tyre me qëllim maksimizimin e vjeljes së rentës minerare, sinkronizimin e legjislacionit minerar me atë të taksave kombëtare, marrjen e masave të nevojshme për miratimin e heqjes nga fondi pyjor të sipërfaqeve pyjore të dhëna për shfrytëzim si dhe kryerjen e rehabilitimit progresiv mjedisor aty ku është e mundur.

4.1 A garantojnë politikat kombëtare maksimizimin e përfitimit publik nga veprimtaria minerare e shfrytëzimit të mermerëve?

4.1.1 A janë hartuar dhe zbatuar politika dhe objektiva të përshtatshme në funksion të shfrytëzimit të mermerëve?

Strategjia Minerare e Republikës së Shqipërisë

Strategjia minerare është dokumenti themelor, që përcakton politikat, përparësitë e zhvillimit, programet e veprimit dhe të administrimit të burimeve minerare për një periudhë 15 vjeçare. Strategjia minerare propozohet nga ministri dhe miratohet nga Këshilli i Ministrave.¹⁹ Me anë të VKM-së nr. 479 datë 29.06.2011 është miratuar Strategjia Minerare e Republikës së Shqipërisë e cila mbulon një periudhë 15 vjeçare (2010-2025). Në këtë strategji shpaloset vizioni i Qeverisë Shqiptare mbi prioritetet strategjike si dhe objektivat strategjike në sektorin minerar. Objektivat strategjike janë të ndara në objektiva afat-shkurtra, afat-mesme dhe afat-gjatë. Zhvillimi i qëndrueshëm i sektorit minerar përbën thelbin e vizionit të kësaj strategjie duke marrë parasysh impaktet ekonomike, sociale e mjedisore bazuar mbi parimet e ndarjes së të ardhurave midis të gjitha niveleve të qeverisjes, kompanive dhe komuniteteve²⁰ parime që nëse do të respektohen me kujdes do të çojnë në një situatë “win-win-win” (fitoj-fitoj-fitoj). Pra, një situatë fituese për të treja palët (qeveri, privat dhe komunitet) e cila është rezultat i një qasjeje të përfitimeve të ndërsjellta ndaj negociatave, në të cilën palët punojnë së bashku për të përmbushur interesat dhe për të maksimizuar krijimin e vlerës. Në një negociatë ose situatë fituese, kur palët janë të kënaqura me marrëveshjen e tyre, shanset për një sukses afatgjatë janë shumë më të larta.²¹

Misioni i kësaj strategjie është garantimi i një strukture minerare eficiente nga pikëpamja ekonomike duke synuar rritje të mirëqenies dhe të ardhurave të shtetasve shqiptarë, duke nxitur dhe mbështetur rritjen e prodhimit vendas, shtimin e vlerës së tyre dhe mbi të gjitha punësimin e vendasve. Aktiviteti minerar është një burim i madh punësimi në mënyrë të veçantë në zonat rurale. Në periudhën e hartimit të Strategjisë Minerare (në vitin 2010) siç theksohet në faqen 8 të saj, në industrinë minerare numëroheshin rreth 7100 të punësuar me mundësi shumë më të larta në vitet e ardhshme. Shtimi i numrit të të punësuarve vendas në sektorin minerar ndër të tjera ka qenë një synim i kësaj strategjie për të luftuar gjithashtu edhe migrimin e popullsisë. Nëse do të shikojmë situatën sot, nga të dhënat zyrtare të AKBN-së, numri i të punësuarve në sektorin minerar është 5497 (nga të cilët vetëm 239 në

¹⁹ Ligji nr. 10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, neni 7

²⁰ Strategjia Minerare e Republikës së Shqipërisë, fq 6

²¹https://www.google.com/search?q=win+win+win+situation&oq=win+win+win&gs_lcrp=EgZjaHJvbWUqBwgFEAAAYgAQyCggAEAAAY4wIYgAQyBwgBEC4YgAQyBwgCEAAAYgAQyBwgDEAAAYgAQyBwgEEAAAYgAQyBwgFEAAAYgAQyBggGEEUYPDIGCAcQRRg80gEINTcwN2owajeoAgCwAgA&sourceid=chrome&ie=UTF-8

sektorin e shfrytëzimit të mermerit) dhe migrimi i popullsisë veçanërisht në zonat rurale ku kryhet aktiviteti i shfrytëzimit mineral por dhe atij të mermerit është një plagë e madhe e cila sapo ka filluar të japë efektet e para. Kjo situatë vërtetohet edhe me punësimin e punëtorëve me kombësi të huaj në shumë prej subjekteve të shfrytëzimit të mermerit që operojnë sot në treg. Mungesa e fuqisë punëtore veçanërisht asaj vendase, është edhe një nga shqetësimet kryesore të subjekteve që shfrytëzojnë sot mineralin e mermerit.

Për vlerësimin e Strategjisë Minerare të Republikës së Shqipërisë, bazuar në faktin që qëllimi final i saj është rritja e mirëqenies së shtetasve shqiptarë nëpërmjet rritjes së të ardhurave që krijon veprimtaria minerare, janë përcaktuar një sërë indikatorësh vlerësues dhe konkretisht:

- Prodhimi i mineraleve në ton;
- Prodhimi i mineraleve në vlerë;
- Vlera e investimeve në industrinë minerare;
- Sasia e produkteve të eksportuara;
- Numri i punonjësve në industrinë minerare.

Këto indikatorë të cituar më sipër, mbulojnë një periudhë deri në vitin 2013 dhe jo të gjithë periudhën për të cilën kjo strategji është hartuar dhe miratuar. Në mungesë të mbulimit të të gjithë periudhës së kësaj strategjie me indikatorë matës është e pamundur që të vlerësohet mbi arritjet e saj si dhe me vlerësimin nëse objektivat e saj janë realizuar apo jo. Pra, pavarësisht vendosjes së objektivave afatgjata në këtë strategji, indikatorët (të cilët janë edhe instrumentet vlerësues të objektivave) mbulojnë vetëm një periudhë afat-shkurtër (viti 2013). Këtë e dëshmon edhe më shumë Kapitulli “Programi i Veprimit” në fund të kësaj strategjie, i cili gjithashtu nuk shkon përtej vitit 2013.

Megjithatë, u kërkuan nga subjektet nën auditim evidenca të tjera lidhur me monitorimin e vazhdueshëm të Strategjisë Minerare të Republikës së Shqipërisë për të parë nëse janë përgatitur Raporte apo Relacione periodike mbi zbatimin e objektivave/masave të përcaktuara në këtë strategji. Nga përgjigjet e subjekteve rezulton se nuk janë përgatitur raporte/relacione të tilla dhe kjo gjë as nuk është përcaktuar në Strategjinë Minerare. Raportet e vetëm periodikë që realizohen janë raportet mbi veprimtarinë minerare të subjekteve që kanë leje minerare dhe që realizohen cdo vit nga AKBN, por këto raporte nuk kanë si qëllim të përshkruajnë dhe vlerësojnë masat dhe objektivat e përcaktuara në Strategjinë Minerare të Shqipërisë.

Praktika të mira mbi strategjitë minerare

Një ndër vendet evropiane lider sa i përket industrisë minerare është edhe Suedia. Përtej vizionit dhe objektivave të Qeverisë së Suedisë të cilat shpalosen në Strategjinë Minerare të Suedisë “Për përdorimin e qëndrueshëm të burimeve minerare të Suedisë”, një ndër parimet kryesore mbi të cilat ajo është konceptuar është ndërveprimi i saj si një instrument për dialog, bashkëpunim dhe zhvillim për Suedinë. Pesë objektivat strategjikë të Strategjisë Minerare të Suedisë²² janë:

- Industri minerare në harmoni me mjedisin, vlerat kulturore dhe llojet e tjera të biznesit;
- Dialog dhe bashkëpunim për të promovuar inovacionin dhe zhvillimin;
- Kornizë ligjore dhe infrastrukturë për rritjen e konkurrencës dhe zhvillimit;
- Industri minerare inovative me njohuri të shkëlqyera në këtë sektor;
- Një industri e njohur ndërkombëtare, aktive dhe tërheqëse e minierave dhe mineraleve.

Lidhur me Planin e Veprimit dhe Monitorimin e Strategjisë Minerare të Suedisë një nga masat kryesore të propozuara është edhe themelimi i një forumi ose strukture për monitorimin e zbatimit të saj. Një nga detyrat e kësaj strukture është edhe vlerësimi i masave të ndërmarra me qëllim arritjen e rezultateve të përcaktuara në objektivat e kësaj strategjie. Në përfundim të saj, detajohen gjithashtu një sërë propozimesh apo rekomandimesh me qëllim optimizimin dhe maksimizimin e përfitimeve në sektorin mineral.

²² <https://www.government.se/contentassets/78bb6c6324bf43158d7c153ebf2a4611/swedens-minerals-strategy.-for-sustainable-use-of-swedens-mineral-resources-that-creates-growth-throughout-the-country-complete-version>

Kuadri ligjor mbi shfrytëzimin e mermerit

Ligji nr. 10304, datë 15.7.2010 “Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë” përcakton rregullat për zhvillimin e veprimtarive minerare e postminerare dhe ka për qëllim nxitjen e veprimtarisë minerare, rritjen maksimale të përfitimit publik nga veprimtaria minerare dhe mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit publik nga rreziku mineral. Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare” përcakton llojet e taksave dhe tarifave kombëtare që zbatohen në Republikën e Shqipërisë, nivelin e taksave kombëtare, procedurat e llogaritjes, të arkëtimit dhe transferimit në Buxhetin e Shtetit ose në buxhetin e njësisë të qeverisjes vendore të taksave dhe tarifave kombëtare. Një ndër taksat kryesore që subjektet që shfrytëzojnë mermerin janë të detyruar të paguajnë është edhe taksa e rentës minerare. Taksa e rentës minerare si pjesë e taksave kombëtare përcaktohet sipas shtojcës nr. 2, që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij. Edhe pse për llogaritja e taksës së rentës minerare dhe të ardhurat në buxhetin e shtetit nga renta minerare për aktivitetin e shfrytëzimit të mermerit do të trajtohet gjerësisht në pyetjen audituese pasuese, këtu do të analizohet harmonizimi i Ligjit nr. 10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë” me Ligjin nr.9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”. Nga evidencat e grumbulluara nga grupi i auditimit është vënë re se në Ligjin mineral nuk ka një përcaktim dhe përkufizim të qartë mbi terminologjinë e mineralit të mermerit. Gjithashtu, lejet minerare (të cilat bazohen në Ligjin mineral) janë të emërtuara si më poshtë:

- Gëlqeror i mermerizuar;
- Gëlqeror dekorativ;
- Gëlqeror;
- Gëlqeror masiv;
- Gëlqeror Organogjeno Coprizor.

Po të vërejmë me kujdes shtojcën nr. 2 të Ligjit për Taksat Kombëtare gjejmë emërtimin “mermer”, ndërsa në Ligjin mineral dhe lejet minerare që jepen bazuar në këtë ligj ky emërtim nuk ekziston. Ajo që ndodh në praktikë është që lejet minerare me emërtimin “Gëlqeror i mermerizuar” futen në grupin e IV të Materialet e Ndërtimit dhe konsiderohen si “mermer” sipas Ligjit për Taksat Kombëtare. Pra, në Ligjin për Taksat Kombëtare përdoret termi mermer ndërsa në Ligjin mineral ky term nuk përdoret.

Sigurimi i punonjësve nga aksidentet në punë

Një tjetër çështje me rëndësi e trajtuar në këtë auditim është edhe sigurimi i punonjësve nga aksidentet në punë në aktivitetin mineral të shfrytëzimit të mermerëve. Nga të dhënat e siguruara, është evidentuar se subjekte të ndryshme që operojnë në sektorin e shfrytëzimit të mermerit nuk i kanë siguruar të gjithë punonjësit me sigurimin e jetës me arsyetimin se disa pozicione pune (ekonomist, jurist etj.) nuk e kanë të nevojshme këtë lloj sigurimi. Për këtë arsye, grupi i auditimit ka kërkuar nga subjektet nën auditim nëse ka kritere të qarta e të përcaktuara mbi detyrimet e subjekteve që operojnë në këtë sektor për të siguruar me sigurim jete punonjësit nga aksidentet në punë. Lidhur me këtë, nga AKBN u vu në dispozicion Urdhri i Drejtorit Ekzekutiv të AKBN-së me nr. 122 datë 05.06.2023 “Për miratimin e Rregullores për Organizimin dhe funksionimi e Komisionit për shqyrtimin e dokumentacionit dhe miratimit të Planit Vjetor të Punës të zotëruesve të lejeve minerare të shfrytëzimit dhe përpunimit”. Ky Urdhër ka si qëllim të përcaktojë rregullat dhe detyrat e hollësishme të këtij Komisioni gjatë miratimit të planit vjetor të ushtrimit të aktivitetit mineral nga ana e zotëruesve të lejeve minerare. Në shtojcën 2, Kreu III, pika 4 të Urdhrit të Drejtorit Ekzekutiv të AKBN-së me nr. 122 datë 05.06.2023 citohet se “Për minierat sipërfaqësore (ku bëjnë pjesë edhe aktiviteti i mermerit) duhet të jenë të pajisur me sigurime jete jo më pak se 3 punonjës”. Ky është i vetmi kriter që është i përcaktuar në kuadrin ligjor/rregullator. Nga rishikimi i kuadrit ligjor/rregullator nuk ekziston asnjë kriter që të detyrojë subjektet të sigurojë me sigurim jete punonjësit sipas pozicioneve të punës që ata kanë.

Gjetje nga auditimi 1:

Strategjia minerare e Republikës së Shqipërisë është e mangët, pa indikatorë matës për të gjithë periudhën e veprimtarisë së saj (2010-2025) për disa aspekte të ndryshme si për shembull vlera e investimeve në sektorin minerar, numri i punonjësve të punësuar në sektorin minerar dhe nën sektorët e tij etj. Lidhur me Monitorimin dhe Raportimin mbi ecurinë e Strategjisë Minerare të Shqipërisë nuk është përgatitur asnjë Relacion/Raport që të dëshmojë mbi synimet dhe objektivat e saj. Në Strategjinë Minerare të Shqipërisë nuk përcaktohet ngritja dhe detyrimi i ndonjë strukture për të monitoruar treguesit e saj, ndryshe sa përcaktohet në Strategjinë Minerare të Suedisë.

Gjetje nga auditimi 2:

Ligji minerar dhe Ligji për Taksat Kombëtare nuk janë të harmonizuar me njëri-tjetrin sa i përket përdorimit të terminologjisë mbi mineralin e mermerit. Në Ligjin minerar nuk përdoret emërtimi “mermer”, por gëlqeror i mermerizuar, ndryshe nga Ligji për Taksat Kombëtare i cili përdor emërtimin “mermer” në shtojcën nr. 2 të tij dhe për të cilin ka të përcaktuar edhe vlerën prej 4095 lek/m³. Kjo situatë sjell një konfuzion në përkufizimin e qartë të termit të mermerit e cila evidentohet edhe në përlllogaritjen e rentës minerare për subjektet që shfrytëzojnë GMMD.²³

Gjetje nga auditimi 3:

Nga të dhënat e AKBN-së evidentohet se subjektet që shfrytëzojnë mermerin nuk i kanë të siguruar me siguri jete të gjithë punonjësit e tyre me justifikimin se jo të gjitha pozicionet e kanë të domosdoshme këtë lloj sigurimi. Kuadri ligjor e rregullator mbi shfrytëzimin minerar të mermerit nuk përcakton asnjë kriter mbi pozicionet e punës të cilat duhet të mbulohen me siguri jete nga aksidentet në punë.

Konkluzione

1. Mungesa e monitorimit të vazhdueshëm mbi zbatimin e objektivave të Strategjisë Minerare ndikon në vlerësimin dhe gjykimin objektiv mbi arritjen e rezultateve të parashikuara në Strategji.
2. Ligji Minerar dhe Ligji për Taksat Kombëtare nuk janë në sinkron me njëri-tjetrin sa i përket përkufizimit të termit “mermer” dhe kuadri ligjor e rregullator nuk është i qartë sa i përket pozicioneve të punës të cilat duhet të sigurohen me siguri jete nga aksidentet në punë në aktivitetin minerar të mermerit.

1.1 Rekomandimi:

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në hartimin e Strategjisë së re Minerare, të marrë masa për përcaktimin e indikatorëve për gjatë gjithë periudhës kohëzgjatjes së saj si dhe të përcaktojë qartë njësinë apo strukturën e cila do të monitorojë periodikisht atë.

Me miratimin e Strategjisë së re Minerare

2.1 Rekomandimi:

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë të marrë masa për harmonizimin dhe unifikimin e përkufizimit dhe përcaktimit të qartë të mineralit të mermerit në ligjin minerar dhe atë për taksat kombëtare.

Në vazhdimësi

3.1 Rekomandimi:

Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore të marrë masa për të përditësuar kuadrin ligjor e rregullator duke vendosur kritere të qarta lidhur me sigurinë e detyrueshëm me siguri jete nga aksidentet në punë në varësi të pozicioneve të punës në aktivitetet e shfrytëzimit minerar.

Mars 2024

²³ Shënim: Përlllogaritja dhe të ardhurat nga renta minerare do të analizohen në pyetjen audituese nr. 4.1.2

4.1.2 Si ka qenë ecuria e të ardhurave të realizuara nga sektori i shfrytëzimit të mermerëve?

Rritja e të ardhurave nga aktiviteti ekonomik i lidhur me shfrytëzimin e burimeve natyrore është praktikisht një fenomen universal midis kombeve të botës.²⁴ Sipas një publikimi të Institutit Gjerman të Zhvillimit dhe Qëndrueshmërisë (IDOS), taksimi i burimeve jo të rinovueshme është një çështje shumë politike, që përfshin aktorë të fuqishëm vendas dhe ndërkombëtarë, si në sektorin privat ashtu edhe në atë publik. Një burim kyç i qeverisë në këtë kontekst është besueshmëria që lind kur rregullat dhe rregulloret që rregullojnë sektorin janë të qarta dhe fondet e mbledhura përdoren në mënyrë transparente për interesin e përbashkët.²⁵ Në Republikën e Shqipërisë taksimi i burimeve natyrore është rregulluar me Ligjin nr. 9975 datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar. Taksa e rentës minerare është pjesë e taksave kombëtare. Ajo llogaritet si detyrim mujor i subjektit taksapagues në çastin që ai shet produkte minerare.²⁶ Çdo person fizik apo juridik që është i licencuar dhe vepron në industrinë minerare, sipas një marrëdhënie kontraktuale, duhet të paguajë rentë minerare për burimet natyrore që nxjerr nga/mbi dhe nëntoka e Republikës së Shqipërisë²⁷. Renta minerare është përqindja e vlerës së mineralit të thatë të shitur, që i paguhet shtetit nga zotëruesi i lejes minerare, si kompensim për zvogëlimin e burimeve minerare.²⁸ Referuar Ligjit nr. 9975 datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar, taksa e rentës minerare për sektorin GMMD, aplikohet në vlerë fikse për njësi. Kur taksa e rentës minerare aplikohet në vlerë fikse për njësi, shuma e rentës minerare llogaritet duke shumëzuar sasinë e shitjes së produktit me vlerën e rentës minerare.²⁹

Analiza SWOT

Gjatë auditimit jemi përpjekur të analizojmë ecurinë e të ardhurave të realizuara nga sektori i shfrytëzimit të mermerit nga vjelja e rentës minerare, nëpërmjet përdorimit të modulit SWOT, nisur nga fakti që kjo analizë ofron mundësinë e një menaxhimi më të mirë të këtij problemi kompleks dhe dinamik. Nëpërmjet analizës kemi evidentuar fuqitë, dobësitë, mundësitë dhe kërcënimet që shoqërojnë ecurinë e rentës minerare në sektorin e shfrytëzimit GMMD.

S

-Historiku i industrisë minerare
-Burime minerare të pasura.
-Ligji Nr.10304, datë 15.7.2010 “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”
-Praktika të mira
-Ecuria në rritje e prodhimit dhe e të ardhurave nga shitja e GMMD

W

-Mungesa e përcaktimit të qartë të llojit të mineralit.
-Koordinim në nivel të ulët mes institucioneve të përfshira për rentën minerare.
-Sistem monitorimi i pamjaftueshëm.

O

-Investimi nga sektori privat në fushën e kërkim zbulimit dhe shfrytëzimit të mineraleve
-Potenciali i lartë i shfrytëzimit të mermerit, nisur nga kërkesa në tregun vendas dhe exportit.
-Të ardhura të larta nga vjelja e rentës për mineralin e mermerit.
-Tregu në rritje i sektorit minerar në tërësi.

T

-Mungesa e unifikimit të termit “mermer” në kuadrin ligjor aktual.
-Mungesa e një analize të thelluar kosto përfitim për rentën minerare në mënyrë specifike për mermerin.
-Mungesa e koordinimit dhe shkëmbimit të të dhënave financiare mbi rentën mes institucioneve të caktuara për vjeljen e saj dhe AKBN.
Kërkesa për ndryshimin e emërimit të mineralit në Akt Miratimin e lejeve të shfrytëzimit .

Burimi: Grupi i auditimit

²⁴ <https://documents1.worldbank.org/curated/en/974521468739320152/pdf/multi0page.pdf>

²⁵ <https://www.idos-research.de/en/briefing-paper/article/taxation-of-non-renewable-natural-resources-what-are-the-key-issues>

²⁶ Ligji nr. 9975 datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar.

²⁷ Ligji nr. 9975 datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar, Neni 4, pika 4

²⁸ Ligji Nr.10304, datë 15.7.2010 “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë ” i ndryshuar


²⁹ Ligji nr. 9975 datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar, Neni 4, pika 4

Ecuria e rentës minerare në Sektorin e GMMD

Në Sektorin e Shfrytëzimit të GMMD, për periudhën objekt auditimi 2020-2022 vihet re një rritje e subjekteve të cilat janë pajisur me leje shfrytëzimi. Nga të dhënat e vëna në dispozicion, nga AKBN (email nga AKBN datë 13.10.2023) rezulton se gjatë vitit 2020 ka pasur 25 leje aktive, në vitin 2021, 28 të tilla dhe në fund të vitit 2022 32 leje shfrytëzimi, të cilat sipas përcaktimit të mineralit, rezultojnë si më poshtë:

- 20 subjekte me leje shfrytëzimi për Gëlqeror i mermerizuar;
- 8 subjekte me leje shfrytëzimi për Gëlqeror dekorativ;
- 2 subjekte me leje shfrytëzimi për Gëlqeror;
- 1 subjekt me leje shfrytëzimi për Gëlqeror masiv;
- 1 subjekt me leje shfrytëzimi për Gëlqeror Organogjeno Coprizor.

Grafiku nr. 3 Lejet minerare të shfrytëzimit në Sektorin GMMD viti 2022



Burimi: AKBN

Përpunoi: Grupi i Auditimit

Siç vihet re edhe nga grafiku i mësipërm:

63% e lejeve të shfrytëzimit në Sektorin GMMD i takojnë Gëlqerorit të mermerizuar;

25% e lejeve të shfrytëzimit në Sektorin GMMD i takojnë Gëlqerorit dekorativ;

12% e lejeve të shfrytëzimit në Sektorin GMMD i takojnë mineralit Gëlqeror, gëlqeror masiv dhe Gëlqeror Organogjeno Coprizor.

Rritja e numrit të subjekteve që operojnë në sektorin GMMD sjell edhe një ecuri të mirë në prodhimin e realizuar gjatë periudhës objekt auditimi.

Tabela nr. 6 Prodhimi (në m³) GMMD i realizuar

Lloji i Mineralit	Njësia	Prodhimi (m ³)		
		viti 2020	viti 2021	viti 2022
GMMD	m ³	12,537.24	19,805.77	27,279.06

Burimi: AKBN

Përpunoi: Grupi i Auditimit

Nga të dhënat e mësipërme, prodhimi i raportuar në m³ për vitet 2020-2022 rezulton si më poshtë:

- Gjatë vitit 2021 në raport me vitin 2020, prodhimi i GMMD është rritur rreth 58%. Nga 12.537,24 m³ prodhuar në vitin 2020 në 19.805,77 m³ gjatë vitit 2021.
- Gjatë vitit 2022 në raport me vitin 2020, prodhimi i GMMD është rritur rreth 118%. Nga 12.537,24 m³ prodhuar në vitin 2020 në 27279.06 m³ gjatë vitit 2022.

Rritja e numrit të subjekteve që janë pajisur me leje shfrytëzimi në sektorin e GMMD, e shoqëruar edhe me rritjen e prodhimit të mineralit, ka sjellë një rritje të lartë të të ardhurave të realizuar nga shitja si në tregun vendas ashtu edhe në eksportin e mineralit.

Tabela nr. 7 Të ardhurat në sektorin GMMD dhe renta minerare

Nr	Emertimi	Njësia	viti 2020	viti 2021	viti 2022
1	Volumi i produktit GMMD të shitur	m ³	11,011	18,880	24,927
2	Të ardhura nga shitjet brenda vendit GMMD	Lekë	137,208,330.80	108,652,582.70	160,824,824.40
3	Të ardhura nga eksportet GMMD	Lekë	92,846,095.00	359,169,117.80	431,330,343.90
4	Totali i të ardhurave(1+2)	Lekë	230,054,425.80	467,821,700.50	592,155,168.30
5	Renta minerare	Lekë	13,320,612.00	9,435,064.85	8,888,552.00

Burimi: AKBN

Përpunoi: Grupi i Auditimit

Të ardhurat e realizuara nga shitjet brenda vendit kanë pësuar një ulje gjatë vitit 2021 por paraqesin një trend rritës në fund të vitit 2022. Ndërkohë vihet re një rritje e madhe e të ardhurave të realizuara nga eksportet për periudhën objekt auditimi.

- Gjatë vitit 2021 të ardhurat nga eksporti janë rritur në masën 237.767.274,70 lekë ose rreth 103% më shumë në raport me vitin 2020.
- Gjatë vitit 2022 të ardhurat nga eksporti janë rritur në masën 338.484.248,90 lekë ose rreth 147% më shumë në raport me vitin 2020.


Në total të ardhurat nga shitjet brenda vendit dhe eksportet në fund të vitit 2022 janë rritur në masën 362.100.742,50 lekë ose 157% në raport me vitin 2020.

Ndërkohë që ecuria e prodhimit të produktit mineral dhe të ardhurat e realizuara nga shitja e tij paraqesin një trend shumë pozitiv, renta minerare e vjelë nga sektori GMMD paraqet një trend zbritës.

- Gjatë vitit 2021 të ardhurat e vjela nga shteti nga renta minerare pësojnë një rënie në masën 3,885,547,15 lekë ose rreth 29 % më pak në raport me vitin 2020.
- Gjatë vitit 2022 të ardhurat e vjela nga shteti nga renta minerare pësojnë një rënie në masën 4,432,060 lekë ose rreth 33 % më pak në raport me vitin 2020.

Pra, siç mund të vihet re, volumi i produktit të shitur (në m³) gjatë periudhës objekt auditimi ka pësuar rritje nga 11,011 m³ në vitin 2020 në 24,927 m³ në vitin 2022. Në të njëjtën kohë, renta minerare e cila përlllogaritet mbi volumin e produktit të shitur ka pësuar rënie.

Grafiku nr. 4 Paraqitja grafike e ecurisë së volumit (m³) të shitur të GMMD dhe rentës minerare



Burimi: AKBN

Përpunoi: Grupi i Auditimit

Pasojat e mungesës së unifikimit të termit “mermer” në kuadrin ligjor aktual

Në Ligjin nr. 9975 datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar, Shtojca 2, Renta Minerare sipas klasifikimit Grupi IV, Mineralet dhe Materialet e Ndërtimit, janë 3 kategori që i përkasin GMMD, mbi bazën e të cilave kryhet përlllogaritja e rentës minerare që paguajnë subjektet. Tarifa e rentës minerare për secilin prej tyre është:

- Për Gëlqerorët - 47 lekë/m³
- Për Mermerin - 4095 lekë/m³
- Për gjithë mineralet e tjera të grupit të katërt - 104 lekë/m³³⁰

Sa i takon pagesës së rentës minerare nga ana e subjekteve që kanë leje shfrytëzimi në sektorin e GMMD rezultojnë vlera të ndryshme, megjithëse Akt Miratimi i lejes përmban të njëjtin emërtim minerali. Kështu, subjekte që janë të pajisur me leje shfrytëzimi minerar “Gëlqeror i mermerizuar” paguajnë rentë të ndryshme. E njëjta situatë paraqitet edhe për emërtimin “Gëlqeror dekorativ”. AKBN ka konfirmuar se përlllogaritjet e rentës minerare për llojet e ndryshme të mineraleve brenda GMMD janë si më poshtë:

- Gëlqeror i mermerizuar; 4,095 lekë/m³
- Gëlqeror dekorativ; 104 lekë/m³
- Gëlqeror masiv; 104 lekë/m³
- Gëlqeror; 47 lekë/m³
- Gëlqeror organogjen coprizor 104 lekë/m³

Nga ana tjetër, nga Raportet Vjetore të AKBN-së evidentohet se disa subjekte përgjatë periudhës objekt auditimi (2020-2022) edhe pse kanë të njëjtin emërtim të lejes minerare si për shembull “Gëlqeror i mermerizuar” nuk e paguajnë rentën minerare me 4095 lekë/m³. E njëjta gjë ndodh edhe me disa subjekte të cilat kanë emërtimin “Gëlqeror dekorativ” të cilët nuk e paguajnë rentën minerare me 104 lekë/m³. Më konkretisht:³¹

³⁰ Ligji nr. 9975 datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar, Shtojca 2

³¹ Siç theksohet edhe më poshtë, për të gjitha të dhënat në këtë rubrikë, grupi i auditimit është bazuar në të dhënat respektive të deklaruara nga AKBN në Raportet Vjetore 2020-2022 duke qenë se të dhënat e vëna në dispozicion nga AKBN përgjatë auditimit kanë qenë kontradiktore.

- Për vitin 2020, subjekti “A.” sh.p.k. me Leje Minerare “Gëlqeror i mermerizuar” me nr. 1866 datë 26.09.2018 rezulton të ketë shitur 130.8 m³ dhe të ketë paguar 5,232 lekë rentë minerare do të çka thotë që ky subjekt e ka paguar rentën minerare për këtë me vit 40 lekë/m³.
- Për vitin 2020, subjekti “B. C.” sh.p.k. me Leje Minerare “Gëlqeror i mermerizuar” me nr. 1835 datë 30.06.2017 rezulton të ketë shitur 226 m³ dhe të ketë paguar 561,327 lekë rentë minerare, çka do të thotë që ky subjekt e ka paguar rentën minerare për këtë vit me 2483 lekë/m³.
- Për vitin 2021, subjekti “D. V.” sh.p.k. me Leje Minerare “Gëlqeror i mermerizuar” me nr. 1225/1 datë 24.12.2012 rezulton të ketë shitur 50.3 m³ dhe të ketë paguar 83,700 lekë rentë minerare, çka do të thotë që ky subjekt e ka paguar rentën minerare për këtë vit me 1664 lekë/m³.
- Për vitin 2021, subjekti “E. M.” me Leje Minerare “Gëlqeror dekorativ” me nr. 1912 datë 07.06.2021 rezulton të ketë shitur 115 m³ dhe të ketë paguar 7,004 lekë rentë minerare c’ka do të thotë që ky subjekt e ka paguar rentën minerare për këtë vit me 61 lekë/m³.
- Për vitin 2021, subjekti “P.” sh.p.k. me Leje Minerare “Gëlqeror i mermerizuar” me nr. 1853 datë 25.01.2018 rezulton të ketë shitur 55 m³ dhe të ketë paguar 2,570 lekë rentë minerare c’ka do të thotë që ky subjekt e ka paguar rentën minerare për këtë vit me 47 lekë/m³.
- Për vitin 2022 subjekti “P.” sh.p.k. me Leje Minerare “Gëlqeror i mermerizuar” me nr. 1853 datë 25.01.2018 rezulton të ketë shitur 55 m³ dhe të ketë paguar 2,570 lekë rentë minerare c’ka do të thotë që ky subjekt e ka paguar rentën minerare për këtë vit me 47 lekë/m³.
- Sa i përket vitit 2022, lidhur me subjektin “M. C.” sh.p.k. me Leje Minerare “Gëlqeror dekorativ” me nr. 1790/1 datë 22.01.2016 sipas të dhënave të AKBN (email datë 09.10.2023) rezulton të ketë shitur 860 m³ dhe të ketë paguar 41,526 lekë rentë minerare c’ka do të thotë që ky subjekt e ka paguar rentën minerare për këtë vit me 49 lekë/m³. Për të njëjtin subjekt dhe për të njëjtin vit, sipas të dhënave të AKBN (email datë 13.10.2023) rezulton të ketë shitur 880 m³ dhe të ketë paguar 91,609 lekë rentë minerare c’ka do të thotë që ky subjekt e ka paguar rentën minerare për këtë vit me 104 lekë/m³. Ndërsa, në Raportin Vjetor të AKBN-së për vitin 2022, subjekti “M. C.” sh.p.k. rezulton të ketë shitur 0 m³ material dhe rrjedhimisht nuk ka paguar asnjë lek mbi rentën minerare.
- Subjekti “S. P.” me Leje Minerare “Gëlqeror i mermerizuar” me nr. 862/2 datë 26/05/2005 për gjatë gjithë periudhës 2020-2022, e ka paguar rentën minerare me 104 lekë/m³.

Për trajtimin e treguesve mbi rentën minerare, grupi i auditimit ka punuar mbi disa të dhëna të ndryshme të vëna në dispozicion nga AKBN përgjatë këtij auditimi. Që prej fazës studimore, dhe më tej gjatë fazës së terrenit, të dhënat e AKBN-së³² mbi volumin e shitur të subjekteve dhe vlerën e rentës minerare kanë qenë të ndryshme ç’ka ka detyruar grupin e auditimit për disa lloje të dhënash t’i referohet Raportëve Vjetore të AKBN-së.

Tendenca e subjekteve të GMMD për ndryshimin e emërtimit të mineralit në Lejet Minerare

Në zonën e Mëlovës të rrethit Skrapar janë dhënë 10 leje minerare, të cilat fillimisht të gjitha kanë qenë me emërtimin e mineralit “Gëlqeror i mermerizuar”. Të gjithë këto subjekte shfrytëzojnë të njëjtin formacion gjeologjik. Sipas konfirmimit nga AKBN “ky vendburim, në tërësinë e tij, përbëhet nga depozitime karbonatike të përfaqësuar nga Gëlqerorë Bllokore me veti fiziko - mekanike shumë të mira, dekorative për përdorim në fushën e ndërtimit”. Për periudhën objekt auditimi 2020-2022 pagesa e rentës nga secili subjekt që ka kryer aktivitet në vendburimin Melovë, të rrethit Skrapar, paraqitet si më poshtë:

³² Shënim: Të dhënat mbi volumin e shitur në m³ të GMMD si dhe rentës minerare për subjektet që shfrytëzojnë GMMD të dërguar nga AKBN më datë 09.10.2023 dhe 13.10.2023 nuk përkohjnë si me njëri tjetrin, ashtu edhe me të dhënat e publikuara në Raportet Vjetore të AKBN për vitet 2020, 2021 dhe 2022.

Tabela nr. 8 Pagesa e rentës minerare gjatë periudhës 2020-2022 në Vendburimin Melovë, nga subjektet që kanë leje aktive shfrytëzimi.³³

Nr. Lejes minerare	Data Akt-Miratimit	Emri i subjektit	Emërtimi i vendburimit	Lloji i mineralit	Pagesa e rentes minerare		
					v. 2020	v. 2021	v. 2022
970/2	06.09.2006	F.	Melovë, Rrethi Skrapar	Gëlqeror i mermerizuar	4095		4095
862/2	26.05.2005	S. P	Melovë, Rrethi Skrapar	Gëlqeror i mermerizuar	104	104	104
1661/2	06.11.2014	T. E.	Melovë, Rrethi Skrapar	Gëlqeror i mermerizuar	4095	4095	4095
1811	12.07.2016	D.	Melovë, Rrethi Skrapar	Gëlqeror i mermerizuar			
1656	16.08.2013	V. H.	Melovë, Rrethi Skrapar	Gëlqeror i mermerizuar	4095	1493	104
1653	07.08.2013	W. S.	Melovë, Rrethi Skrapar	Gëlqeror i mermerizuar			
1617	19.03.2013	Z. F.	Melovë, Rrethi Skrapar	Gëlqeror i mermerizuar			
1548/1	27.06.2011	T. E.	Melovë, Rrethi Skrapar	Gëlqeror i mermerizuar			
1834	13.06.2017	G. M.	Melovë, Rrethi Skrapar	Gëlqeror i mermerizuar			
1930	24.03.2022	M.	Melovë, Rrethi Skrapar	Gëlqeror i mermerizuar			

Burimi: AKBN (Raportet vjetore 2020, 2021, 2022)

Përpunoi: Grupi i auditimit

- Subjekti “F.” sh.p.k. me leje shfrytëzimi minerar nr. 970/2 datë 06.09.2006, përgjatë gjithë periudhës 2020-2022, ka paguar rentë minerare në masën 4.095 lekë/m³.
- Subjekti “T. E.” sh.p.k. me leje shfrytëzimi minerar nr. 1661/2 datë 06.11.2014, përgjatë gjithë periudhës 2020-2022, ka paguar rentë minerare në masën 4.095 lekë/m³.
- Subjekti “S. P.” me leje shfrytëzimi minerar nr. 862/2 datë 26/05/2005 përgjatë gjithë periudhës 2020-2022, ka paguar rentë minerare në masën 104 lekë/m³, duke kategorizuar “Gëlqeror i mermerizuar” në “Gjithë mineralet e tjera të grupit të katërt”, i cili përkon nr.36. të Shtojcës 2 të Ligjit nr. 9975 datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar, sipas së cilit masa e rentës minerare është 104 lekë/m³.
- Subjekti “V.H.” sh.p.k. me leje minerare nr.1656 datë 16.03.2013, gjatë vitit 2020 ka paguar rentë minerare në masën 4095 lekë/m³, në vitin 2021 ka paguar rentë minerare në masën 1493 lekë/m³ dhe më pas ka ndryshuar emërtimin e mineralit të përcaktuar në Akt Miratimi, nga "Gëlqeror i Mermerizuar" në "Gëlqeror" me Urdhër të Ministrit të MIE, nr. 444, datë 06.12.2021. Gjatë vitit 2022 ky subjekt ka paguar rentë minerare në masën 104 lekë/m³.

Në Raportin Vjetor të AKBN për vitin 2022 “Mbikëqyrja e shfrytëzimit të rezervës minerare nga subjektet private”, citohet: “Disa minerale si Gëlqeror i mermerizuar, Gëlqeror dekorativ, Gëlqeror bllokor etj., pavarësisht emërtimit të ndryshëm, duke qenë i njëjti mineral, kanë përdorim dhe çmim shitje të njëjtë, ndërkohë që paguajnë vlera të ndryshme të rentës minerare. Në këtë mënyrë subjektet minerare vazhdimisht kanë tentuar dhe kanë mundur të realizojnë ndryshimin e emërtimit të mineralit për t’ju shmangur klasifikimit të tyre në ligjin e taksave, pra duke paguar më pak rentë minerare.”³⁴

Nga evidenca e vënë në dispozicion të grupit të auditimit, lidhur me ndryshimin e emërtimit të mineralit në lejen e shfrytëzimit, rezulton si më poshtë vijon:

- Urdhër i Ministrit të MIE nr. 7201/1 datë 25.11.2020 “Për ndryshimin e emërtimit të llojit të mineralit në lejen minerare dhënë sipas Akt Miratimit nr. 1863 datë.16.07.2018 dhe reflektimin e këtyre ndryshimeve në Regjistrin Minerar”.

³³ Sipas Raporteve Vjetore të AKBN-së, subjektet pa të dhëna mbi rentën e paguar nuk kanë kryer aktivitet gjatë periudhës 2020-2022.

³⁴ Raporti Vjetor i vitit 2022 i AKBN, Vol. II, fq.18

Përmbajtja e Urdhërit: Në lejen minerare të shfrytëzimit dhënë sipas Akt Miratimit nr.1863 datë 16.07.2018, të bëhet ndryshimi i emërimit të mineralit si më poshtë vijon:

Nga Gëlqeror i Mermerizuar që është emërtuar, të bëhet Gëlqeror Masiv.


- Urdhër i Ministrit të MIE nr. 444 datë 06.12.2021 “ Për ndryshimin e emërimit të llojit të mineralit në lejen minerare dhënë sipas Akt Miratimit nr. 1656 datë.16.08.2013 dhe reflektimin e këtyre ndryshimeve në Regjistrin Minerar”.

Përmbajtja e Urdhërit: Në lejen minerare të shfrytëzimit dhënë sipas Akt Miratimit nr.1656 datë 16.08.2013, të bëhet ndryshimi i emërimit të mineralit si më poshtë vijon:

Nga “Gëlqeror i Mermerizuar” që është emërtuar, të bëhet “Gëlqeror”.

Në hartën e mëposhtme, e cila i përket vendburimit Mëlovë në rrethin e Skraparit paraqiten 10 subjekte që shfrytëzojnë të njëjtin formacion gjeologjik. Nga këto, subjekti "V. H." që zotëron Lejen Minerare të Shfrytëzimit Nr. 1656, ka ndryshuar emërtimin e mineralit të përcaktuar në Akt Miratimin nga "Gëlqeror i mermerizuar" në "Gëlqeror".³⁵ Ndërkohë, të gjitha subjektet e tjera në këtë zonë e kanë emërtimin në lejen minerare “Gëlqeror i mermerizuar”.

Harta nr. 2 Harta topografike e Vendburimit Mëlovë, Skrapar



Burimi: AKBN

³⁵ Urdhër i Ministrit të MIE nr. 444 datë 06.12.2021 “ Për ndryshimin e emërimit të llojit të mineralit në lejen minerare

Analiza e përlllogaritjes së rentës minerare GMMD

Grupi i auditimit me synim maksimizimin e vjeljes së rentës minerare në sektorin e GMMD identifikoi avantazhet dhe disavantazhet e legjislacionit në fuqi dhe atij paraardhës mbi përlllogaritjen e rentës minerare.

Legjislacioni aktual

Përlllogaritja e rentës minerare mbi vlerën fikse për njësi bazuar në kategorizimin e mineralit siç parashikohet nga Ligji nr. 9975 datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar Shtojca 2, mund të ketë efekte si më poshtë:

- Në rastin kur ekziston mundësia e faturimit nën vlerën reale të mineralit të shitur, me qëllim shmangien e detyrimeve të subjekteve, përlllogaritja bazuar në vlerë fikse për njësi (m³), garanton vjeljen e rentës, pavarësisht çmimit të shitjes.
- Në kushtet e mospërputhjes së emërimit të mineralit në lejen minerare me emërtimet që përmban Shtojca 2 e Ligjit nr. 9975 datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar, krijon mundësi për devijim nga renta e përcaktuar, në avantazh të subjekteve.
- Duke qenë se përlllogaritja e rentës minerare bazohet në vlerë fikse për njësi, (në rastin e grupit GMMD në m³), ajo mbetet e pa ndikuar nga ndryshimi i çmimit të shitjes si në tregun vendas ashtu edhe në eksport. Në rastin e rritjes së çmimit të shitjes të mermerit, nuk maksimizohen të ardhurat që shkojnë në Buxhetin e Shtetit nga vjelja e rentës minerare.

Legjislacioni paraardhës

Sipas ligjit paraardhës, renta minerare përcaktohet duke shumëzuar vlerën totale të shitjes së produktit me përqindjen e rentës për produktin. Përlllogaritja e rentës minerare në përqindje mbi vlerën e produktit të shitur, parashikuar nga Ligji i mëparshëm nr. 9975 datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare” mund të ketë efekte si më poshtë:

- Përlllogaritja e rentës minerare në përqindje mbi vlerën e produktit të shitur ka ndikim të drejtpërdrejtë në të ardhurat që shkojnë në Buxhetin e Shtetit nga vjelja e rentës minerare. Çdo rritje e vlerës së mineralit në tregjet botërore sjell automatikisht rritjen e rentës minerare pasi ajo përlllogaritet në përqindje mbi vlerën e produktit të shitur.
- Nga ana tjetër ulja e çmimit të mermerit në tregjet botërore, sjell për pasojë uljen e rentës që duhet të paguajnë subjektet, duke ulur të ardhurat e vjela nga shteti nga renta minerare. Por duke qenë se shteti nga ana tjetër është edhe garantues i investimeve në sektorin minerar, kontribuon në lehtësimin e situatës financiare të subjekteve që operojnë dhe inkurajon investimet brenda sektorit.

Sa më sipër, në funksion të analizës lidhur me mënyrën e përlllogaritjes së rentës minerare për mermerin në veçanti, grupi i auditimit ka kryer disa përlllogaritje të rentës minerare në dy versionet, sipas ligjit aktual në fuqi dhe atij të mëparshëm duke marrë në konsideratë të dhënat për vitin 2022. Referuar Ligjit nr. 9975 datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare” të mëparshëm, Shtojca 2 Përqindja e rentës minerare sipas klasifikimit, mermeri gjendet në grupin IV, Mineralet dhe Materialet e Ndërtimit dhe masa e taksës variojnë nga 4-10%.³⁶ Siç u citua dhe më sipër, renta minerare përcaktohet duke shumëzuar vlerën totale të shitjes me shumicë të produktit me përqindjen e rentës, sipas përcaktimeve të shtojcës nr.2, që i bashkëlidhet këtij ligji.³⁷

Përlllogaritja është kryer bazuar në minimumin e masës së taksës, pra 4% mbi vlerën e produktit të shitur. Siç vihet re në tabelën dhe grafikun më poshtë, shteti shqiptar, për vitin 2022 do të përfitonte më shumë nëse do të vulte rentën minerare sipas ligjit të vjetër (19,637,627 lekë), ndryshe nga renta minerare e vjelë me ligjin aktual e cila është rreth 3 herë më pak ose ndryshe 6,844,361 lekë.

³⁶ Ligji nr. 9975 datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, Shtojca 2

³⁷ Ligji nr. 9975 datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, neni 4 pika 4

Tabela nr. 9 Përlllogaritja e rentës minerare viti 2022

Nr.	Emërtimi	Njësia	viti 2022
1	Totali i te ardhurave nga shitja GMMD	Leke	490,940,676.00 ³⁸
2	Renta minerare sipas ligjit ne fuqi	Leke	6,844,361.00 ³⁹
3	Përlllogaritja e rentës minerare sipas ligjit te vjetër (%)	Leke	19,637,627.04

Burimi: Raporti vjetor 2022, AKBN

Përpunoi: Grupi i Auditimit

Grafiku nr. 5 Paraqitja grafike e efektit të përlllogaritjes së rentës minerare për vitin 2022.



Burimi: Raporti vjetor 2022, AKBN

Përpunoi: Grupi i Auditimit

Praktika të mira

Sipas një studimi të Bankës Botërore mbi taksimin e burimeve natyrore, metoda e përlllogaritjes së taksës së shfrytëzimit të burimeve natyrore mbi volumin e produktit të shitur është ndoshta një nga metodat më të përdorura.⁴⁰ Efekti dhe taksa mund të ndryshojë në varësi të faktit nëse norma tatimore bazohet në sasinë e prodhuar (për njësi takse) ose në çmimin e shitjes.⁴¹

Lista e rentës minerare të Republikës së Kosovës i kategorizon mineralet në gjashtë grupe kryesore: mineralet energjetike; mineralet metalore; mineralet industriale/jometalore; mineralet ndërtimore; gurë të çmuar, gjysmë të çmuar dhe dekorativ; si dhe uji mineral. Për secilin nga këto gjashtë grupe evidentohen një sërë mineralesh me nivelin e rentës minerare përkatëse. Renta minerare për disa minerale është caktuar si përqindje, ndërsa për disa minerale të tjera është caktuar si vlerë fikse. Mermeri është klasifikuar në grupin e minerareve me emërtim gurë të çmuar, gjysmë të çmuar dhe dekorativ dhe niveli i rentës për të llogaritet në vlerën $3.2\%/m^3$.⁴²

³⁸ Kjo shifër është marrë nga Raporti Vjetor i AKBN-së për vitin 2022.

³⁹ Kjo shifër është marrë nga Raporti Vjetor i AKBN-së për vitin 2022

⁴⁰ <https://documents1.worldbank.org/curated/en/974521468739320152/pdf/multi0page.pdf>

⁴¹ <https://documents1.worldbank.org/curated/en/974521468739320152/pdf/multi0page.pdf>

⁴² https://me.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/07/Vendimi_-_Lista_e_Rentes_Minerare.pdf

Gjetje nga auditimi 1:

Në sektorin e shfrytëzimit të GMMD, 63 % e lejeve minerare i përkasin emërtimit “Gëlqeror i mermerizuar”. Prodhimi në fund të vitit 2022 në sektorin e shfrytëzimit të GMMD rezultoi 27,279 m³ nga 12,537 m³ që ka qenë në vitin 2020. Të ardhurat e subjekteve që shfrytëzojnë GMMD nga shitjet (brenda dhe jashtë vendit) rezultojnë të jenë 592,155,168 lekë për vitin 2022 duke shënuar një rritje të lartë në raport me të ardhurat nga shitjet për vitin 2020 të cilat kanë qenë 230,054,425 lekë. Volumi i produktit të shitur të GMMD (në m³) ka shënuar rritje nga 11,011 m³ në vitin 2020 në 24,927 m³ në vitin 2022. Pavarësisht rritjes së volumit të shitur mbi të cilin përlogaritet renta minerare, ecuria e kësaj të fundit ka shënuar trend zbritës për periudhën objekt auditimi nga 13,320,612 lekë në vitin 2020 në 8,888,552 në vitin 2022.

Gjetje nga auditimi 2:

Përgjatë periudhës objekt auditimi rezultojnë disa subjekte të cilat në Lejen Minerare kanë emërtimin “Gëlqeror i mermerizuar” dhe nuk e paguajnë rentën minerare sipas përcaktimit të Ligjit nr. 9975 datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare” i ndryshuar, Shtojca nr. 2, Grupi IV numri 22. I njëjti fenomen përsëritet edhe për subjekte të tjera të cilat në Lejen Minerare kanë emërtimin “Gëlqeror dekorativ” dhe nuk e paguajnë rentën minerare sipas përcaktimit të Ligjit nr. 9975 datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare” i ndryshuar, Shtojca nr. 2, Grupi IV numri 36.

Konkluzione

1. Subjekte me të njëjtin emërtim në Lejen minerare paguajnë rentë minerare të ndryshme në mos përputhje me Ligjin për Taksat kombëtare. Ky është edhe një ndër shkaqet kryesore që të ardhurat në buxhetin e shtetit nga vjelja e rentës minerare për sektorin e GMMD kanë pësuar rënie përgjatë viteve 2020-2022 pavarësisht se sasia e mineralit të GMMD ka ardhur në rritje. Kjo situatë nuk garanton maksimizimin e përfitimit publik dhe të ardhurave që shteti përfiton nga vjelja e rentës minerare për sektorin e GMMD.

1.1 Rekomandimi:

Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, për të gjithë subjektet që shfrytëzojnë Gëlqerorët Masiv, të Mermerizuar dhe Dekorativ, të marrë masa për të unifikuar pagesën e rentës minerare bazuar në emërtimin e mineralit që përmban Leja Minerare e shfrytëzimit.

Menjëherë e në vazhdimësi

4.2 A kanë garantuar institucionet përgjegjëse mbikëqyrje të plotë të procesit të shfrytëzimit të mermerëve?

4.2.1 A janë miratuar kërkesat për heqje nga fondi pyjor të aktiviteteve të shfrytëzimit të mermerëve? ⁴³

Ligji nr. 57/2020 “Për pyjet” rregullon dhe formalizon marrëdhëniet e subjekteve që kryejnë aktivitetin e shfrytëzimit të mermerëve me institucionet përgjegjëse për menaxhimin e pyjeve. Qëllimi i këtij ligji është mbrojtja e pyjeve si pasuri me rëndësi të veçantë, për vlerat e mëdha dhe të pazëvendësueshme në mbrojtjen e klimës, tokës, ruajtjen dhe përmirësimin e potencialeve prodhuese, ekuilibrave të mjedisit natyror etj. Ky ligj synon ruajtjen, shtimin e sipërfaqes dhe rritjen e volumit të përgjithshëm të fondit pyjor kombëtar, rregullimin e marrëdhënieve dhe garantimin e qëndrueshmërisë financiare, organizimin funksional në të gjitha nivelet e qeverisjes për shfrytëzimin dhe përdorimin e qëndrueshëm e të balancuar të burimeve pyjore⁴⁴.

⁴³ Shënim: Në këtë auditim, grupi i auditimit është fokusuar vetëm në menaxhimin e fondit pyjor dhe jo në atë kullor, duke qenë se mbi 80 % e sipërfaqes së subjekteve janë të pozicionuar dhe shfrytëzojnë sipërfaqe pyjore. Megjithatë, praktika dhe procedura e heqjes së fondit kullor është thuajse e njëjtë me atë të fondit kullor.

⁴⁴ Ligji nr. 57/2020 “Për pyjet”, neni 1, pika 1 & 3.

Një ndër kriteret kryesore që parashtron Ligji nr. 57/2020 “Për pyjet” është se sipërfaqja e fondit pyjor kombëtar duhet të ruhet dhe të mos zvogëlohet dhe gjithashtu në rastet e lejuara nga ligji për heqjet nga fondi pyjor kombëtar të garantohet zëvendësimi i tij. Pra, çdo subjekt të cilit i miratohet Akti ligjor/nënligjor për heqjen nga fondi pyjor të sipërfaqes ku do të ushtrojë aktivitetin minerar duhet që të marrë masa për të garantuar zëvendësimin e kësaj sipërfaqeje pyjore në të cilën do të zhvillojë aktivitetin minerar. Ndryshimet e sipërfaqeve në fondin pyjor kombëtar bëhen me:

- a) miratimin e Ministrit të MTM për sipërfaqe deri në 1 ha;
- b) vendim të Këshillit të Ministrave për sipërfaqe mbi 1 ha deri në 10 ha;
- c) ligj të veçantë për sipërfaqe mbi 10 ha.⁴⁵

Pasi subjekteve i miratohet heqja nga sipërfaqja e fondit pyjor me anë të një prej tre formave cituar më sipër, subjektet janë të detyruar të paguajnë kostot e përlllogaritura për pyllëzimin kompensues përkatës. Pas miratimit për ndryshimet (heqjen) në sipërfaqen e fondit pyjor, ndryshimet duhet të pasqyrohen në Regjistrin Kombëtar të Fondit Pyjor (RKFP). Regjistri Kombëtar i Fondit Pyjor (RKFP) është regjistri zyrtar që ngrihet dhe mirëmbahet nga Agjencia Kombëtare e Pyjeve, në të cilin pasqyrohet tërësia e informacioneve kadastrale të nevojshme dhe e ndryshimeve periodike për çdo njësi të fondit pyjor kombëtar.

Referuar Ligjit Nr. 10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, neni 24 pika 10, me miratimin e lejes minerare të shfrytëzimit me karrierë të grupit të mineraleve ndërtimore (ku bën pjesë edhe mermeri) zona e lejuar e shfrytëzimit hiqet nga fondi pyjor e kullosor, pronë shtetërore, zëri “Tokë e zënë, tokë me bimësi pyjore”, dhe regjistrohet në zërin “Tokë e zënë, objekt shfrytëzimi për ushtrimin e veprimtarisë minerare”, sipas legjislacionit në fuqi për ndryshimin e zërit kadastral të fondit pyjor e kullosor. Brenda 10 ditëve nga miratimi i lejes minerare, zotëruesi i saj përgatit dokumentacionin përkatës dhe e dorëzon pranë MIE e cila brenda 10 ditëve përgatit aplikimin dhe e dërgon pranë MTM. Pra, sipas Ligjit për sektorin minerar kërkesa nga subjekti duhet dorëzuar në MIE e cila më pas e përcjell atë në MTM.

Ndërsa, bazuar në VKM nr. 888, datë 27.12.2022 “Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga Fondi Pyjor Kombëtar apo zgjerimin e tyre”, kërkesa nuk duhet të bëhet në MIE por në portalin qeveritar “e-Albania”. Në mënyrë të përmbledhur më poshtë përshkruhet procedura e VKM-së nr. 888 datë 27.12.2022 lidhur me aplikimin dhe dokumentet që subjekti duhet të depozitojë në portalin qeveritar “e-Albania” për të marrë miratimin për ndryshim/heqje nga fondi pyjor të sipërfaqes pyjore të destinuar për shfrytëzim për aktivitetin minerar.

1. Personi fizik ose juridik, që kërkon të kryejë procedurën për ndryshimin e kategorisë së përdorimit dhe pakësimin në volum të një sipërfaqeje nga fondi pyjor kombëtar, bën kërkesën nëpërmjet portalit qeveritar *e-Albania*.

- a) Kërkesa arkivohet elektronikisht në dosjen elektronike të krijuar si modul (backend) në Regjistrin Kombëtar të Fondit Pyjor;
- b) Kërkesa bëhet sipas formularit të aplikimit, në ankesin nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;
- c) Rolet e institucioneve të përcaktuara në këtë procedurë janë në aneksin nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, brenda 20 (njëzetë) ditëve pune nga data e paraqitjes së kërkesës, shqyrton kërkesën dhe dokumentacionin e depozituar nga kërkuesi, si dhe verifikon nëse dokumentacioni është depozituar i plotë, sipas pikës 2, të kreut III, të këtij vendimi.

3. Në rast se gjatë shqyrtimit të dokumentacionit, MTM konstaton se dokumentacioni i depozituar, sipas pikës 2, të kreut III, nuk është i plotë apo nuk është sipas formatit të kërkuar, njofton nëpërmjet

⁴⁵ Ligji nr 57/2020 “Për pyjet”, neni 5, pika 4.

portalit qeveritar *e-Albania* kërkesin për plotësimin e dokumentacionit dhe të metave të konstatuara, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pune nga dita e njoftimit.

4. Mosplotësimi i dokumentacionit të kërkuar brenda afatit të përcaktuar në pikën 3, të këtij kreu, përbën shkak për mospranimin e kërkesës. Kërkesi njoftohet nëpërmjet portalit qeveritar *e-Albania* për arsyet e refuzimit, si dhe për të drejtën e ankimit në përputhje me legjislacionin në fuqi për ankimimet administrative. Procedurat për të njëjtën kërkesë fillojnë nga e para.

5. MTM, nëse vlerëson se dokumentacioni është i plotë, sipas pikës 2, të kreut III, të këtij vendimi, dhe është në përputhje me rastet e përcaktuara në pikën 14, të këtij kreu, përcjell kërkesën për hartimin e raportit tekniko-ekonomik dhe dhënien e dakordësisë, njësisë së vetëqeverisjes vendore, kur sipërfaqja pyjore, objekt i ndryshimit të kategorisë së përdorimit, është në pronësi të saj ose në pronësi private.

6. Njësia e vetëqeverisjes vendore, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e administrimit të kërkesës, përcjell pranë ministrisë përgjegjëse për pyjet raportin tekniko-ekonomik së bashku me vendimin e Këshillit Bashkiak, i cili jep pëlqimin ose jo për vazhdimin e procedurës së ndryshimit të kategorisë së përdorimit të sipërfaqes pyjore në pronësi të saj ose private.

7. Agjencia Kombëtare e Pyjeve bën vlerësimin e saktësisë së raportit tekniko ekonomik, sipas informacionit të regjistrit kombëtar të fondit pyjor dhe sistemit *ALFIS* dhe e përcjell këtë vlerësim në ministri, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune.

8. Nëse vendimi i këshillit bashkiak shprehet kundër procedurës së ndryshimit të kategorisë së përdorimit të sipërfaqes pyjore, atëherë struktura përgjegjëse për pyjet në ministri, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga marrja e këtij vendimi, njofton kërkesin dhe ndërpret menjëherë procedurën. Kërkesi njoftohet nëpërmjet portalit qeveritar *e-Albania* për arsyet e refuzimit, si dhe për të drejtën e ankimit në përputhje me legjislacionin në fuqi për ankimimet administrative.

9. MTM, pasi administron dakordësinë respektive, sipas pikës 6, dhe vlerësimin sipas pikës 7, të këtij kreu, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune, përgatit urdhrin e ministrit, për ndryshimin e kategorisë së përdorimit (heqje/shtesa) të sipërfaqes nga/në fondin pyjor, në rastin kur sipërfaqja është më e vogël se 1 ha, sipas përcaktimit në shkronjën “a”, të pikës 4, të nenit 5, të ligjit 57/2020, “Për pyjet”, i cili i dorëzohet kërkesit nëpërmjet sportelit të shërbimit, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pune nga data e nënshkrimit të tij.

10. Në rastin kur kërkesa për ndryshimin (heqje/shtesa) të sipërfaqeve nga/në fondin pyjor kombëtar është për sipërfaqe mbi 1 ha, sipas përcaktimit të bërë në shkronjën “b”, të pikës 4, të nenit 5, të ligjit nr. 57/2020, “Për pyjet”, si dhe për sipërfaqe mbi 10 ha, të përcaktuar në shkronjën “c”, të pikës 4, të nenit 5, të po këtij ligji, ndiqet e njëjta procedurë, përcaktuar në kreun III, të këtij vendimi, dhe ministria përgatit aktin e miratimit, Vendim të Këshillit të Ministrave ose ligj të veçantë.

11. Pas miratimit të ndryshimit të kategorisë së përdorimit të sipërfaqes nga fondi pyjor kombëtar, ndiqet procedura e mëposhtme:

a) Struktura përgjegjëse për pyjet në bashkinë përkatëse kryen përditësimin në regjistrin kombëtar të pyjeve dhe përcjell të dhënat pranë agjencisë shtetërore përgjegjëse për pyjet;

b) Agjencia Shtetërore e Kadastrës bën çregjistrimin nga kategoria tokë e zënë pyll dhe e regjistron në kategorinë e re të përdorimit.

12. Sipërfaqja që hiqet nga fondi pyjor publik, sipas këtij vendimi, kalon në një kategori tjetër përdorimi, por në çdo rast mbetet në pronësi publike.

13. Brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga data e miratimit të aktit ligjor për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, sipas përcaktimeve përkatëse të shkronjave “a”, “b” dhe “c”, të pikës 4, të nenit 5, të ligjit nr. 57/2020, “Për pyjet”, subjekti kërkuar kryen pagesën mbi vlerën e sipërfaqes pyjore të hequr apo të infrastrukturës pyjore të tjetërsuar:

a) në llogarinë bankare të bashkisë kur sipërfaqja pyjore është pronë publike;

b) në llogarinë bankare të pronarit privat, në rastin kur sipërfaqja pyjore është në pronësi private.⁴⁶

⁴⁶ Shënim: Pagesat e subjekteve për bashkitë për ndryshimin/heqjen e sipërfaqes së fondit pyjor nuk ka qenë objekt i këtij auditimi duke qenë se në këtë auditim nuk është përfshirë asnjë bashki.

Sa më sipër, subjekti gjatë aplikimit në portalin *e-albania*, krahas dokumenteve të tjera duhet të depozitojë edhe dokumentin e tarifës bankare për llogari të MTM në shumën prej 20,000 lekë dhe kjo shumë është e pakthyeshme edhe nëse kërkesa nuk miratohet.⁴⁷

Një element tjetër shumë i rëndësishëm është edhe neni 47 pika 1 gërma b fraksioni II e Ligjit Nr. 10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë” në të cilin citohet se leja e minerare shfrytëzimit për mineralet ndërtimore (ku bën pjesë edhe mermeri) revokohet nëse subjekti nuk fillon veprimtarinë brenda 180 ditëve kalendarike nga data e hyrjes në fuqi të lejes minerare. Pra, në mënyrë që të respektojë këtë kriter, subjektet duhet të pajisen brenda 6 muajve kalendarike me dokumentin e miratimit (nga Ministri i MTM, VKM ose Ligj) për heqjen nga fondi pyjor të sipërfaqes pyjore në të cilën do të ushtrojnë veprimtarinë e tyre.

Lidhur me objektin e këtij auditimi, u fokusua vetëm në subjektet që shfrytëzojnë mermerin për të parë nëse këto subjekte janë të pajisura me dokumentin përkatës për heqjen e sipërfaqes nga fondi pyjor. Nga evidencat e mbledhura nga grupi i auditimit nëpërmjet Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit vihet re se aplikimet e subjekteve janë në faza të ndryshme, por e përbashkëta është se asnjë prej subjekteve që shfrytëzojnë mermerin nuk është i pajisur me dokumentin përkatës për ndryshimin/heqjen nga fondi pyjor të sipërfaqes pyjore të shfrytëzuar. Është shqetësuese që edhe pse shumica e subjekteve aktive në sektorin e mermerit kanë bërë aplikime për heqjen nga fondi pyjor prej viteve, këto aplikime janë ende në faze shqyrtimi në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe nuk janë finalizuar me miratimin përkatës. Evidentohet gjithashtu që një pjesë e subjekteve nuk e kanë bërë ende aplikimin në MIE/MTM mbi kërkesën për ndryshim/heqje nga fondi pyjor. Në këtë situatë, kur pjesa më e madhe e subjekteve e kanë bërë aplikimin (një pjesë e tyre prej disa vitesh) por ende nuk janë pajisur me miratimin nga Ministri/VKM/Ligj, këto subjekte nuk janë duke respektuar Ligjin e Pyjeve. Nga ana tjetër, nëse këto subjekte do të prisnin me vite deri në miratimin (për heqje nga fondi pyjor) të Ministrit/VKM/Ligj, leja e tyre minerare do të revokohej.

Tab. nr. 10 Sipërfaqet e licencuara (me leje minerare për shfrytëzim, për GMMD dhe total)

Lejet e GMMD të shfrytëzimit për periudhën 2015 – 2022			Lejet e shfrytëzimit për periudhën 2015 - 2022	
Viti	Nr. Lejeve	Sip. e licencuara për GMMD	Nr. Lejeve Total	Sip. e licencuara në Total për aktivitet minerar
2015	22	8.962 km²	618	250.664 km ²
2016	24	9.1834 km²	627	250.321 km ²
2017	33	21.997 km²	645	260.986 km ²
2018	34	23.12 km²	647	245.722 km ²
2019	34	25.944 km²	571	239.2335 km ²
2020	34	25.944 km²	576	242.9821 km ²
2021	39	27.209 km²	587	250.665 km ²
2022	34	26.8219 km²	559	236.7046 km ²

Burimi: AKBN

Në tabelën nr. 10 më sipër janë paraqitur të dhëna mbi sipërfaqen totale të licencuar shfrytëzimit të GMMD si dhe sipërfaqes totale të licencuar për të gjithë aktivitetin minerar. Ajo që vihet re është se sipërfaqja e licencuar për shfrytëzim me leje minerare për grupin e mineraleve të GMMD është rreth 26.8 km² ose 11 % e sipërfaqes totale e të gjithë aktivitetit minerar në Shqipëri. Duke qenë se objekt

⁴⁷ VKM nr. 888, datë 27.12.2022 “Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga Fondi Pyjor Kombëtar apo zgjerimin e tyre, Kreu III, pika 2, gërma dh.

i këtij auditimi është vetëm grupi i mineraleve GMMD, grupi i auditimit u fokusua në sipërfaqen e licencuar vetëm për grupin e GMMD. Referuar edhe bazës ligjore të përshkruar më sipër, nga grupi i auditimit u kërkuan të dhëna lidhur me sipërfaqen reale të shfrytëzuar për grupin e GMMD deri në vitin 2022. Nga përgjigjet zyrtare të AKBN-së, rezulton se sipërfaqja e licencuar dhe e shfrytëzuar nga subjektet që shfrytëzojnë mineralet e GMMD është 0.89 km². Kjo sipërfaqe pavarësisht se rezulton ende në Regjistrin Kombëtar të Fondit Pyjor, realisht ajo nuk është më një sipërfaqe pyjore por një sipërfaqe në të cilën kryhet aktivitet mineral. Pra, “de facto” fondi pyjor ka një sipërfaqe të reduktuar me 0.89 km² vetëm si rezultat i shfrytëzimit të grupit të mineraleve të GMMD, pa llogaritur këtu grupet e tjera të mineraleve.

Agjencia Kombëtare e Pyjeve

Agjencia Kombëtare e Pyjeve (AKP), është person juridik, publik, buxhetor, në varësi të Ministrit të MTM, që ka si mision mirëqeverisjen e pyjeve në nivel kombëtar, ruajtjen dhe zhvillimin e tyre, përdorimin e qëndrueshëm dhe shumë funksional të burimeve në fondin pyjor kombëtar, si pasuri natyrore me rëndësi kombëtare. AKP organizon Rrjetin e Përherëshëm të Monitorimit të Fondit Pyjor Kombëtar, si pjesë e Rrjetit Kombëtar të Monitorimit të Gjendjes së Mjedisit për të cilin përpunon dhe nxjerr rezultatet e monitorimit, si dhe harton e publikon raportin vjetor për gjendjen e fondit pyjor si pjesë të raportit për gjendjen e mjedisit.

AKP në kuadër të sigurimit të performancës në sektorin e pyjeve, si dhe vlerësimit të gjendjes së pyjeve dhe impaktit të sektorit, kryen:

- a) monitorimin e treguesve kyç dhe nivelit të realizimit të politikave, programeve dhe planeve në nivel kombëtar nga strukturat përgjegjëse në bashki për pyjet;
- b) mbikëqyrjen e zbatimit të akteve ligjore/nënligjore, akteve administrative, politikave, programeve dhe planeve në nivel kombëtar nga strukturat e kontrollit të pyjeve në bashki dhe në zonat e mbrojtura, si dhe ndërhyr në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të pakufizuar në rastet kur vëren pamundësinë ose mos ushtrimin e kompetencave ligjore nga ana e tyre.⁴⁸

Gjetje nga auditimi 1:

Deri më sot asnjë prej subjekteve që ushtrojnë aktivitetin e shfrytëzimit të mermerit nuk janë të pajisur me aktin përkatës ligjor/nënligjor (Miratimin e Ministrit të MTM, VKM ose Ligj të veçantë) për ndryshimin/heqjen nga fondi pyjor të sipërfaqes pyjore të shfrytëzuar. Ligji për pyjet përcakton qartë detyrimin e subjekteve për t'u pajisur me Miratimin e Ministrit të MTM, VKM ose Ligj të veçantë mbi ndryshimin/heqjen nga fondi pyjor të sipërfaqes pyjore të shfrytëzuar.

Gjetje nga auditimi 2:

Sipërfaqja “de facto” ose reale e fondit pyjor është ulur me 0.89 km². Duke qenë se subjekteve nuk i është miratuar ndryshimi/heqja nga fondi pyjor, këto sipërfaqe rezultojnë ende në Regjistrin Kombëtar të Fondit Pyjor, kur aktualisht ato janë sipërfaqe e shfrytëzuar si aktivitet mineral. Mos miratimi nga Ministri, VKM, ose Ligj për heqje nga Fondi Pyjor bën që subjektet të mos marrin masa për kompensimin e shpyllëzimit që ato kanë kryer dhe do të vazhdojnë të kryejnë.

Gjetje nga auditimi 3:

Subjektet të cilat nuk kanë bërë kërkesën për ndryshimin/heqjen nga fondi pyjor të sipërfaqeve të fondit pyjor që ata shfrytëzojnë janë si më poshtë:

- Subjekti “F.” sh.p.k. me leje minerare nr. 970/2, datë 6.9.2006;
- Subjekti “K. K.” sh.p.k. me leje minerare nr. 1051/1 datë 3.8.2017;
- Subjekti “M.” sh.p.k. me leje minerare nr. 1930 datë 24.3.2022;
- Subjekti “A.” sh.p.k. me leje minerare nr. 1918 dt 12.7.2021;

⁴⁸ Ligji nr 57/2020 “Për Pyjet” neni 35, pika 1

- Subjekti “B.” sh.p.k. me leje minerare nr. 1888 datë 30.12.2019;
- Subjekti “D.” sh.p.k. me leje minerare nr. 1811 datë 12.7.2016;
- Subjekti “H. F.” sh.p.k. me leje minerare nr. 1703 datë 23.5.2014;
- Subjekti “W. S.” sh.p.k. me leje minerare nr. 1653 datë 7.8.2013.

Nga mos aplikimi i këtyre subjekteve për ndryshimin/heqjen nga fondi pyjor të sipërfaqes pyjore të destinuar për aktivitetin e shfrytëzimit të mermerit shuma e munguar në buxhetin e shtetit është 160,000 lekë.

Konkluzione

1. Të gjitha subjektet aktive që operojnë në aktivitetin e shfrytëzimit të mermerit nuk janë të pajisur me miratimin për ndryshimin/heqjen nga fondi pyjor të sipërfaqeve pyjore që shfrytëzojnë. Në Shqipëri, deri në vitin 2022, sipërfaqja e fondit pyjor është zvogëluar me 0.89 km² vetëm nga aktiviteti i shfrytëzimit të mermerit.

1.1 Rekomandimi:

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marrë masat të shqyrtojë të gjitha kërkesat/aplikimet e subjekteve që ushtrojnë aktivitetin e shfrytëzimit të mermerit, duke miratuar sipas rastit dokumentin për ndryshimin/heqjen nga fondi pyjor të sipërfaqes pyjore të shfrytëzuar, të cilat prej kohësh nuk marrin zgjidhje.

Menjëherë

3.1 Rekomandimi:

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Pyjeve të marrin masa të detyrojnë të gjitha subjektet që ushtrojnë aktivitetin e shfrytëzimit të mermerit të aplikojnë për ndryshim/heqje të sipërfaqes së fondit pyjor.

Brenda muajit Maj 2024 e në vazhdimësi

4.2.2 A ka funksionuar sistemi i kontrollit dhe monitorimit të aktivitetit të shfrytëzimit të mermerëve?

Monitorimi dhe raportimi është i nevojshëm për të informuar pjesëmarrësit për përgjegjësitë e tyre dhe për t'u mundësuar atyre që të përgatiten për të gjitha angazhimet në bazë të raporteve 3-mujore dhe vjetore, bazuar tek rezultatet - aktivitetet, produktet dhe treguesit e nivelit të rezultatit dhe në objektiva. Plani i rehabilitimit është pjesë e planit të veprimtarisë së shfrytëzimit dhe zhvillohet njëkohësisht deri në rehabilitimin e plotë të sipërfaqes së shfrytëzuar nga kjo veprimtari, ku subjektet shfrytëzuese të mineraleve të ndërtimit duhet ta rehabilitojnë atë në masën 100% me fondet e tyre. Hartimi i planit të rehabilitimit dhe fillimi i rehabilitimit progresiv të karrierës (guroreve) nga kompanitë, duhet të fillojë që në vitin e parë pas shfrytëzimit të saj⁴⁹. Plani i rehabilitimit progresiv dhe përfundimtar, vlerësohet nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) dhe depozitohet nga subjektet në momentin e aplikimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit për leje minerare dhe leje mjedisore. Ky plan zhvillohet gjatë dhe pas përfundimit të veprimtarisë shfrytëzuese deri në rehabilitimin e plotë të sipërfaqes së shfrytëzuar sipas kërkesave standarde të miratuara me Udhëzim të përbashkët të MIE dhe MTM mbi rehabilitimin mjedisor progresiv, përcaktuar me Vendimin nr. 741, datë 09.09.2015. Vlera monetare vjetore e garancisë financiare përcaktohet me vendim të këshillit teknik të AKBN-së, e cila miratohet nga ministri dhe depozitohet çdo vit në llogari të ministrisë përgjegjëse.

Preventivat tip për vlerësimin monetar të planit të rehabilitimit bëhen sipas përcaktimit në Udhëzimin nr. 718, datë 03.10.2011⁵⁰.

⁴⁹ Pika 8,10,11e Urdhërit 67 datë 11.3.2018

⁵⁰ Aneksi nr.4 i Udhëzimit nr.718, datë 03.10.2011 “Mënyrën e vlerësimit të garancive financiare të lejeve minerare”.

AKBN dhe AKM janë strukturat përgjegjëse për verifikimin e zbatimit të planit të rehabilitimit në terren dhe ky plan konsiderohet i realizuar vetëm pas miratimit të raportit nga ministri përgjegjës për veprimtarinë minerare dhe ai për mjedisin, kjo sipas kërkesave të ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në RSH-së”. Synimi i Planit të rehabilitimit është⁵¹:

- të stabilizojë zonat e dëmtuara nëpërmjet ndërhyrjeve inxhinierike me qëllim minimizimin e ndër të tjera dhe të erozionit.
- të rigjellbërojë zonën në të cilën bëhet rehabilitimi me bimësi të përshtatshme, që ka ekzistuar më parë.
- të minimizojë ndikimin pamor të zonave të degraduara e të përmirësojë peizazhin.

- Në rastet kur zotëruesi i lejes nuk ka realizuar rehabilitimin progresiv e përfundimtar sipas planit të miratuar, atëherë vlera e plotë e garancisë financiare vjetore ose të përgjithshme kalon në favor të shtetit dhe përdoret nga ministria përgjegjëse në bashkëpunim me ministrinë e mjedisit për rehabilitimin progresiv e përfundimtar të mjedisit në zonat përkatëse, e cila ka për detyrë të monitorojë dhe të mbikëqyrë zbatimin e këtij detyrimi. Mosrealizimi i planit të rehabilitimit nga zotëruesi i lejes, i heq atij të drejtën e përfitimit për një leje tjetër të një veprimtarie minerare për një periudhë 50 vjeçare, e llogaritur kjo nga fundi i vlefshmërisë së lejes së parë, dhe bëhet shkak për revokim të çdo leje tjetër, përcaktuar qartë në Ligjin nr.10304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në RSH-së”.⁵²

➤ Udhëzimet dhe vendimet e ndryshme ligjore të dala ndër vite (Vendimi nr.741, datë 9.9.2015, i cili ka shfuqizuar Vendimin nr. 440, datë 16.06.2011; Udhëzimi i përbashkët nr.18, datë 24.08.2022), nuk kanë të përditësuar e qartësuar mënyrën e përlllogaritjes së vlerës së përgjithshme të garancisë financiare për rehabilitimin e mjedisit për lejet e shfrytëzimit minerar. Nuk përcaktohet se mbi cilat çmime bazohet përlllogaritja e vlerës së çdo operacioni për 1 ha karrierë për grupin e mineraleve ndërtimore, por merren në konsideratë çmimet e përcaktuara në pikën 6 të Udhëzimit nr.718, datë 03.10.2011, konkretisht: mbushje e sheshit fundor (35 lekë/m³), mbjellje pemësh (100 lekë/m³), hapje gropash (1000 lekë/m³), blerje pemësh (50 lekë/m³), shërbime (50 lekë/m³), kanali i ujërave të larta drenazhim (200 lekë/m³), sinjalistikë (5000 lekë), çmontim makinerish e pajisjesh (341 lekë/orë pune), prishje objektivësh sipërfaqësorë (284 lekë/orë pune), ngarkim materialesh (341lekë/orë pune), transport materialesh e ngarkim shkarkim(16 lekë/ton km).

Lidhur me pyetjen drejtuar AKBN-së se a ka të miratuar nga ministri i MIE dhe MTM një udhëzim të përbashkët mbi formatin standard të vlerësimit të planit të rehabilitimit të mjedisit, AKBN është përgjigjur se zbatohet Udhëzimi nr.718, datë 03.10.2011, Vendimi nr.741, datë 9.9.2015 dhe Udhëzimi i përbashkët nr.18, datë 24.08.2022⁵³.

➤ Zotëruesi i lejes minerare ka detyrimin të paraqesë pranë AKBN-së çdo 3-6 muaj një informacion për të gjithë operacionet e kryera për rehabilitimin e mjedisit dhe menaxhimin e mbetjeve minerare, në përputhje me detyrimet e tij të lejes minerare dhe planin vjetor⁵⁴. Nga shqyrtimi i të dhënave në raportet vjetore të AKBN-së dhe në vet deklaratimet e subjekteve mbi sipërfaqen e shfrytëzuar dhe të rehabilituar, del se kjo sipërfaqe është zero km² e rehabilituar. AKBN është drejtpërdrejt struktura përgjegjëse që ka për detyrë mbikëqyrjen e monitorimin e veprimtarive minerare; ka të drejtë të marrë masa administrative ose të propozojë marrjen e tyre prej Ministrit, sipas përcaktimit në pikën 1.2/b, pikën 4 të nenit 43 të këtij ligji, detyrë të cilën nuk e ka zbatuar për asnjë rast të vetëm. Edhe pse për disa subjekte minerare është lënë detyrë rehabilitimi i sipërfaqeve

Urdhëri i Ministrit të MIE nr.201, datë 20.06.2016 “Për miratimin e formës së informacioneve tremujore, vjetore, përfundimtare dhe përmbajtjen e planit vjetor të punës nga ana e zotëruesve të lejeve minerare të shfrytëzimit me karrierë për grupin e mineraleve ndërtimore”, pikat 7,8,9.

⁵¹ Udhëzimi i Përbashkët Nr.19, datë 24.08.2022 “Për miratimin e formatit standard për hartimin e planit të rehabilitimit të mjedisit në veprimtarinë minerare”, pika 3.

⁵² Neni 37, pika 7 e Ligjit nr.10304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në RSH-së”.

⁵³ Pyetësor i dërguar me datë 27.06.2023 “Kërkesë për informacione në fazën fillestare të auditimit”.

⁵⁴ Neni 25 pika b e Ligjit nr.10304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në RSH-së”.

të shfrytëzuara, nuk rezulton të jetë zbatuar nga asnjë subjekt dhe aq më shumë nuk rezulton të jetë marrë apo propozuar nga AKBN asnjë masë administrative ndaj tyre, konkretisht:

Në raportin e 6 -muorit të parë për vitin 2021 është lënë detyrë 1 subjekti: me nr. leje 1661/2, datë 06.11.2014),`ndërsa në raportin vjetor për vitin 2021 u janë lënë detyrë 3 subjekteve: me leje nr. 1051/1, datë 03.08.2007; me leje nr. 1835, datë 30.06.2017; me leje nr.1792, datë 10.03.2016. Në raportin vjetor për vitin 2022 është lënë detyrë 9 subjekteve: me leje nr.1561, datë 22.05.2012; leje nr.1604/1, datë 07.01.2013; me leje nr.1051/1, datë 03.08.2007; me leje nr. 1026/2, datë 27.06.2007; me leje nr. 1905, datë 18.01.2021; me leje nr.1792, datë 10.03.2016; me leje nr.862/2, datë 26.05.2005; me leje nr. 970/2, datë 09.06.2006; me leje nr. 1661/2, datë 06.11.2014. Vihet re se një subjekti me leje nr. 1661/2, datë 06.11.2014 i është lënë detyrë në dy vitet rresht dhe në asnjë vit nuk është zbatuar.

Gjatë procesit të vlerësimit të planit të rehabilitimit progresiv dhe përfundimtar nga AKBN për lejet e shfrytëzimit minerar duhet të llogaritet dhe përcaktohet vlera monetare e garancisë financiare e detyrueshme, e përgjithshme dhe vjetore, për realizimin e planit të rehabilitimit të mjedisit, e cila depozitohet në AKBN dhe MIE dhe një kopje i përcillet edhe AKM-së⁵⁵. Kjo vlerë miratohet me vendim të këshillit teknik të AKBN-së dhe nga ministri i MIE. Zotëruesi i lejes paguan çdo vit garancinë financiare, duke e llogaritur nga data efektive e marrjes së lejes, dhe e paraqet në AKBN bashkë me planin vjetor të punës i cili miratohet nga ministri. Vlera e garancisë financiare rivlerësohet në rast të ndryshimit të planit vjetor të programuar, kur sasia e materialit për t'u shfrytëzuar është më e madhe se ajo e programuar. Në rast të mosparaqitjes së dokumentit të garancisë financiare të rehabilitimit jo më vonë se 20 ditë kalendarike pas përfundimit të vitit të llogaritur me datën e marrjes së lejes minerare referuar pikës 8 të Vendimit nr.741, datë 9.9.2015.

Nga shqyrtimi i të dhënave të evidencës së debitorëve për mospagesën e garancisë financiare të realizimit të planit të rehabilitimit nga AKBN, rezultojnë të dhëna jo të sakta e jo të plota në vlerë dhe numër subjektësh. Në fund të vitit 2022 raportohen 2 subjekte debitorë në vlerën 815,394 lekë, ndërsa nga përllogaritjet e bëra rezultojnë 5 subjekte në vlerë 1,630,532 lekë. Konkretisht: tre subjektet e para të listuar në tabelën më poshtë nuk raportohen debitorë, ndërsa në fakt nga përllogaritjet del se shuma gjithsej e tyre për të paguar rezulton në vlerën 897,406 lekë. Të dhënat të detajuara të këtyre subjekteve detajohen në tabelën më poshtë:

Tabelë nr. 11 Subjektet që rezultojnë me detyrime të papaguara të garancisë financiare për realizimin e planit të rehabilitimit, sipas viteve të shfrytëzimit, deri në 31.12.2022.

Sipas AKBN					Sipas llogaritjeve të kryera							Debitorë sipas AKBN
Të dhëna për lejet e shfrytëzimit					Garancia financiare rehabilitimit			Garancia financiare rehabilitimit				
Nr. Leje Minerare	Data e miratimit të lejes	Afati në vite	Mbarimi i afatit	Rinovim periudha	Shuma total/vite shfrytëzimi	Detyrimi vjetor	Paguar	Detyrimi vjetor	Vite shfrytëzimi gjithsej nga data e lejes	Shuma gjithsej që duhet paguar deri 31.12.2022, nga data e lejes	Diferenca për të paguar	
1604/2	07.01.2013	25	2038		1,258,725	59,964	359,274	50,349	9	453,141	93,867	
1703	23.05.2014	25	2039		3,139,825	125,593	376,779	125,593	8	1,004,744	627,965	
1617	19.03.2013	25	2038		2,194,700	87,788	614,518	87,788	9	790,092	175,574	
1350/1	26.05.2009	20	2029	25.11.2019	1,417,980	141,798	684,854	141,798	13	1,417,980	733,126	425,394
1834	3.06.2017	25	2024		9,750,278	390,000	1,950,000	390,011	5	1,950,055	55	390,000

Burimi: Evidenca e debitorëve dhe i pagesave të garancisë financiare nga AKBN dhe përpunuar nga grupi i auditimit.

- Krahasuar të dhënat e evidencës së debitorëve me ato të raporteve vjetore institucionale del se ka mospërputhje në përcaktimin e subjekteve debitorë. Nga të dhënat e raporteve vjetore rezulton se ka

⁵⁵ Pika 3-6;8-14 të Vendimit nr.741, datë 9.9.2015 "Për miratimin e formës, rasteve të kthimit dhe mënyrës së llogaritjes të garancive financiare për rehabilitimin e mjedisit, për realizimin e programit minimal të punës dhe realizimin e investimit në veprimtarinë minerare" Aneksi 1.

pasur mospagesë të garancisë financiare vjetore prej 9 subjekteve në vitin 2020 dhe për 8 subjekte të tjera nuk kanë të dhëna; në vitin 2021 rezultojnë me mospagesë 5 subjekte dhe për 18 të tjera nuk ka të dhëna, e megjithatë ato rezultojnë të kenë vazhduar normalisht aktivitetin. Në vitin 2022 rezultojnë me mospagesë 2 subjekte, subjekti me leje nr.1548/1 datë 14.12.2021 dhe subjekti me leje nr.1389 datë 23.07.2009), por jo ato të raportuara në evidencën e debitorëve, përkatësisht subjekti me leje nr.1350/1 datë 26.05.2009 dhe subjekti me leje nr.1834 datë 3.06.2017) dhe për 20 të tjera nuk ka të dhëna. Theksojmë se AKBN është struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen, raportimin për kontrollin e zbatimit të ligjit minerar dhe raportet vjetore ia paraqet Ministrit për informim në lidhje me treguesit e realizuar dhe respektimin ose jo nga ana e subjekteve minerare të detyrimeve që lidhen me zbatimin e kushteve të përcaktuara në lejet minerare⁵⁶.

❖ AKBN është struktura përgjegjëse në shqyrtimin e planeve vjetore, mbikëqyrjen dhe kontrollin e respektimit të kushteve të dhënies së lejes si dhe për raportimin tek ministri për çdo veprimtari minerare të shfrytëzimit çdo 6 muaj⁵⁷. Gjithashtu ka të drejtë të kryejë inspektime për zbatimin e dispozitave të ligjit minerar dhe të marrë masa administrative apo t'i propozojë ministrit për marrjen e masave për subjekte që nuk respektojnë kërkesat e legjislacionit minerar⁵⁸. Roli i saj në raportim është marrja e të dhënave mbi të gjithë treguesit e realizimit për çdo operacion të veprimtarisë minerare të subjekteve, të pajisura me leje minerare të shfrytëzimit me karrierë për grupin e mineraleve ndërtimore, konsolidimin e informacionit 3-mujor dhe vjetor dhe paraqitja e një raporti të përmbledhur për shqyrtim në strukturën përkatëse të MIE.

Mbikëqyrja dhe monitorimi i veprimtarive minerare realizohet nga drejtoria minerare pranë AKBN-së, e cila:

- ✓ shqyrton e miraton planin vjetor të punës dhe për çdo subjekt minerar,
- ✓ bën rivlerësimin e garancisë financiare të planit të rehabilitimit pas shqyrtimit të planit vjetor të punës, në rastin kur sasia e materialit për t'u shfrytëzuar është më e madhe se ajo e programuar në projektin e zhvillimit të veprimtarisë minerare.
- ✓ harton programin vjetor dhe periodik të punës dhe organizon punën për zbatimin e tij.
- ✓ kontrollon zbatimin e planit të rehabilitimit në përputhje me garancitë e miratuara.
- ✓ ndjek ecurinë e pagesave të garancive financiare të rehabilitimit, kontrollin e pagesave për çdo subjekt minerar dhe propozon masa administrative në rast mospagese të tyre.
- ✓ mbikëqyr në terren zbatimin e planit të rehabilitimit nga subjektet minerare për rehabilitimin progresiv dhe përfundimtar të karrierës.
- ✓ kryen inspektime për ndjekjen e respektimit të kushteve të lejes e normave të detyrueshme të dispozitave ligjore sipas legjislacionit minerar për çdo veprimtari minerare, le detyra, merr masa administrative apo propozon marrjen e tyre nga ministri.

❖ Nga shqyrtimi i të dhënave të paraqitura në mënyrë të përmbledhur dhe të detajuar për çdo subjekt brenda përbrenda raporteve vjetore institucionale konstatohen pasaktësi dhe mospërputhje midis tyre, në lidhje me numrin e saktë të subjekteve që ushtrojnë aktivitet të shfrytëzimit të mineralit të mermerit, konkretisht:

- Për vitin 2020 AKBN raporton në tabelën përmbledhëse 34 subjekte të mermerit, ndërsa të detajuara pasqyrohet aktiviteti i 40 subjekteve të tilla.
- Për vitin 2021 AKBN raporton në tabelën përmbledhëse 34 subjekte të mermerit, ndërsa të detajuara pasqyrohet aktiviteti i 44 subjekteve të tilla.

⁵⁶ Vendim nr. 232, datë 23.3.2011 "Miratimin e funksioneve të strukturave përgjegjëse në sektorin minerar të Republikës së Shqipërisë", pika 2, dh,e,i,j.

⁵⁷ Vendim nr. 232, datë 23.3.2011 "Miratimin e funksioneve të strukturave përgjegjëse në sektorin minerar të Republikës së Shqipërisë", pika 2, dh,e,i,j.

⁵⁸ Kreu VII Mbikëqyrja, monitorimi i veprimtarive minerare dhe kadastra minerare, neni 43 pika 1,2,4 e Ligjit nr.10304, datë 15.7.2010 "Për sektorin minerar në RSH-së".

- Për vitin 2022 AKBN raporton në tabelën përmblledhëse 35 subjekte të mermerit, ndërsa të detajuara pasqyrohet aktiviteti i 45 subjekteve të tilla.

Në mënyrë të përmblledhur sipas viteve këto të dhëna paraqiten në tabelën si më poshtë:

Tabelë nr. 12 Raportimi i numrit të subjekteve minerare të evidentuara brenda raporteve vjetore.

Viti	Nr i subjekteve të shfrytëzimit të mineralit të mermerit raportuara nga AKBN sipas tabelës përmblledhëse në raportet vjetore	Nr. i subjekteve të shfrytëzimit të mineralit të mermerit, të detajuara në raportet vjetore	Numri i subjekteve për të cilat ka mospërputhje të dhënash
2020	34	40	6
2021	34	44	10
2022	35	45	10

Burimi i të dhënave: Raportet vjetore nga AKBN dhe përpunuar nga grupi i auditimit.

❖ AKBN gjatë kontrollit në terren tek zotëruesi i lejes lë akt-konstatim në të cilin pasqyrojnë kontrollin e kryer, evidentimin e përshkrimit e shkeljeve ligjore dhe masën e dënimit me gjobë që vendosin, e cila duhet paguar brenda 30 ditë kalendarike nga data e hartimit të konstatimit⁵⁹. Për të parë rregullshmërinë e mbajtjes së akt-konstatimeve dhe për të kuptuar problematikat e dala gjatë kontrollit si dhe kontrollin e zbatimit të detyrave të lëna nga kontrollet e njëpasnjëshme, nga grupi i auditimit u përzgjedhën akt-konstatimet e mbajtura (gjithsej 29) për periudhën nën auditim 2020-2022, për shtatë subjekte minerare aktive me realizim prodhimi më shumë krahasuar me subjektet e tjera.

✓ Nga auditimi i akt-konstatimeve rezulton se ato nuk përmbajnë të dhëna të plota e të sakta për të gjitha operacionet e veprimtarisë sipas planit vjetor të miratuar dhe se asnjë prej tyre nuk përmban masë administrative për asnjë subjekt. Nuk janë të plotësuara korrekt e saktë të gjitha rubrikat e formatit të akt-konstatimit si: numri i licencës dhe emri i drejtuesit teknik. Ka mungesa të plotësisht të datës së mbajtjes së tij, të nënshkrimit nga secili person që ka kryer kontrollin, të nënshkrimit nga ana e përfaqësuesve të subjektit (zotëruesi i lejes, administratori, drejtuesi teknik), të numrit dhe datës së miratimit të planit vjetor. Të dhënat për veprimtarinë e shfrytëzimit kanë pothuajse të njëjtën mënyrë plotësimi dhe jo të specifikuar për çdo operacion të veprimtarisë sipas planit vjetor të miratuar (sasia e realizuar e prodhimit, sasia e shitjes, vlera e garancive të investimit e rehabilitimit, vlera e investimit), në koordinim me planin e zhvillimit. Në asnjë prej tyre nuk ka të dhëna mbi realizimin ose jo të planit të rehabilitimit. Në shumë pak raste është lënë detyrë rehabilitimi progresiv në sipërfaqet ku ka mbaruar shfrytëzimi, por nuk është ndjekur në kontrollin e ardhshëm dhe se asnjë prej tyre nuk ka masë administrative.

✓ Monitorimi e mbikëqyrja e veprimtarive minerare nuk është kryer e plotë dhe dy herë në vit sipas dispozitave të ligjit minerar në RSH-së. Nga 7 subjektet e përzgjedhura për auditim vetëm dy prej tyre janë monitoruar 2 herë në vit.

❖ Sigurimi i punëtorëve është një komponent jetik që ofron mbrojtje si për punonjësit ashtu edhe për bizneset. Sigurimi i punëtorëve mbron punonjësit dhe bizneset nga rreziqet dhe pasiguritë e papritura dhe siguron mbrojtje financiare për punëtorët në rast aksidentesh, lëndimesh ose sëmundjesh në vendin e punës, duke siguruar që ata të marrin kompensimin dhe mbështetjen e nevojshme kur lind nevoja. Njëkohësisht, sigurimi i punëtorëve ndihmon bizneset të zbusin detyrimet e mundshme dhe të ruajnë e garantojnë shëndetin dhe jetën e tyre. Për këtë qëllim janë miratuar një sërë aktesh ligjore dhe nënligjore që i vendos punëmarrësit përpara detyrimit për marrjen e masave dhe zbatimin në mënyrë efektive të tyre. Detyrimi për mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të punonjësve të punësuar në veprimtarinë minerare është i përcaktuar në pikën 5 të nenit 36, Detyrimet e përgjithshme gjatë ushtrimit të veprimtarisë minerare ku citohet: “Të bëj sigurimin e punonjësve të punësuar në veprimtarinë minerare nga aksidentet në punë, sipas rregullave të sigurimit, të

⁵⁹ Urdhër Nr.382, datë 20.5.2011 “Për miratimin e formës, përmbajtjes dhe procedurave të lënies së aktit të konstatimit për kundërvajtjet administrative në zbatim të lejeve minerare”.

përcaktuara nga Këshilli i Ministrave”.⁶⁰ Zotëruesit e lejeve minerare për të ushtruar aktivitetin detyrohen të kryejnë sigurimin e punonjësve të tyre nga aksidentet personale në punë, sipas një kontrate, pranë një shoqërie sigurimi, cila mbulon raste si humbja e jetës, paaftësia e pjesshme ose e përkohshme, për shkak të dëmtimit në punë. Shuma e vlerës së përcaktuar për çdo punonjës që duhet të jetë i mbuluar me sigurim jete nuk duhet të zbresë nën 6,000.000 lekë. Ndërkohë që tarifa e sigurimit duhet të jetë në masën 0,5 %, gjë që duhet të jetë e pasqyruar edhe në kontratën e sigurimit, referuar Vendimit nr.1109, datë 30.7.2008 "Për sigurimin e punonjësve, të punësuar në veprimtarinë minerare nga aksidentet në punë". Subjektet kanë detyrimin të paraqesin dokumentacionin e nevojshëm, pranë strukturave përkatëse, dhe vetëm pas konfirmimit të rregullsisë së tij subjekti ka të drejtë të fillojë ushtrimin e veprimtarisë së tij. Çdo shmangie nga detyrimet që ka subjekti përbën shkelje ligjore. Subjektet deklarojnë mbi numrin e të punësuarve dhe atyre me sigurim jete në sistemin elektronik, "revzonë" dhe më pas është detyrë e AKBN-së verifikimi, shqyrtimi dhe marrja e masave për zbatimin korrekt e me përgjegjshmëri sipas kuadrit ligjor dhe detyrave funksionale, përcaktuar edhe në rregulloren e brendshme të organizimit e funksionimit të institucionit.

Duke u nisur nga rëndësia që ka mbrojtja e sigurimi i jetës e shëndetit në punë dhe për të parë se si është zbatuar në fakt ky detyrim ligjor për punonjësit e punësuar në aktivitetet minerare, u audituan të dhënat e deklaruara nga vetë subjektet në AKBN dhe u krahasuan me të dhënat e çdo subjekti në raportet vjetore të institucionit, nga të cilat rezultojnë se:

✓ Për periudhën nën auditim numri i të punësuarve në veprimtarinë minerare të mermerit, deklaruar nga subjektet minerare të shfrytëzimit të mermerit në rang vendi nga viti në vit rezulton me trend në rritje, me 36% në vitin 2021 dhe me 13%, në vitin 2022, të krahasuara këto me vitet përkatëse të mëparshme.

✓ Në vitin 2020 janë pa sigurim jete 47% e numrit gjithsej të të punësuarve; në vitin 2021 janë pa sigurim jete 30% e numrit gjithsej të të punësuarve; në vitin 2020 janë pa sigurim jete 21% e numrit gjithsej të të punësuarve.

✓ Konstatohen diferenca në raportimin e numrit total të të punësuarve dhe të atyre me sigurim jete të deklaruara nga subjektet në krahasim me numrin e deklaruar nga AKBN në raportet vjetore. Përkatësisht: nga AKBN janë raportuar më pak: në vitin 2020 për 38 punëtorë; në vitin 2021 për 27 punëtorë dhe në vitin 2022 për 29 punëtorë.

✓ Kjo tregon mungesë përgjegjësie të punëdhënësve duke mos respektuar marrëdhëniet kontraktore, por edhe përgjegjësi ndërinstitucionale, të atyre që kanë autoritetin ligjor në kontrollin e monitorimin e zbatimit të legjislacionit të sigurimit e mbrojtjes në punë.

Në akt-konstatimet e vërejtura, të mbajtura nga specialistë dhe inspektorë pranë drejtorisë përgjegjëse në AKBN vërehet se:

- Në rubrikën mbi numrin total të punonjësve dhe numrin me sigurim jete rezulton që jo të gjithë të punësuarit janë të mbuluar me sigurim jete. Asnjë prej këtyre rasteve nuk është evidentuar si shkelje ligjore, për të mos thënë më tej se nuk ka asnjë masë administrative, e cila të shërbejë edhe si parandaluese e cënimit të jetës dhe vendosjes para përgjegjësisë administrative, civile e penale të personave përgjegjës. Të detajuara për çdo subjekt dhe për çdo vit jepen në tabelat mëposhtme.

-Drejtuesit e subjekteve përpara se të sigurojnë veten e tyre duhet të sigurojnë jetën e punëtorëve të tyre. Nga 7 subjektet e përzgjedhura për auditim, u vërejt se në dosje nuk ishin policat e kontratat e sigurimit për çdo vit; numri i punëtorëve të siguruar nuk përputhej me akt konstatimet e mbajtura në subjekt nga grupi i inspektimit të institucionit. Në 3 prej tyre shumat e sigurimit (nga policat e sigurimit) rezultojnë të ndryshme me 500,000 lekë; 3,000,000 lekë dhe 6,000,000 lekë (vetëm nga një subjekt). Vendimi nr.1109, datë 30.7.2008 përcakton se shumta e sigurimit nuk duhet të jetë më e ulët se 6,000,000 lekë dhe tarifa e primit të sigurimit jo më e ulët se 0,5% e shumës së shënuar në

⁶⁰ Neni 36 , pika 5 Ligjit nr.10304, datë 15.7.2010 "Për sektorin minerar në RSH-së.

kontratën e sigurimit⁶¹. U vërejt se në policën e sigurimit rezultojn të siguruar drejtues teknik, inxhinier, shofer me shumën 6,000,000 lekë. Efekti nga moszbatimi i vendimit, edhe pse i hershëm në kohë, do të shtohet konsiderueshëm po të marrim parasysh se nga deklarimi i vetë subjekteve, në vitin 2020 nuk janë siguruar 47% e numrit total të punësuar; në vitin 2021 nuk janë siguruar 30% e numrit total të punësuar; në vitin 2022 nuk janë siguruar 21% e numrit total të punësuar. Gjithashtu për asnjë periudhë të auditimit numri i të punësuarve dhe atyre me sigurim jete të deklaruar nga subjektet, jo vetëm nuk përputhet me të dhënat e raporteve vjetore, por ka diferenca të konsiderueshme.

Tabela nr. 13 Numri i punonjësve me sigurim jete deklaruar nga subjektet, krahasuar me raportimet vjetore të institucionit, për periudhën 2020-2022.

VITI	Sipas deklarimit të subjekteve në revzone				Sipas raporteve vjetore të AKBN		Diferenca (+,-)	
	Nr total i subjekteve	Nr. i punëtorëve total	Nr. i punëtorëve me sigurim jete	Punëtorët pa sigurim jete në %	Nr. i punëtorëve total	Nr. i punëtorëve me sigurim jete	Nr. i punëtorëve total	Nr. i punëtorëve me sigurim jete
2020	26	141	75	46.8%	103	64	-38	-11
2021	32	192	134	30%	165	125	-27	-9
2021	33	217	171	21%	188	156	-29	-15
Totali		550	380	31%	456	345	-94	-35

Burimi i të dhënave: Data bazë e revzonës, raportet vjetor dhe përpunuar nga grupi i auditimit.

❖ Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) është autoriteti kompetent për përcaktimin e kushteve për lejet përkatëse të mjedisit, në përputhje me dispozitat e Ligjit nr.10431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” dhe ka funksion midis të tjerave hartimin e Programit Kombëtar dhe monitorimin e gjendjes së mjedisit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji; përgatitjen dhe publikimin e raporteve vjetore për gjendjen e mjedisit etj. Sektori i monitorimit pranë AKM-së kontrollon dhe verifikon dokumentacionin dhe raportet 6/mujore të vet monitorimit të subjekteve minerare mbi gjendjen e mjedisit, për ngarkesën e ndotjes dhe ndikimet në mjedis, reagimet e publikut, në përputhje me kushtet e lejes mjedisore dhe ligjin mjedisor, si dhe afatin e dorëzimit të raporteve sipas përcaktimit në Urdhërin nr.77, datë 02.7.2020 “Për procedurën e dorëzimit të dokumenteve dhe raporteve të vet monitorimit, për subjektet e pajisura me leje të mjedisit të tipit A ose B” pika 5 që kërkon nga subjektet dorëzimin dhe protokollimin e këtyre raporteve në përputhje me urdhërin.

Nga vëzhgimi i data bazës së dorëzimit të raporteve të vet monitorimit të subjekteve me leje minerare të pajisura me leje mjedisore në AKM për periudhën objekt auditimi rezultojn se:

- Nga ana e subjekteve nuk kanë dorëzuar raportet e vet monitorimit: për vitin 2020 janë 15 subjekte minerare ose 71 % e numrit gjithsej të subjekteve aktive; për vitin 2021 janë 4 subjekte minerare ose 19 % e numrit gjithsej të subjekteve aktive dhe për vitin 2022 janë 5 subjekte minerare ose 23% e numrit gjithsej të subjekteve aktive, ndërsa 4 subjekte rezultojnë se nuk kanë dorëzuar asnjë raport vet monitorimi për këtë periudhë auditimi.

Drejtoria e Inspektimit të Kontrollit (DIK) pranë AKM-së e organizuar në nivel qendror e rajonal, midis të tjerave kryen inspektime:

- Në zbatim të kushteve të lejes mjedisore të subjekteve minerare, veçanërisht në gurore,
- Në sigurimin e kontrollit shtetëror të mbrojtjes së mjedisit sipas legjisllacionit në fuqi,
- Në sigurimin e informimit për publikun për procesin e vendimmarrjes për çështjet e mjedisit,
- Në kryerjen e kontrollit të zbatimit të detyrave të programit të rehabilitimit të zonës së ndotur etj.

DIK ka për detyrë të ndërmarrë çdo veprim që, në bazë të këtij ligji, mund të jetë i nevojshëm për të siguruar përputhshmërinë me kërkesat e përcaktuara në dispozitat e legjisllacionit për ndërtimet, për veprimtaritë e planifikuara, për të cilat nevojitet kryerja e vlerësimit të ndikimit në mjedis.

⁶¹ Vendimi Nr.1109, datë 30.7.2008 “Për sigurimin punonjësve, të punësuar në veprimtarinë minerare, nga aksidentet në punë”

Në programet vjetore dhe analizat vjetore të AKM-së, vënë në dispozicion të grupit të auditimit, për periudhën objekt auditimi rezulton se:

Për vitin 2020 nuk është dërguar raport vjetor, me argumentimin e kufizimit të zbatimit të detyrave për shkak të periudhës së pandemisë, shpjeguar kjo në përgjigjet e pyetësorit, ndërsa nga evidencat e monitorimit rezulton se janë inspektuar dy subjekte minerare⁶².

Në analizat vjetore të vitit 2021, 2022 nuk ka asnjë informacion në lidhje me kontrollin e ushtruar në këto subjekte, numrin e subjekteve me lejen e shfrytëzimit minerar të mermerit të cilët disponojnë dhe leje mjedisore, të kontrollit të zbatimit të rehabilitimit të zonës. Kryesisht pasqyrohen inspektimet e kryera nga Sektori i Inspektimit të Burimeve Natyrore (Ujore) në AKM në nivel qendror e rajonal, duke mos dhënë realisht një informacion, të plotë e të saktë e mbi të gjitha të evidentimit të problematikave në lidhje me rehabilitimin progresiv e përfundimtar të zonës së shfrytëzuar; të zbatimit të detyrave të lëna nga inspektimet e mëparshme me qëllim përmirësimin e situatës dhe zbatimin e akteve ligjore e nënligjore të kushteve të dhënies së lejes dhe të mbrojtjes së mjedisit. Nga data-baza e të dhënave nga AKM-ja, për inspektimin e subjekteve me leje mjedisore me aktivitet të shfrytëzimit të mineralit të mermerit, për periudhën objekt auditimi dërguar grupit të auditimit, rezulton se:

- Nuk janë inspektuar nga DIK pranë AKM-së asnjëherë 6 subjekte për periudhën 2020-2022 (subjekti me leje nr.1051/1 datë 03.08.2007, subjekti me leje nr.1924 datë 13.10.2021, subjekti me leje nr.1866 datë 26.09.2018, subjekti me leje nr.1811 datë 12.7.2016, subjekti me leje nr.1617 datë 19.03.2013, subjekti me leje me nr.1714 datë 06.06.2014).

- Janë inspektuar nga DIK 17 subjekte minerare për vitin 2021 dhe 19 subjekte minerare për vitin 2022, por në analizat vjetore të kësaj periudhe nuk paraqiten këto inspektime, qoftë edhe të grupuara sipas aktivitetit, edhe pse në programin tematik të inspektimeve vjetore të hartuar nga Sektori i Inspektimit Mjedisor, miratuar nga drejtori i përgjithshëm i AKM-së, nga Inspektorati Qëndror e më pas nga ministri i mjedisit, është përfshirë në aktivitetin 2.1 Inspektimi e karrierave të shfrytëzimit të gurit, në të gjithë vendin nga DIK dhe degët rajonale të ARM-së.

Referuar përgjigjeve të pyetësorit të grupit të auditimit drejtuar AKM-së, në lidhje me pyetjen: A ka bashkëpunuar AKM me AKBN në lidhje me monitorimin e planit të rehabilitimit të mjedisit për subjektet që shfrytëzojnë mermerin, i është përgjigjur se është ngritur grupi i punës, por deri sot nuk është kryer asnjë procedurë, pasi procedurat iniciohen nga AKBN⁶³, pra edhe në periudhën që po ushtrohet auditimi rezulton të mos funksionojë bashkëpunimi, si detyrim ligjor i përcaktuar⁶⁴.

Referuar pyetjes së bërë mbi ç'bazë përzgjidhen subjektet për inspektim u janë përgjigjur se: Drejtoria Inspektim Kontrollit, Sektori Inspektimit në Mjedis kryen inspektime mbi bazë risku të miratuar me plan vjetor nga Ministri i linjës. Plani vjetor nuk përmban emra subjektesh, por fusha aktiviteti me ndikim në mjedis në të cilat Drejtoria do të fokusohet. Plani vjetor ndahet sipas planeve mujore me veprimtari të ndryshme në mjedis, të cilat janë të përbëra me emrat dhe të dhënat e subjekteve.

➤ Dokumentacioni i plotë për marrjen e lejes minerare paraqitet nga kërkuesi i lejes në QKL i cili ia përcjell elektronikisht MIE-s dhe bën të mundur aksesin për këtë dokumentacion për institucionin shqyrtues, AKBN-në. Vlerësimi i kushteve të lejes bëhet nga AKBN-ja dhe hartimi i aktit të miratimit të lejes minerare realizohet nga drejtoria që mbulon veprimtarinë minerare dhe më pas miratohet nga ministri përgjegjës. Brenda 120 ditëve kalendarike nga data e aplikimit në QKL, subjekti duhet të

⁶² Përgjigje e pyetësorit nga AKM datë 09.10.2023

⁶³ Përgjigje e pyetësorit ardhur me email në datë 06.10.2023, drejtuar AKM-së në adresë elektronike, në datën 29.09.2023

⁶⁴ Urdhëri nr.7, datë 20.01.2023 "Për ngritjen e grupit për verifikim dhe kontrollin në terren për zbatimin e planit të rehabilitimit të mjedisit për lejet e shfrytëzimit dhe lejet e kërkim-zbulim-shfrytëzimit"

pajiset me lejen përkatëse mjedisore që mbulon zonën e kërkuar minenare⁶⁵. Me marrjen e lejes së shfrytëzimit minerar nga MIE, në përputhje me legjislacionin në fuqi për minierat, subjekti fitues i projektit duhet t'i nënshtrohet detyrimeve të ligjit 10448, datë 14.07.2011 "Për lejet e mjedisit" i ndryshuar, neni 2, i cili përcakton:

a. rregullat për lejimin e zhvillimit të disa veprimtarive që shkaktojnë ndotje të mjedisit në Republikën e Shqipërisë;
b. masat e parashikuara për parandalimin e kësaj ndotjeje dhe, kur kjo nuk është e mundur, masat për pakësimin e shkarkimeve të tyre të gazta, të lëngëta e të ngurta në ajër, ujë e tokë.

• Nga të dhënat e raportuara nga vete AKM-ja, në lidhje me inspektimin e subjekteve të pajisura me leje mjedisore të cilat zhvillojnë aktivitet minerar të shfrytëzimit të mineralit del se:

• Subjekti me leje shfrytëzimi nr.1051/1, datë 03.08.2007, nuk disponon leje mjedisi për periudhën e auditimit 2020-2022, dhe si i tillë as nuk rezulton të jetë inspektuar prej saj. Sipas raporteve 6/mujore dhe vjetore të mbikëqyrjes së aktivitetit minerar nga AKBN-ja, ky subjekt rezulton të jetë aktiv, me vendndodhje Përroi i Thatë, Bashkia Kukës dhe me sipërfaqe shfrytëzimi prej 0.162 km². Theksohet se AKBN ka detyrimin ligjor për mbikëqyrjen e kushteve të lejes dhe normave të detyrueshme të legjislacionit minerar në fuqi. Të raportojë mbi kontrollin për zbatim të ligjit për lejet minerare të shfrytëzimit për çdo veprimtari minerare çdo 6/muaj. Ti propozojë Ministrin masat dhe penalitetet që duhen ndërmarrë ndaj subjekteve që nuk respektojnë kërkesat e legjislacionit minerar, bazuar në rezultatet e mbikëqyrjes e monitorimit të këtyre veprimtarive minerare, sipas përcaktimit të Vendimit nr. 232, datë 23.3.2011 "Miratimin e funksioneve të strukturave përgjegjëse në sektorin minerar të Republikës së Shqipërisë", pikën 2 gërmat dh/e/i/j.

Nisur sa më lart, nëse një operator ushtron aktivitet pa plotësuar kërkesat e legjislacionit të sipërcituar, institucionet përgjegjëse duhet të marrin masa administrative, sipas përcaktimit të nenit 29 të Ligjit nr.10448, datë 9.6.2011 "Për lejet e mjedisit".

Gjetje nga auditimi 1:

Nga të dhënat e raportuara evidentohet se sipërfaqja e shfrytëzuar rezulton të jetë 0.8879 km², ndërsa sipërfaqja e prekur nga rehabilitimi i mjedisit progresiv ose përfundimtar është 0. Në Raportet Vjetore të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore subjekteve të mëposhtme u janë lënë detyrë për realizimin e rehabilitimit mjedisor të zonës së shfrytëzuar dhe konkretisht:

Për vitin 2021

- ✓ Subjekti "K. K." sh.p.k. me leje minerare nr. 1051/1, datë 03.08.2007;
- ✓ Subjekti "B. C." sh.p.k. me leje minerare nr. 1835, datë 30.06.2017;
- ✓ Subjekti "A." sh.p.k. me leje minerare nr. 1792/1, datë 10.03.2016.

Për vitin 2022

- ✓ Subjekti "Y.S." sh.p.k. me leje minerare nr. 1561, datë 22.05.2012;
- ✓ Subjekti "A." sh.p.k. me leje minerare nr. 1604/1, datë 07.01.2013;
- ✓ Subjekti "K. K." sh.p.k. me leje minerare nr. 1051/1, datë 03.08.2007;
- ✓ Subjekti "K." sh.p.k. me leje minerare nr. 1026/2, datë 27.06.2007;
- ✓ Subjekti "M. Gj." sh.p.k. me leje minerare nr. 1905, datë 18.01.2021;
- ✓ Subjekti "A." sh.p.k. me leje minerare nr. 1792/1, datë 10.03.2016;
- ✓ Subjekti "S. P." sh.p.k. me leje minerare nr. 862/2, datë 26.05.2005;
- ✓ Subjekti "F." sh.p.k. me leje minerare nr. 970/2, datë 06.09.2006;
- ✓ Subjekti "T. E." sh.p.k. me leje minerare nr. 1661/2, datë 06.11.2014.

Gjetje nga auditimi 2:

⁶⁵ Vendim nr.942 datë 17.11.2010 "Për miratimin e procedurave dhe të dokumentacionit për marrjen e lejeve minerare në zonat e hapura", pika Pika 10 B.3.

Akt-Konstatimet nuk përmbajnë të dhëna të plota e të sakta për të gjitha operacionet e veprimtarisë sipas planit vjetor të miratuar. Në asnjë prej tyre nuk jepet sipërfaqja që duhet rehabilituar sipas viteve të shfrytëzimit, nuk lihen detyra konkrete dhe as nuk evidentohen shkeljet ligjore që përbëjnë kundërvajtje administrative në zbatim të legjislacionit minerar. Monitorimi e mbikëqyrja e veprimtarive minerare nuk është kryer e plotë dhe dy herë në vit sipas dispozitave të ligjit minerar në RSH-së. Është konstatuar se për periudhën 2020-2022, nuk janë monitoruar dy herë/vit 3 nga 7 subjektet e përzgjedhura për auditim (subjekti “D.V.” sh.p.k. me leje minerare nr.1225/1, datë 24.12.2012, subjekti “T.E.” sh.p.k. me leje minerare nr.1661/2, datë 06.11.2014 dhe subjekti “M. C.” sh.p.k. me leje minerare nr. 1790/1, datë 21.01.2016). Për vitin 2020 dhe 2021 nuk është monitoruar dy herë në vit subjekti “A.” sh.p.k. me leje minerare nr. 1604, datë 7.1.2013. Për vitin 2020 dhe 2022 nuk është monitoruar dy herë në vit subjekti “A.” sh.p.k. me leje minerare nr.1792/1, datë 10.03.2016.

Gjetje nga auditimi 3:

Subjektet që kryejnë aktivitet minerar të shfrytëzimit të mermerit zotërojnë leje mjedisi “Tipi B” në kushtet e së cilës përcaktohet edhe dorëzimi dy herë në vit i Raporteve të Vet Monitorimit të Lejes Mjedisore. Konstatohet se për periudhën 2020-2022 nuk janë dorëzuar dy herë në vit (për periudhën 2020-2022) Raportet e Vet Monitorimit të “Lejeve Mjedisore Tipi B” nga subjektet me leje mjedisi nr. PN-0131-11-2020, PN-0266-02-2021, PN-9060-07-2019, PN-3102-06-2016, PN-6834-02-2014.

Gjetje nga auditimi 4:

Subjekti “K. K.” sh.p.k. me leje minerare shfrytëzimi nr.1051/1, datë 03.08.2007 zhvillon veprimtari minerare pa disponuar lejen mjedisore, duke qenë në mos përputhje me kriteret e përcaktuara në ligjin minerar dhe mjedisor.

Konkluzione

1. Mungesa e rehabilitimit progresiv mjedisor nga ana e subjekteve që shfrytëzojnë mermerin nuk garanton minimizimin e efekteve negative mjedisore përgjatë periudhës së operimit të këtyre subjekteve.
2. Moszbatimi dispozitave të ligjit minerar në lidhje me monitorimin e plotë dhe dy herë në vit i cili vjen si rezultat edhe i mos mbështetjes së duhur financiare sjell mangësi në pasqyrimin real të realizimit të të gjithë treguesve të planit vjetor të shfrytëzimit për çdo subjekt. Mos pasqyrimi i drejtë dhe i plotë i akt-konstatimeve për të gjitha operacionet e veprimtarisë sipas planit vjetor të miratuar nuk lejon të evidentohen shkeljet ligjore që përbëjnë kundërvajtje administrative në zbatim të legjislacionit minerar.
3. Mosdorëzimi i raporteve të vet monitorimit sipas afateve të përcaktuara në lejet e mjedisit nga subjektet minerare cënon respektimin e kushteve dhe kriterëve për respektimin e standardeve mjedisore të përcaktuara në lejet e mjedisit.
4. Mungesa e lejes mjedisore krahas mos respektimit të ligjit minerar dhe atij mjedisor nuk garanton respektimin e standardeve mjedisore dhe marrjen e masave me qëllim minimizim dhe reduktimin e efekteve negative mjedisore në zonën minerare të shfrytëzuar.

1.1 Rekomandimi:

Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit të vlerësojë sipërfaqet e prekura nga aktiviteti i shfrytëzimit minerar të mermerit dhe sipas rastit të sigurojë që subjektet të kryejnë rehabilitimin progresiv/përfundimtar të sipërfaqeve të shfrytëzuara.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

2.1 Rekomandimi:

Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore të marrë masat e nevojshme për të kryer me përpikmëri dy herë në vit monitorimin e veprimtarisë minerare të çdo subjekti në vendin e ushtrimit të aktivitetit.

Në vazhdimësi

3.1 Rekomandimi:

Agjencia Kombëtare e Mjedisit të marrë masa ndëshkuese gjatë inspektimeve në terren për subjektet të cilat nuk kryejnë dorëzimin e raporteve të vet monitorimit dhe t'i vlerësojë këto si subjekte me potencial risku.

Menjëherë e në vazhdimësi

4.1 Rekomandimi:

Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit nëpërmjet një grupi të përbashkët pune të inspektojnë subjektin "K. K." sh.p.k. me leje minerare të shfrytëzimit nr.1051/1, datë 03.08.2007, për zbatimin e kushteve të lejes minerare dhe mjedisore.

Menjëherë

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

6. ANEKSI

6.1 Observacionet e subjekteve

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit, AKBN ka paraqitur observacione me shkresë nr. 2442/4 prot. datë 13.12.202, ardhur në KLSH me nr. 448/10 prot datë 15.12.2023, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Lidhur me gjetjen nr. 3 dhe rekomandimin nr. 3.1, (fq.26) të pyetjes audituese “A janë hartuar dhe zbatuar politika dhe objektiva të përshtatshme në funksion të shfrytëzimit të mermerëve”?

Sa i përket sigurimit nga aksidentet në punë për punonjësit që ushtrojnë aktivitetet minerar, subjektet private e kanë detyrim të sjellin edhe Policat e Sigurimit nga aksidentet në punë në Komisionin e Planit Vjetor të Punës. Bazuar në Rregulloren e Komisionit të Miratimit të Planeve Vjetore, numri i punonjësve me sigurim jete është përcaktuar jo më i vogël se 3 punonjës (2 punonjës + Drejtuesi teknik i subjektit) me afat 1 vjeçar, për aktivitetin minerar në objektet sipërfaqësore. Në deklaratimet *online* subjektet vetë deklarojnë numrin e punonjësve të siguruar për të gjithë punonjësit e tyre.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit risjell edhe një herë në vëmendje se sigurimi i punonjësve ndaj aksidenteve në punë duhet bërë sipas pozicioneve të punës, shkallës apo nivelit të vështirësisë së tyre dhe nivelin e riskut që punonjësit hasin në këtë lloj veprimtarie. Kriteri me 3 punonjës që AKBN ka përmendur në këtë observacion është trajtuar në nënkapitullin “Sigurimi i punonjësve nga aksidentet në punë”. Megjithatë ky kriter është thjesht sasior dhe i pamjaftueshëm në raste kur subjektet kanë me dhjetëra punonjës që ballafaqohen me risk të lartë nga aksidentet në punë. Ndaj edhe një herë i qëndrojmë rekomandimit, se duhen vendosur kritere më të qarta sa i përket pozicioneve të punës që e kanë të nevojshme sigurimin e jetës nga aksidentet në punë.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit, AKBN ka paraqitur observacione me shkresë nr. 2442/4 prot. datë 13.12.202, ardhur në KLSH me nr. 448/10 prot datë 15.12.2023, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Lidhur me gjetjen nr. 1&2 dhe rekomandimin nr. 1.1, (fq.36) të pyetjes audituese “Si ka qenë ecuria e të ardhurave të realizuara nga sektori i shfrytëzimit të mermerëve”?

Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, për të gjithë subjektet që shfrytëzojnë Gëlqerorët Masiv, të Mermerizuar dhe Dekorativ, të marrë masa për të unifikuar pagesën e rentës minerare bazuar në emërtimin e mineralit që përmban Leja Minerare e shfrytëzimit. Nga ana e AKBN janë dhënë sqarimet përkatëse lidhur me arsyet e rritjes së volumit të produktit të shitur dhe uljes së rentës minerare për periudhën objekt auditimi, si edhe sqarime lidhur me pagesën jo të unifikuar të rentës minerare nga subjektet e pajisura me lejen minerare me emërtimin “Gëlqeror i mermerizuar”.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit, është njohur me shpjegimet e dhëna në observacionin e dërguar nga AKBN gjatë periudhës së auditimit. Në trajtimin e gjetjeve nr. 1&2 dhe rekomandimin nr. 1.1, AKBN shpreh dakordësinë me rekomandimin e lënë “Rekomandimi nga ana e Grupit të auditimit qëndron dhe është në përputhje edhe me kërkesat e vazhdueshme të DM drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Komisionit AD-Hoc”.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, Ministria e Turizimit dhe Mjedisit ka paraqitur observacione me shkresë nr. 4802/3 prot. datë 13.07.2023 “Mbi gjetjet në Projektraportin e Auditit të Performancës” nga Ministri i MTM-së Znj. M.K.F., ku janë shprehur objeksionet si më poshtë.

Pretendimi i subjektit: Lidhur me rekomandimin nr. 1.1, (fq. 41) të pyetjes audituese 4.2.1 A janë miratuar kërkesat për heqje nga fondi pyjor të aktiviteteve të shfrytëzimit të mermerëve, MTM sqaron se: MTM ka shqyrtuar të gjitha kërkesat e ardhura nga subjektet për shfrytëzimin e mermerëve dhe statusin e tyre jua ka informuar sipas tabelës së kërkuar. Për subjektet të cilat kanë dokumentacion të plotë, janë në fazë rishqyrtimi nga strukturat e ministrisë e lidhur kjo edhe me ndryshimet ligjore, emërtesat etj. Gjithashtu, duke mbajtur në konsideratë përcaktimet sipas pikës 1, neni 12, të ligjit 57/2020, "Për pyjet", për shkak të vlerës dhe rëndësisë, pyjet janë pasuri kombëtare dhe trajtohen si të tilla. Funkcioni i pyjeve si një e mirë publike prevalon mbi çdo interes tjetër të çdo subjekti dhe garantohet me vendosjen e kufizimeve përkatëse. Institucionet shtetërore garantojnë trajtimin prioritar të pyjeve sipas statusit të tyre "pasuri kombëtare" dhe interesit publik që ato përmbushin, miratimi i heqjes nga fondi pyjor lidhet edhe me faktin që deri tani nuk është kryer asnjë lloj rehabilitimi. Rehabilitimi si detyrim i lejeve të shfrytëzimit mineral, nuk është i lidhur me detyrimin e pyllëzimit kompensues si rezultat i heqjes nga fondi pyjor dhe duhet të ishte kryer në mënyrë periodike sipas planit të rehabilitimit të miratuar i cili është kusht për miratimin e lejes së shfrytëzimit mineral. Heqja nga fondi pyjor dhe detyrimi i pyllëzimit kompensues nuk është kusht i realizimit të planit të rehabilitimit. Realizimi i planit të rehabilitimit është një nga kushtet për revokimin e lejes së shfrytëzimit. Për më tepër, ligji bazë i sektorit mineral, nr. 10304, datë 15.07.2010, neni 24, pika 10, citonte se "leja minerare hyn në fuqi për zbatimin e detyrimeve pas heqjes nga fondi pyjor... dhe kjo është hequr në nryshimin e aktit me ligjin nr. 134/2014. Në nenin 47 pika 1/b, e cila citon rastet e revokimit, nuk përmendet që një nga kushtet është heqja nga fondi pyjor, gjithashtu, në asnjë nga nenet e ligjit mineral nuk ka të cituar kur hyn në fuqi leja minerare dhe që pas kësaj ditet llogaritet 180 ditësi për revokimin. Pra, si përfundim, miratimi i heqjes nga fondi pyjor nuk është i lidhur me revokimin e lejes minerare.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Së pari sqarojmë se lidhur me rekomandimin nr. 1.1 më sipër, grupi i auditimit ka synuar të theksojë rëndësinë e përfundimit të procedurës së heqjes nga fondi pyjor dhe jo vetëm shqyrtimit paraprak të tyre. Ndaj dhe ky rekomandim është lënë, pasi subjekte që kanë aplikuar prej muajsh apo edhe vitesh sic kemi marrë informacion nga vet MTM (nëpërmjet tabelës së dërguar grupit të auditimit gjatë auditimit), ende nuk kanë një përgjigje definitive nga MTM mbi dokumentin e miratimit për heqjen nga fondi pyjor sipas ligjit për pyjet.

Së dyti, hyrja në fuqi e lejes minerare përcaktohet në Aktin e Miratimit të Lejes Minerare nga Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë. Është e vërtetë që në nenin 47 pika 1/b nuk citohet që një nga kushtet e revokimit është mos marrja e dokumentit të heqjes nga fondi pyjor dhe kjo nuk është thënë nga grupi i auditimit. Ajo që grupi i auditimit ka dashur të theksojë është se subjektet private ndodhen mes "dy zjarreve", nga njëra anë duhet të zbatojnë ligjin mineral dhe të fillojnë aktivitetin e tyre brenda 180 ditëve siç e parashikon ligji mineral, neni 47 pika 1 gërma b/II, dhe nga ana tjetër duhet të pajisen me dokumentin për heqjen e fondit pyjor në mënyrë që të zbatojnë me përpikmëri qëllimin e këtij ligji e mos të jenë objekt ndëshkimi bazuar në Ligjin për Pyjet neni 36 pika 4 "a" dhe pika 6 "b". Si përfundim, miratimi i heqjes nga fondi pyjor nuk lidhet me revokimin e lejes minerare, por me zbatimin e Ligjit për Pyjet nga ana e subjekteve private dhe ajo që vlen për t'u theksuar është se për këtë situatë, të paktën për pjesën më të madhe të subjekteve, është Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ajo që i ka ballafaquar me këtë mos zbatim të ligjit.

Pretendimi i subjektit: Lidhur me rekomandimin nr. 3.1, (fq. 41) të pyetjes audituese 4.2.1 A janë miratuar kërkesat për heqje nga fondi pyjor të aktiviteteve të shfrytëzimit të mermerëve, MTM sqaron se: Kërkesa për heqje nga fondi pyjor për sipërfaqen e miratuar për shfrytëzim mineral, bëhet nga subjekti dhe nuk inicohet nga MTM dhe mënyra e aplikimi është e përcaktuar në VKM nr. 888/2022. Gjithashtu, është e përcaktuar edhe në Ligjin Mineral nr. 10304, datë 15.07.2010, të ndryshuar me Ligjin nr. 134/2014, neni 24, pika 10 ku citohet se Me miratimin e lejes minerare të shfrytëzimit me karrierë të grupit të mineraleve ndërtimore zona e lejuar e shfrytëzimit hiqet nga fondi pyjor e kullësor, pronë shtetërore, zëri "Tokë e zënë, tokë me bimësi pyjore", dhe regjistrohet në zërin "Tokë

e zënë, objekt shfrytëzimi për ushtrimin e veprimtarisë minerare”, sipas legjislacionit në fuqi për ndryshimin e zërit kadastral të fondit pyjor e kullësor. Brenda 10 ditëve nga miratimi i lejes, zotëruesi i saj përgatit dokumentacionin përkatës dhe e dorëzon pranë ministrisë përgjegjëse për veprimtarinë minerare, e cila brenda 10 ditëve përgatit aplikimin dhe e dërgon pranë ministrisë përgjegjëse për mjedisin. Së dyti, MTM nuk mban kadastrën minerare e cilat mbahet nga AKBN dhe nuk është në dijeni të lejeve minerare të miratuara dhe subjektet të cilat kanë përfituar këto leje.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Sqarojmë se rreth 25 % e subjekteve (konkretisht 8 subjekte) që operojnë vetëm në sektorin e mermerit nuk kanë aplikuar fare për heqjen nga fondi pyjor të sipërfaqes pyjore të licencuar për aktivitet mermeri. Bazuar në Ligjin 57/2020 “Për Pyjet” neni 6 pika 3, neni 14, pika 2, neni 15 pika 2, neni 22 pika 1 & 2, është Agjencia Kombëtare e Pyjeve (institucion nën varësinë e MTM-së) e cila ka përgjegjësi lidhur me mirëqeverisjen dhe ruajtjen e pyjeve, monitorimin, grumbullimin e informacioneve, interpretimin dhe raportimin e tyre. Gjithashtu, ajo që vlen të theksohet, bazuar në nenin 35 pika 1 të Ligjit 57/2020 “Për pyjet”, AKP ka një rol shumë të rëndësishëm në kuadrin e kontrollit dhe mbikëqyrjes së zbatimit të akteve ligjore e nënligjore.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, AKBN ka paraqitur observacione me shkresë nr. 2442/4 prot. datë 13.12.202, ardhur në KLSH me nr. 448/10 prot datë 15.12.2023, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Lidhur me gjetjen 1 dhe rekomandimin nr. 1.1 (fq 49 & 50) të pyetjes audituese nr. 4.2.2 “A ka funksionuar sistemi i kontrollit dhe monitorimit të aktivitetit të shfrytëzimit të mermerëve”?

AKBN sqaron se sektori i mbikëqyrjes pranë DM në AKBN, ka të dhëna të sakta përsa i përket sipërfaqes se licencuar dhe te prekur nga aktiviteti minerar për të gjitha llojet e mineraleve ndërtimore dhe specifikisht për grupin e mineraleve GMMD për të cilët është kryer ky auditim. Sipërfaqet e prekura nga aktiviteti minerar rivlerësohen në çdo kontroll në objekt dhe pasqyrohen në raportin 6 1mujor/vjetor që DM harton lidhur me aktivitetin minerar në RSH. Theksojmë se këto objekte minerare janë në zhvillim e sipër dhe praktikisht nuk është e mundur të realizohet rehabilitimi progresiv i sipërfaqeve te prekura nga aktiviteti minerar. Megjithatë, aty ku kanë mbaruar rezervat, janë lenë detyrat përkatëse nga DM për të krijuar kushtet për rehabilitim progresiv. Te gjitha subjektet minerare, që ushtrojnë aktivitet shfrytëzimi për GMMD, kanë paguar rregullisht vlerën e përcaktuar në projektin fillestar të shfrytëzimit për Garancinë e Rehabilitimit të Mjedisit (kjo vlerë paguhet çdo vit për vitin pasardhës).

Llogaritjet tuaja për garancitë e papaguara vërejmë se nuk janë të sakta:

Për sa i përket viteve më para, subjektet që janë propozuar për revokim për mos pagesë të garancisë së rehabilitimit, ose e kanë kryer pagesën ose janë revokuar.

Aktualisht vetëm 2 subjekte janë debitore. Me poshtë po japim sqarimet për secilin subjekt që keni përmendur.

1. Subjekti "N. K." sh.p.k, leja **1350**, me vlerë totale të garancisë së rehabilitimit **1,417,980 leke** dhe me vlere vjetore **141,798 lekë**, nuk ka paguar 3 vitet 2020-2022 në vlerë totale **425,394 leke**. Subjekti është në proces gjyqësor dhe i është dërguar dhe propozimi për revokim.

2. Subjekti "A.", sh.p.k, leja **1604/2**, me vlerë totale të garancisë së rehabilitimit **1,019,379 lekë** dhe me vlerë vjetore **59,964 lekë** ka paguar dhe garancinë e vitit 2023.

3. Subjekti "Z. F.", sh.p.k, leja **1617**, me vlerë totale të garancisë së rehabilitimit **2,194,700 leke** dhe me vlere vjetore **87,788 lekë**, ka paguar dhe garancinë e vitit 2023.

4. Subjekti "H. F.", sh.p.k, leja **1703**, me vlere totale të garancisë së rehabilitimit **3,139,825 leke** dhe me vlere vjetore **125,593 leke**, ka paguar dhe garancinë e vitit 2023.

5. Subjekti "G.M.M" sh.p.k, leja 1834, me vlerë totale të garancisë së rehabilitimit 9,750,278 lekë dhe me vlere vjetore 390,000 lekë, nuk ka paguar vitin 2022 në vlerë totale 390,000 lekë. Ky subjekt është revokuar më datë 31.05.2023.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Siç është argumentuar në faqen 41, 42, 43 të Raportit të Auditimit, theksojmë se: a) sipërfaqja e rehabilitimit të mjedisit progresiv dhe përfundimtar është 0 km², edhe pse sipërfaqja e shfrytëzuar rezulton të jetë 0.8879 km², ndaj sipërfaqes 21.5301 km² së dhënë për shfrytëzim. Hartimi i planit të rehabilitimit dhe fillimi i rehabilitimit progresiv të karrierës (guroreve) nga kompanitë, duhet të fillojë që në vitin e parë pas shfrytëzimit të saj sipas përcaktimit në pikën 8,10,11 të Urdhërit 67, datë 11.3.2018. Plani i rehabilitimit progresiv dhe përfundimtar, vlerësohet nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) dhe zhvillohet gjatë dhe pas përfundimit të veprimtarisë shfrytëzuese deri në rehabilitimin e plotë të sipërfaqes së shfrytëzuar sipas kërkesave standarde të miratuara me Udhëzimin e përbashkët të MIE dhe MTM mbi rehabilitimin mjedisor progresiv, përcaktuar qartë në Vendimin nr. 741, datë 09.09.2015. AKBN-ja është drejtpërdrejtë struktura përgjegjëse që ka për detyrë mbikëqyrjen dhe monitorimin e veprimtarive minerare dhe ka të drejtë të marrë masa administrative ose t'i propozojë Ministrit për marrjen e tyre, sipas përcaktimit në pikën 1.2/b, pikën 4 të nenit 43 të Ligjit nr.10304, datë 15.7.2010 "Për sektorin minerar në RSH-së", detyrim të cilin nuk e ka zbatuar për asnjë rast të vetëm, edhe kur Ju e keni lënë detyrë, prandaj pretendimi juaj se subjektet janë në zhvillim e sipër dhe praktikisht nuk është e mundur të realizohet rehabilitimi progresiv i sipërfaqeve të prekura nga aktiviteti minerar nuk qëndron. b) Përsa i takon llogaritjes së garancisë financiare vjetore të rehabilitimit theksojmë se jemi bazuar në të dhënat e vëna në dispozicion grupit tonë të auditimit (evidenca për pagesën e garancisë financiare vjetore për të gjitha subjektet aktive, në evidencën e debitorëve). Sqarojmë se subjekti "A." me leje nr. 1604/2, datë 07.01.2013 me afat 25 vite, sipas evidencës suaj, vlere totale e garancisë është 1,258,725 lekë dhe detyrimi vjetor është 59,964 lekë. Në observacionin tuaj vlere totale e garancisë është 1,019,379 lekë, pra nuk është e njëjta vlerë në evidencën e paraqitur, ç'ka tregon përsëri pasaktësi dhe mosrakordim midis strukturave tuaja përgjegjëse. Sipas përlllogaritjeve nga grupi i auditimit, del se detyrimi është 93,867 lekë, sipas argumentimit në faqen 43 të Projekt Raportit.

Në lidhje me Subjektet "N. K." sh.p.k, leja 1350, "Z. F.", sh.p.k, leja 1617, "H. F.", sh.p.k, leja 1703, "G. M. M." sh.p.k, leja 1834 sqarojmë se: përlllogaritjet janë bërë duke u bazuar në evidencat e dërguara nga AKBN të cilat janë trajtuar në fq 43 të Projekt Raportit.

Përsa i përket subjekteve të cilat janë cilësuar propozim për revokim apo dhe proces gjyqësor, sqarojmë se grupi i auditimit i është referuar vetëm periudhës 2020-2022, periudhë e cila ka qenë dhe objekt i këtij auditimi.

Për sa më sipër shprehemi se pretendimet tuaja nuk merren në konsideratë nga grupi i auditimit pasi nuk qëndrojnë.

Pretendimi i subjektit: Lidhur me gjetjen nr. 2 dhe rekomandimin nr. 2.1 (fq 49 & 50) të pyetjes audituese nr. 4.2.2 "A ka funksionuar sistemi i kontrollit dhe monitorimit të aktivitetit të shfrytëzimit të mermerëve"?

Në projekt raport është konstatuar edhe fakti që jo të gjitha subjektet minerare janë inspektuar 2 (dy) herë në vit. Në mungesë të bazës teknike, financiare dhe faktorë të tjerë (të përshkruara qartë në raportet përmbledhëse), DM e ka pasur të pamundur inspektimin 2 herë në vit për çdo subjekt. Megjithatë, ky konstatim është i drejtë dhe do merren masat për zbatueshmërinë e tij.

Lidhur me të dhënat jo të plota në Akt-Konstatime, sqarojmë se ato mbahen në terren, në kushte jo gjithmonë të përshtatshme dhe përmbajnë të dhëna operative të konstatuara në momentin e inspektimit. Këto të dhëna, së bashku me matjet topo-markshederike, përpunohen në zyrë për të arritur në një konkluzion më të saktë lidhur me aktivitetin minerar, dhe të dhënat që pasqyrohen në raportet përfundimtare.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me pretendimin tuaj për mosplotësimin e Akt Konstatimeve si pasojë e mungesës së kushteve jo gjithmonë të përshtatshme, ju bëjmë me dije se grupi i auditimit ka konstatuar se të gjitha Akt Konstatimet e mbajtura nuk janë të plotësuara korrekt e saktë në të gjitha rubrikat e formatit të Akt-Konstatimit, detyrim i përcaktuar në Urdhërin Nr.382, datë 20.5.2011“Për miratimin e formës, përmbajtjes dhe procedurave të lënies së aktit të konstatimit për kundërvajtjet administrative në zbatim të lejeve minerare”. Pavarësisht arsyesimit të AKBN-së grupi i auditimit i qëndron bindjes se Akt-Konstatimet duhet të plotësohen në mënyrë korrekte në përputhje me kriteret mbi mbajtjen e plotësimit të tyre.

Pretendimi i subjektit: Lidhur me gjetjen nr. 4 dhe rekomandimin nr. 4.1 (fq 49 & 50) të pyetjes audituese nr. 4.2.2 “A ka funksionuar sistemi i kontrollit dhe monitorimit të aktivitetit të shfrytëzimit të mermerëve”?

Kjo Leje Minerare është propozuar për revokim nga AKBN (shkresa Nr. 4319 prot., date 15.09.2023), për mos përmbushje të detyrimeve ligjore për Lejen Minerare të Shfrytëzimit Nr. 1051/1 date 03.08.2007. Jemi në pritje të përgjigjes së MIE-s.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Reagimi i AKBN-së në një kohë kaq të shpejtë tregon marrjen e masave të menjëhershme në drejtim të vënies në zbatim të këtij rekomandimi të lënë nga grupi i auditimit.

Aneksi 6.2 Foto të kryera gjatë vizitave në terren



Foto 1: Pamje nga shfrytëzimi i mermerit në Kapshticë, Devoll (Grupi i auditimit, 2023)



Foto 2: Pamje nga shfrytëzimi i mermerit në Pepellash, Ersekë (Grupi i auditimit, 2023)



Foto 3: Pamje nga shfrytëzimi i mermerit në Lepenicë, Selenicë (Grupi i auditimit, 2023)



Foto 3: Pamje nga shfrytëzimi i mermerit në Mëlovë, Skrapar (Grupi i auditimit, 2023)

Aneksi 6.3

Tabela nr. 2 Lista e subjekteve minerare që rezultojnë me të dhëna jo të sakta e të plota në raportet vjetore, në lidhje me pagesën e garancisë financiare vjetore, për periudhën e auditimit 2020-2022.

Nr.	Nr.Leje	Data e rinovimit të lejes	Data e lejes	Debitorë sipas AKBN	Sipas të dhënave në raportin vjetor 2020	Sipas të dhënave në raportin vjetor 2021	Sipas të dhënave në raportin vjetor 2022
1	862/2	03.04.2015	26.05.2005		Paguar	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna
2	970/2	21.07.2016	06.09.2006		Paguar	Paguar	Nuk ka të dhëna
3	1051/1	13.06.2017	03.08.2007		Papaguar	Paguar	Paguar
4	1225/1	24.12.2012	24.12.2012		Paguar	Paguar	Nuk ka të dhëna
5	1350	25.11.2019	26.05.2009	141,798	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna
6	1548/1	14.12.2021	27.06.2011		Nuk ka të dhëna	Papaguar	Papaguar
7	1604/2	12.07.2021	07.01.2013		Papaguar	Paguar	Paguar
8	1617		19.03.2013		Papaguar	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna
9	1653		07.08.2013		Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna	Paguar
10	1656		16.08.2013		Paguar	Nuk ka të dhëna	
11	1661/2		06.11.2014		Paguar	Paguar	Paguar
12	1703		23.05.2014		Papaguar	Paguar	Paguar
13	1714		06.06.2014		Paguar	Nuk ka të dhëna	Paguar
14	1740		10.02.2015		Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna	Paguar
15	1789		14.01.2016		Paguar	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna
16	1790/1		22.01.2016		Paguar	Paguar	Nuk ka të dhëna
17	1792/1		10.03.2016		Paguar	Nuk ka të dhëna	Paguar
18	1811		12.07.2016		Paguar	Paguar	Nuk ka të dhëna
19	1826		12.12.2016		Paguar	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna
20	1834		13.06.2017	390,000	Nuk ka të dhëna	Papaguar	Nuk ka të dhëna
21	1835		30.06.2017		Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna
22	1853		25.01.2018		Paguar	Paguar	Paguar
23	1863		16.07.2018		Paguar	Paguar	Nuk ka të dhëna
24	1866		26.09.2018		Paguar	Paguar	Paguar
25	1888		30.12.2019		Paguar	Paguar	Nuk ka të dhëna
26	1890		10.04.2020		Paguar	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna
27	1389		23.07.2009		Papaguar		
28	1561		22.05.2012		Paguar	Paguar	Paguar
29	1562/1		01.07.2013		Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna
30	1026/2		25.04.2017		Paguar	Paguar	Paguar
31	1706		23.05.2014		Papaguar	Paguar	Nuk ka të dhëna
32	1711		29.05.2014		Paguar	Paguar	Nuk ka të dhëna
33	1784		19.11.2015		Papaguar	Papaguar	Nuk ka të dhëna
34	1791		2.02.2016		Paguar	Papaguar	Nuk ka të dhëna
35	1389		23.07.2009		Nuk ka të dhëna	Papaguar	Papaguar
36	1844		13.09.2017		Papaguar	Nuk ka të dhëna	
37	1845		13.09.2017		Papaguar	Nuk ka të dhëna	
38	1700		21.05.2014		Paguar		
39	1905		18.01.2021			Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna
40	1912		07.06.2021			Paguar	Paguar
41	1916		12.07.2021			Nuk ka të dhëna	Paguar
42	1918		12.07.2021			Paguar	Paguar
43	1921		12.07.2021			Paguar	Paguar
44	1924		13.10.2021			Nuk ka të dhëna	Paguar
45	1930		24.03.2022				Paguar

Burimi i të dhënave: Evidenca e dërguar nga AKBN dhe përpunuar nga grupi i auditimit